



RADIKALIZMI FETAR
DHE EKSTREMIZMI I DHUNSHËM
NË SHQIPËRI

RADIKALIZMI FETAR DHE EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË SHQIPËRI

IDM, TIRANË 2015



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Ky botim është pjesë e projektit “Parandalimi i radikalizmit fetar tek të rinjtë” të mbështetur financiarisht nga Ambasada e ShBA-ve në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në të janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Drejtues i grupit të ekspertëve dhe studiues kryesor

GJERGJI VURMO

Grupi i ekspertëve

GJERGJI VURMO, Studiues kryesor dhe bashkë-autor

BESFORT LAMALLARI, Studiues dhe bashkë-autor

ALEKA PAPA, Studiuese dhe autore kontribuese

ELONA DHËMBO, Eksperte e lartë

Këshilltarë dhe bashkëpunëtorë të studimit

SOTIRAQ HRONI

ARBEN RAMKAJ

ARJAN DYRMISHI

SHEFQET SHYTI

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve	6
Fjalorth	7
1. PËRMBLEDHJE	9
2. HYRJE	14
3. METODOLOGJIA	16
4. SHQYRTIM I LITERATURËS MBI RADIKALIZMIN FETAR DHE EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM	20
4.1. Koncepte të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm	21
4.2. Radikalizmi si proces	24
4.3. Shkaqet themelore të radikalizmit	26
4.4. Tipologji e grupeve radikale	29
5. RIKTHIMI I FESË DHE LUFTA KUNDËR RADIKALIZMIT: SHQIPËRIA NË 25 VJET	32
5.1. Nevoja emergjente dhe reagim spontan ndaj sfidave të papritura	33
5.2. Radikalizmi fetar në Shqipëri: Kuadri i një dukurie në fazën e hershme	34
5.3. Reagimi i aktorëve kryesorë ndaj radikalizimit fetar: Pasivitet mes paqartësisë?	36
6. VLERËSIMI I FAKTORËVE QË MUNDËSOJNË RADIKALIZIMIN DHE NXITËSIT KRYESORË TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM	39
6.1. Nxitës socio-ekonomikë	45
6.1.1. Perceptimi i përjashtimit shoqëror dhe marginalizimi	47
6.1.2. Rrjetet shoqërore dhe dinamikat brenda grupeve	50
6.1.3. Diskriminimi shoqëror	54
6.1.4. Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ	56

6.1.5. Nevoja sociale dhe ekonomike të papërbushura	59
6.1.6. Lakmia për pasurim të shpejtë dhe pranimi për tu përfshirë në çdo aktivitet fitimprurës	62
6.2. Nxitës politikë	65
6.2.1. Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile	67
6.2.2. Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut	70
6.2.3. Nxitësit "Pushtimi i huaj" dhe "Cënimi politik dhe/ose ushtarak"	74
6.2.4. Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta	77
6.2.5. Zonat e paqeverisura ose të qeverisura dobët	80
6.2.6. Frikësimi apo kërcënim nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm	83
6.2.7. Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë	86
6.3. Nxitës kulturorë	88
6.3.1. Perceptime të sulmeve kundër Islamit	89
6.3.2. Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës	93
6.3.3. Axhenda "proaktive" fetare	94
6.4. Nxitës potencialë të ekstremizmit të dhunshëm specifikë për Shqipërinë	98
6.4.1. Tolerimi i institucioneve të paligjshme fetare	100
6.4.2. Autoriteti i kontestuar i institucioneve fetare në Shqipëri në nivel qendror	102
6.4.3. Mungesë / Ndikimi i klerikë lokalë	104
6.4.4. Niveli i përgatitjes së klerikëve	107
7. PËRFUNDIME	110
8. REKOMANDIME	116
8.1. Institucione shtetërore	117
8.1. Autoritete fetare	119
8.3. Shoqëria civile	120
8.4. Programet e "monitorimit të tensionit" dhe ekipet multidisiplinare	121
9. SHTOJCA	123
9.1. Islami i keqinterpretuar – Si funksionon manipulimi në fe?	124
9.2. Profili social-ekonomik dhe demografia e zonave të projektit	129

9.2.1. Bashkia Pogradec	130
9.2.2. Komuna Buçimas	133
9.2.3. Bashkia Librazhd	136
9.2.4. Komuna Qendër	139
9.2.5. Bashkia Përrenjas	142
9.2.6. Bashkia Cërrik	145
9.2.7. Bashkia Bulqizë	148
9.2.8. Bashkia Kukës	141
9.2.9. Një vështrim krahasimor	154
9.3. Gjetjet e detajuara të sondazhit	161
PYETËSORI I SONDAZHIT	215
POSHTËSHËNIME	222
BIBLIOGRAFIA	238

LISTA E SHKURTIMEVE

BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative
BP	Ballkani Perëndimor
DASH	Departamenti Amerikan i Shtetit
FFP	Fund for Peace (Fondi për Paqe)
FH	Freedom House
GRI	Government Restriction Index (Indeksi i Kufizimeve të Qeverisë)
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
IDRA	Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISIS	Islamic State of Syria & Iraq (Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut)
KE	Komisioni Evropian
KMSH	Komuniteti Mysliman Shqiptar
KSHK	Komiteti Shtetëror i Kulteve
LSMS	Living Standards Measurement Survey (Sondazhi i matjes së standardit të jetesës)
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MPB/MB	Ministria e Punëve të Brendshme
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PSH	Policia e Shtetit
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
WGI	World Governance Indicators (Treguesit Mbarëbotërorë të Qeverisjes)

FJALORTH

Shënim shpjegues: Për disa nga termat dhe konceptet e përfshira në këtë fjalorth nuk ka përkufizime të pranuar gjerësisht apo uniformitet në përdorimin e tyre, gjë që shpesh lë vend për konceptime të gabuara. Për më shumë detaje të këtij diskutimi, lutemi shihni Raportin e Grupit të Ekspertëve për Radikalizimin e Dhunshëm të Komisionit Evropian (KE), "Proceset e radikalizimit që çojnë në akte terrorizmi" (2008).

BEKTASHIZËM	Urdhër i Islamit sufi (tarikati) themeluar nga Sulltan Balim Sultan shekullin XIII. Pas ndalimit të urdhrit Sufist në Turqi (në vitin 1925) qendra e saj u shpërngul në Shqipëri.
EKSTREMIZMI I DHUNSHËM	Procesi i adoptimit të pikëpamjeve radikale (politike, ideologjike ose fetare) dhe kthimit të tyre në veprime të dhunshme
GULENIZËM	Lëvizje transnacionale fetare dhe sociale e drejtuar nga dijetari islamik turk dhe predikuesi Fetullah Gulen dhe që zakonisht referohet edhe si 'hizmet' (shërbim).
HANAFI	Një nga katër shkollat sunite (Hanbali, Maliki dhe Shafi'i) të së drejtës islame, themeluar nga Abu Hanifa.
HAXHI	Pelegrinazh në qytetin e shenjtë të Mekës (Arabi Saudite), të cilin duhet ta bëjë të paktën një herë në jetë çdo mysliman në moshë madhore. Haxhi është një nga 5 detyrat e çdo myslimani dhe katër të tjerat janë: shehadeti (shpallja e besimit të myslimanit); falja e namazit; zekati (dhënia e ndihmës për të varfrit dhe nevojtarët) dhe agjërimi (në muajin e Ramazanit)
MEDRESE	Institucion i arsimit Islamik
MYSLIMAN SUNIT	Përfaqëson degën më të madhe të Islamit (85-90% e popullsisë myslimane në botë). Pjesa e mbetur e popullsisë myslimane (10-15%) janë myslimanë shiitë.
RADIKALIZIM	Procesi i zhvillimit të ideologjive dhe pikëpamjeve ekstremiste. Radikalizimi mund të jetë i dhunshëm ose jo.
RADIKALIZIMI FETAR	Procesi i zhvillimit të ideologjive dhe pikëpamjeve ekstremiste fetare.
RADIKALIZIMI I DHUNSHËM	Procesi i përqaftimit të opinioneve, pikëpamjeve dhe ideve që mund të çojnë në akte terrorizmi (KE: 2005 "Rekrutimi terrorist: trajtimi i faktorëve në ndikojnë në radikalizimin e dhunshëm" [Terrorist Recruitment: addressing the factors contributing to violent radicalisation])

SALAFIZËM	Lëvizje brenda Islamit që merr emrin nga termi salaf (paraardhës) me përjasje të drejtpërdrejtë, të ngurtë dhe puritan ndaj Islamit.
SUFIZMI	Dimensioni i brendshëm mistik i Islamit; besimtari i një tradite të tillë të Islamit referohet si sufist.
TEKFIR / TEKFIRIZËM	Tekfirizmi është tendenca, e shfaqur tek disa prej formacioneve selafiste-xihadiste, për të bashkuar deklarin dhe veprimet e dikujt si jo-islamike me akuzën e apostazisë. Misioni i tekfirit është të rikrijë Kalifatin sipas interpretimit fjalë për fjalë të Kuranit. Në themel të Tekfirizmit (al-manha al-takfiri) është fjala arabe takfir – shpallja e veprimit apo një individi si jo-islamik – nga rrënja e fjalës kafir (i pafe). Tekfirizmi mund të konsiderohet si faza e fundit e islamizmit të pakufizuar.
TERRORIZËM	Akt i qëllimshëm që mund të dëmtojë seriozisht një vend apo një organizatë ndërkombëtare, i kryer me qëllimin shkaktimin e frikës së madhe tek popullata, duke detyruar në mënyrë të pandershme një qeveri apo organizatë ndërkombëtare të kryejë apo të mos kryejë një veprim, duke destabilizuar seriozisht apo duke shkatërruar strukturat bazë politike, kushtetuese, ekonomike apo sociale me anë të atentateve ndaj jetës së personit, sulmeve ndaj integritetit fizik të një personi, rrëmbimit, marrjes peng të njerëzve, avionëve apo anijeve, ose me anë të prodhimit, mbajtjes apo transportit të armëve dhe lëndëve shpërthyesë. (Vendimi Kuadër i BE-së për Luftën kundër terrorizmit: 2002)
UAHABI / ZMI	Lëvizje fetare e Islamit Sunit e përshkruar ndryshe edhe si "ortodoks", "ultrakonservativ", "të rreptë", "fundamentalist", or "puritanik".
XHEMATI	Bashkësia e besimtarëve myslimanë
XHIHAD	Detyra fetare e myslimanëve – "përpjekja në rrugën e Zotit" (Kurani). Xhihad shpesh përdoret edhe si "luftë e shenjtë" kundër jobesimtarëve për të përhapur Islamit.

1



PËRMBLEDHJE

Përmes këtij studimi është bërë e mundur mbledhja, gjenerimi dhe analizimi i të dhënave rreth fenomenit të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm me qëllim informimin e politikë-bërjes dhe aktorëve të interesuar në trajtimin e këtij fenomeni dhe sfidave që lidhen me të. Metodologjia e hulumtimit përqas identifikimin dhe analizimin e thelluar të kontekstit duke përdorur një larmi burimesh për të kuptuar shtrirjen dhe seriozitetin e një sërë faktorëve, të cilët mundësojnë apo nxisin radikalizimin fetar dhe forma të ekstremizmit të dhunshëm. Këta faktorë dhe 'nxitës' janë shpesh të ndërthurur me njëri-tjetrin dhe ndërveprojnë me kontekstin nëpërmjet formave të ndryshme. Lista e faktorëve të analizuar në këtë studim nuk është shteruese, pasi në kontekste dhe kohë të ndryshme fenomeni i radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm mund të ushqehet nga faktorë të tjerë. Gjatë periudhës studimore (shtator 2014 – maj 2015) u shqyrtua një volum i gjerë burimesh zyrtare, akademike dhe të dhëna të tjera të besueshme. Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm aktorësh janë përfshirë në fazën përgatitore të studimit si edhe gjatë hulumtimit në terren për gjenerimin e të dhënave, realizimin e sondazhit, intervistave me aktorë kyç dhe grupeve të fokusuara. Kuadri i plotë i metodologjisë së hulumtimit, si edhe gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e tij kanë qenë objekt i proceseve dhe instrumenteve të vleftësimit për të siguruar cilësi, objektivitet, përputhshmëri me kontekstin shqiptar dhe përjasje gjithëpërfshirëse të bazuar tek të dhënat.

Studimi i IDM konstaton se ndonëse radikalizmi fetar në Shqipëri ndodhet në fazat e hershme të tij, mungesa e vëmendjes dhe përfshirjes në trajtimin e faktorëve nxitës ose mundësues

të tij mund t'i shërbejë përkeqësimit të fenomenit. Hulumtimi po ashtu vëren pasivitet për trajtimin dhe parandalimin e radikalizimit fetar tek një pjesë e mirë e institucioneve shtetërore, veçanërisht tek institucionet jashtë spektrit të sigurisë, si edhe tek aktorë jo-shtetërorë. Fenomeni i radikalizimit fetar mund të zhvillohet më tej për shkak të mungesës së një bashkëpunimi përmbajtësor në drejtim të parandalimit të fenomenit midis autoriteteve shtetërore jashtë fushës së sigurisë dhe drejtuesve të komuniteteve fetare. Agjenda e grupeve radikale fetare mund të lehtësohet dhe favorizohet edhe nga mungesa e shoqërisë civile në zona të largëta rurale, e cila krijon një boshllëk në drejtim të aktiviteteve "mbrojtëse" ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Mbështetja e gjerë e komuniteteve të besimtarëve fetarë ndaj traditës liberale të besimit, institucioneve fetare dhe vlerave të harmonisë fetare nuk duhet të shërbejë si justifikim për pasivitet të aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë. Nga ana tjetër, keq-interpretimi i fenomenit, minimizimi i rëndësisë apo identifikimi i tij me pasojat (kryesisht në fushën e sigurisë) orienton drejt përjasjes së gabuar dhe efekte kundër-produktive të reagimit të institucioneve. Radikalizimi fetar (si proces) dhe ekstremizmi i dhunshëm (si rezultat) mundësohen dhe ushqehen nga faktorë apo nxitës të cilët ndërveprojnë në një kontekst shoqëror (makro) dhe individual/grupi (mikro). Disa nga gjetjet kryesore të hulumtimit përfshijnë:

NXITËS SOCIAL-EKONOMIKË

- a. Mundësitë e ulëta për punësim pavarësisht arsimimit mund të shërbejnë si një faktor potencial për radikalizim. Kjo ndjesi e përgjithshme privimi

dhe pritishtërisht të dështuara përjetohet afërsisht nga gjysma e të anketuarve (49%).

- b. Privimi nga mundësitë social-ekonomike shoqërohet me ndjesinë e të qenit i përjashtuar dhe i diskriminuar. Një në dy të anketuar beson se komuniteti fetar, të cilit ai i përket, nuk është i përfaqësuar mjaftueshëm në politikë dhe institucione shtetërore (51%).

Zonat periferike dhe rurale shfaqin treguesit më shqetësues të nxitësve social-ekonomikë ku grupet më të cënueshëm ndaj radikalizimit janë individë dhe familje në nevojë, të rinj të papunë dhe persona të cilët besojnë se janë të diskriminuar për shkak të besimit të tyre.

NXITËS POLITIKË

- a. Pamundësia për të ndikuar vendimmarrjen, qeverisja e korruptuar apo e padrejtë përbëjnë nxitës të fortë të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm. 26% e të anketuarve besojnë se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar edhe me dhunë po qe nevoja. 47% e të anketuarve besojnë se mbrojtja me çdo mjet, brenda apo jashtë kufijve, e vlerave dhe dinjitetit fetar është detyrë e çdo besimtar.
- b. Dhuna, keqtrajtimi apo përndjekja nga institucionet e sigurisë mund të provokojnë ndjenja hakmarrjeje dhe mbështetje për grupet ekstremiste të dhunshme. 30% e të anketuarve e justifikojnë hakmarrjen kundër institucioneve shtetërore, nëse

ato shkelin të drejtat dhe liritë e njeriut.

Mjaft shqetësues është fakti se kryesisht moshat e reja nga 18 deri 30 vjeç (jo praktikantë të fesë) me arsim të ulët dhe të papunë shfaqen më të prirur për të mbështetur përdorimin e dhunës. Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore dhe ofrimi i mundësive efektive për të marrë pjesë në vendimmarrjen në nivel vendor apo qendror janë kusht dhe shërbejnë për forcimin e marrëdhënies qytetar-shtet.

NXITËS KULTURORË

- a. Rreth 1/3 e të anketuarve besojnë se traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar është nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm, ndërsa Perëndimi shihet si armiqësor ndaj vendeve dhe kulturës Islame. Sipas të njëjtës përqindje të të intervistuarve, sot në Shqipëri është e vështirë të praktikosh fenë islame. Rreth 12% e të anketuarve besojnë se në komunitetin e tyre ka individë apo grupe që nxisin radikalizmin Islamik.

Kategoritë më të rrezikuara nga manipulimi fetar për sulme ndaj besimit dhe kulturës islame janë veçanërisht meshkuj të grupmoshës 31-35 vjeç, të papunë, praktikantë të fesë dhe me arsim të mesëm.

NXITËS SPECIFIKË PËR SHQIPËRINË

- a. Rreth 28% e të anketuarve shprehen tolerantë ndaj objekteve fetare pa leje (kisha, xhami). Një qëndrim i tillë paraqitet shqetësues duke pasur parasysh se këto mjedise

shpesh janë raportuar si propaganduese të ekstremizmi fetar.

- b. Rreth 21% e të pyeturve nuk besojnë se klerikët në komunitetin e tyre kanë nivelin e duhur të formimit teologjik. Për shkak të marrëdhënies së përditshme të klerikëve me komunitetin e besimtarëve, është kritike që ata të jenë të përgatitur për të kundërshtuar në bindshëm argumente radikale fetare dhe të trajtojnë shqetësimet e besimtarëve.

Bazuar në analizën e gjetjeve të këtij studimi, rekomandimet e mëposhtme trajtojnë masa dhe alternative konkrete në mbështetje të parandalimit dhe adresimit të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm në kontekstin e Shqipërisë. Ndërkohë që rekomandimet u drejtohen tre aktorëve kyçë –institucioneve shtetërore, KMSH-së dhe shoqërisë civile– studimi sugjeron se përgjegjësia për parandalimin dhe adresimin e radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm duhet konsideruar si një përgjegjësi më e gjerë shoqërore. Disa prej rekomandimeve kryesore të studimit janë:

- Trajtimi i fenomenit të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm përtej kufijve të sektorit të sigurisë duke përfshirë në mënyrë aktive agjenci dhe institucione shtetërore në fushat e qeverisjes vendore, arsimit, çështjeve sociale, rinisë, punësimit, anti-diskriminimi, etj. si edhe aktorë jo-shtetërorë, mbi të gjitha komunitetet fetare dhe shoqërinë civile. Veprimet dhe masat e ndërmarra në

kuadër të reagimit të organeve ligjzbatuese duhet të ndërthurin edhe mundësinë e programeve de-radikalizuese fetare në bashkëpunim me komunitetet fetare dhe shoqërinë civile.

- Konsolidimi i nivelit dhe formimit teologjik të imamëve, trajnimi i tyre lidhur me radikalizimin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm, fuqizimi i Këshillit të Teologëve dhe nxitja e koordinuar e veprimtarisë së tij me imamët janë disa nga masat që përmirësojnë zhvillimet brenda komunitetit më të madh fetar në vend. KMSH duhet të vazhdojë përpjekjet e nisura nën përfaqësimin e përfshirjes për trajtimin e rasteve të xhamive ilegale, si alternativë ndaj izolimit të tyre. Është thelbësore që këto përpjekje të mbështeten nga aktorë të tjerë të shoqërisë.
- Shoqëria civile duhet të kontribuojë për kundërshtimin e ideologjive dhe agjendave 'proaktive' të grupeve radikale fetare përmes krijimit të forumeve në të cilat marrin pjesë aktive opinion-bërës, drejtues fetarë dhe teologë. Zbutja e perceptimeve dhe efekteve të përjashtimit shoqëror dhe marginalizimit, sidomos midis të rinjve në kërkim të punësimit, mund të realizohet përmes nismave të shoqërisë civile me fokus tek rinia, gratë dhe komuniteteve të cënueshme nga fenomeni. Shoqëria civile duhet të angazhohet jo vetëm për evidentimin por edhe adresimin e rasteve të shkeljes së të drejtave nga institucionet shtetërore.
- Së fundi, është i nevojshëm hartimi i programeve të

“monitorimit të tensionit” dhe zbatimi i tyre nga skuadra multi-disiplinare me fokus tek promovimi i vlerave të përbashkëta, kundërshtimi i ideologjive ekstremiste, ndërtimi i kapaciteteve civile dhe drejtuese në komunitetet fetare dhe ato të marginalizuara si dhe forcimi i rolit të institucioneve të tyre. Një vëmendje e veçantë u duhet kushtuar programeve më specifike të cilat synojnë parandalimin e radikalizmit dhe de-radikalizmin në nivel individual. Programet me individët e rrezikuar nga radikalizmi apo të radikalizuar duhet të përfshijnë forma të ndryshme mentorimi dhe mbështetjeje, si ofrimi i hapësirave të sigurta, këshillimi psikologjik si dhe nxitja e individëve drejt mendimit kritik.

Procesi i përthithjes së gjetjeve të studimit dhe trajtimit të rekomandimeve të tij duhet të udhëhiqet nga një përfaqëse gjithëpërfshirëse që reflekton mbi sfida shoqërore me ndikim tek fenomeni dhe që fuqizon “agjentë të ndryshimit” në nivel kombëtar dhe vendor pranë komuniteteve më të rrezikuara.

2



HYRJE

Shqipëria, tashmë vend anëtar i NATO-s dhe kandidat për në Bashkimin Evropian (BE), po ecën në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE duke trajtuar sfidat e zhvillimit dhe forcimit të shtetit ligjor si dhe duke kontribuar në rritjen e bashkëpunimit rajonal në përputhje me vlerat evropiane. Harmonia fetare njihet gjerësisht si një vlerë themelore e shoqërisë, ku pjesëtarët e komunitetit mysliman, katolik, ortodoks dhe komuniteteve të tjera fetare kanë bashkëjetuar në paqe. Në një popullsi prej rreth 2.8 milionë banorë, tri bashkësitë më të mëdha fetare në vend sipas regjistrimit të fundit të popullsisë (2011) janë ajo myslimane (56.7%), katolike (10%) dhe ortodokse (6.8%).¹

Në vitet e fundit, veçanërisht me përshkallëzimin e konfliktit sirian, në debatin publik në Shqipëri u futën koncepte të tilla si radikalizimi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm. Raporte të ndryshme të medias në vend² apo ato ndërkombëtare³ si dhe hulumtimet kanë konfirmuar praninë e qytetarëve shqiptarë në konfliktin sirian.⁴ Reagimi i Shqipërisë ndaj një dukurie të tillë deri tani ka qenë kryesisht nëpërmjet masave represive me ndikim të menjëhershëm jashtë kufijve kombëtarë - për shembull, me ndryshimet në Kodin Penal (2014) për të mundësuar ndjekjen penale të individëve që marrin pjesë në konflikte të armatosura jashtë vendit, me intensifikimin e bashkëpunimit të shërbimeve të inteligjencës dhe policisë me agjencitë e zbatimit të ligjit në rajon; me ndjekjen penale të një numri individësh që rekrutoni qytetarët shqiptarë për të marrë pjesë në konfliktin sirian, etj. Nga ana tjetër, veprimeve të deritanishme të shtetit u mungon një perspektivë dhe qasje solide e orientuar drejt parandalimit brenda kufijve kombëtarë. Rastet e raportuara të qytetarëve shqiptarë që shkojnë për të luftuar në konfliktet e

armatosura jashtë vendit janë pasojat e një fenomeni të radikalizimit që po ndodh në mjedisin e brendshëm. Ato flasin për përpjekjet që bëhen për të përdorur fenë dhe për të radikalizuar besimtarët në vend me ndikim të drejtpërdrejtë tek komunitetet fetare dhe tek shoqëria në tërësi.

Ky studim i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) ka fokus të tij pikërisht këtë dimension të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Ai synon të identifikojë shkaqet kryesore, nxitësit kyçë dhe rreziqet e mundshme të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit fetar. Ai ka për qëllim të trajtojë dy aspekte themelore - gjenerimin e të dhënave për fenomenin dhe hartimin e rekomandimeve për parandalimin e tij. Analiza bazohet në kontekst dhe trajton rëndësinë, shkallën, (ndër)lidhjet dhe pasojat e nxitësve kryesorë duke shqyrtuar disa "variabla" dhe tregues të tillë si ata ekonomikë, socialë, arsimorë, kulturorë, fetarë, praninë e komunitetit dhe shtetit, etj. Duke u mbështetur në këto njohuri, studimi i IDM-së shtjellon mekanizmat e mundshëm të ndërhyrjes duke njohur rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve shtetërorë dhe bashkësive fetare si dhe të aktorëve të tjerë jo-shtetërorë, të tillë si shoqëria civile, mediat dhe qarqet akademike.

3



METODOLOGJIA

Studimi është hartuar për të sjellë të dhëna dhe fakte në kontekstin e debatit të politikave në lidhje me radikalizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri. Ai zbaton një metodologji të detajuar të mbledhjes, gjenerimit (aty ku mungojnë) dhe analizimit të të dhënave dhe evidencave, duke shqyrtuar fenomenin në kontekstin shqiptar dhe paraqitjen e karakteristikave të tij, vlerësimin e nxitësve kryesorë të tij, rreziqet dhe pasojat që lidhen me dukurinë. Studimi analizon edhe përgjigjen e aktorëve kryesorë (si shteti, komunitetet fetare, shoqëria civile dhe aktorët e tjerë jo-shtetërorë), mënyrën se si është zhvilluar kjo përgjigje deri tani dhe cilin drejtim duhet të marrë në të ardhmen e afërt. Rrjedhimisht, hulumtimi është realizuar për t'iu përgjigjur tri objektivave kryesore, si më poshtë:

- Hartëzimin e fenomenit të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri dhe paraqitjen e tipareve, shkallës dhe madhësisë së tyre;
- Identifikimin e nxitësve kryesorë dhe faktorëve të tjerë që ushqejnë apo mundësojnë (krijojnë dhe ruajnë) një fenomen të tillë dhe analizimin e rreziqeve dhe implikimeve në nivel shoqërie;
- Evidentimin e alternativave të bazuara në fakte për ndërmarrjen e veprimeve të bashkërenduara mes aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin fetar.

Përfaqja e studimit ndaj analizës mbi radikalizimin fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm mbështetet në një kuptim të pranuar gjerësisht se për

të kuptuar këtë fenomen hulumtimi duhet të bëjë prioritet popullatat dhe zonat gjeografike që duket se janë veçanërisht të ekspozuara ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë studim trajtohen edhe palët e interesuara dhe "lojtarët" e prekur nga ekstremizmi i dhunshëm dhe / ose me ndikim në mjedisin e synuar.

FOKUSI GJEORAFIK

Në studim janë përdorur informacione zyrtare nga agjencitë e zbatimit të ligjit në vend për aktivitetet aktuale apo të mundshme radikale fetare dhe informacione të raporteve të medias (sidomos për shtetasit shqiptarë që marrin pjesë në konfliktin sirian) për të përcaktuar në terma të përgjithshme fokusin gjeografik. Në bazë të këtij informacioni janë përzgjedhur katër qarqe pilote: Korça, Elbasani, Kukësi dhe Dibra.⁵ Në hapat e mëtejshëm të fazës fillestare të hulumtimit janë përcaktuar zona më specifike gjeografike brenda këtyre qarqeve të përfshira në këtë studim. Në përputhje me udhëzimin e dhënë përmes një kuadri teorik të fenomenit, shqyrtimit të literaturës dhe metodologjive bashkëkohore kërkimore si dhe bazuar në të dhënat zyrtare dhe informacionet nga burimet parësore dhe dytësore, në total u përzgjodhën tetë zona si zona të synuara, që janë: bashkitë Pogradec, Përrenjas, Librazhd, Cërrik, Bulqizë dhe Kukës si dhe komunat Buçimas dhe Qendër-Librazhd.⁶ Ky fokus i veçantë i studimit u përcaktua duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e variablave dhe treguesve socialë, ekonomikë, kulturorë dhe tregues të tjera që konsiderohen si përfaqësues dhe shumë të rëndësishme për shqyrtuar supozimet në lidhje me praninë/mungesën e raportuar të aktivitetit fetar radikal ose të ekstremizmit të dhunshëm.

POPULLSIA E SYNUAR

Studimi përqendrohet në shtresa të veçanta të popullsisë – tek të rinjtë dhe familjet e reja (individët deri në 45 vjeç), të cilët përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së përgjithshme në Shqipëri. Përveç kësaj, ky grup përfaqëson grup-moshën më të “shënjestruar” në lidhje me radikalizimin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm. E fundit por jo më pak e rëndësishme, ndërkohë që studimi trajton rolin dhe ndërthurjen e një sërë variablash social-ekonomike, kulturore, politike, fetare dhe të tjera brenda zonave të synuara gjeografike dhe popullatës në tërësi, në të shqyrtohet më ngushtësisht komuniteti më i madh fetar në Shqipëri, pra, komuniteti mysliman.

METODA

Ky kontekst shqyrtohet duke analizuar burimet dhe faktorët “nxitës” që çojnë apo mundësojnë dhe rrisin radikalizimin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri. Në këtë studim analizohet një kuadër i përgjithshëm i nxitësve kryesorë të përcaktuar në tre kategori (social-ekonomikë, politikë dhe kulturorë),⁷ i cili është validuar në kontekstin lokal në Shqipëri. Siç shpjegohet edhe në kapitullin 6 të këtij studimi, procesi i vlefësimit konfirmoi relevancën e kategorive dhe të pjesës më të madhe të nxitësve të këtij kuadri, ndërkohë që shtoi edhe një kategori të re “nxitësish” që janë specifike për kontekstin shqiptar.

Studimi del në përfundime për sa i përket implikimeve nga nxitësit dhe rreziqet e ndryshme për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin fetar duke shtjelluar dhe vlerësuar dinamikën dhe korrelacionet mes nxitësve nga të gjitha kategoritë. Vlerësimi i çdo

nxitësi specifik kyç është bërë me anë të trekëndëzimit metodologjik bazuar në disa burime parësore dhe dytësore, përfshirë këtu rishikimin e literaturës dhe raporteve, analizën e kuadrit ligjor dhe të politikave, të dhënat zyrtare mbi treguesit socio-ekonomikë dhe të tjerë, perceptimet e publikut, analizën e përvojës së drejtpërdrejtë dhe opinionet e informuesve kyçë dhe të grupeve të fokusuara, etj.

Për këtë studim u përdorën instrumente të hulumtimit cilësor për të evidentuar tiparet e fenomenit (faza fillestare), për të kuptuar kontekstin dhe si përkthehet në nivel vendor ky fenomen (shkalla dhe madhësia), për të analizuar rolet dhe pritshmëritë e aktorëve kryesorë si dhe për të shqyrtuar më thellësisht gjetjet e instrumenteve sasiorë (shih më poshtë). Disa nga këto instrumente dhe afati i tyre kohor jepet më poshtë:

- Hulumtim dhe analiza e burimeve (8 muaj)
- Intervista me 15 informues kyç në fazën fillestare nga institucionet qendrore shtetërore, institucionet fetare, ekspertë dhe profesionistë, gazetarë investigativë, etj. (një muaj)
- Njëzetë e tetë intervista me aktorë vendorë në tetë zonat e synuara me përfaqësues nga institucionet shtetërore, Komuniteti Mysliman Shqiptar (KMSH) dhe aktorë të tjerë (dy muaj)
- Fokus grupe me një total prej 40 pjesëmarrësish nga zonat e Bulqizës, Cërrikut, Librazhdit (përfshirë Komunën Qendër Librazhd) dhe Pogradecit (një muaj).

U hartua një instrument kërkimi sasior (sondazh) që u realizua gjatë një periudhe tremujore për të identifikuar perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve në zonat e synuara. Sondazhi u realizua me 800 të anketuar në tetë zona, bazuar në një kampion me kuota (100 të intervistuar për zonë), që siguron një interval besueshmërie 3.45 në një nivel besueshmërie 95%.⁸ Në kampionin për secilën zonë përfshiheshin qytetarët e moshës 18 - 45 vjeç, nga të cilët 50% e kampionit ishin qytetarë të zgjedhur rastësisht dhe 50% besimtarë myslimanë të përzgjedhur rastësisht dhe të intervistuar pranë ambienteve të xhamive të zonës.⁹

Pyetëtori u hartua nëpërmjet procedurave të rrepta për sigurimin e cilësisë dhe në versionin e tij përfundimtar përfshinte 47 pyetje në tre pjesë, si më poshtë:

- Pjesa 1 – Pyetje për demografinë dhe aspekte të veçanta për besimin fetar të të intervistuarit (nëntë pyetje)
- Pjesa 2 – që është edhe pjesa qendrore e pyetëtorit përfshinte në total 34 pohime të ndërlidhura me kuadrin e nxitësve kryesorë të ekstremizmit të dhunshëm (një apo dy “fjali verifikuese të përdorura për secilin nxitës)
- Pjesa 3 – pyetje të tjera të veçanta për qëndrimin dhe perceptimet e fesë dhe ekstremizmit të dhunshëm fetar në Shqipëri (katër pyetje)

Në pjesën e shtojcave të këtij studimi jepet një përshkrim i instrumentit të sondazhit si dhe hollësi të mëtejshme mbi gjetjet dhe metodologjinë së tij.

4



SHQYRTIM I
LITERATURËS MBI
RADIKALIZMIN
FETAR DHE
EKSTREMIZMIN E
DHUNSHËM

4.1. KONCEPTE TË RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Vitet e fundit *radikalizmi* dhe *ekstremizmi i dhunshëm* janë shndërruar në fjalë kyçe të studimeve, raportimeve të medias dhe të punës së agjencive ligjzbatuese të shteteve evropiane. Me gjithë seriozitetin dhe shkallën e rrezikut që i paraqitet sigurisë kombëtare të shteteve dhe rajonit sot nuk ka ende një përkufizim të qartë dhe të pranuar gjerësisht për radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.¹⁰ Përtej boshllëkut dhe konfuzionit që karakterizon debatet epistemologjike dhe studimet teorike në këtë fushë, mospasja e përkufizimeve të qarta për këto koncepte lidhet dhe me problemin praktik të identifikimit dhe kuptimit sa më të plotë të kërcënimit të shfaqur dhe rrjedhimisht mënyrës se si duhet të përballemi me të. Borum (2011) sugjeron se “qeveritë dhe organizatat përgjegjëse për sigurinë kombëtare duhet të përpiqen në mënyrë të bashkërenduar për të përkufizuar konceptet “radikalizëm” dhe “ekstremizëm”, pikë së pari pasi kjo lidhet me rezultate strategjike”. Në diskutimet e vazhdueshme rreth terrorizmit, termat “radikal” dhe “ekstremist” përdoren masivisht dhe shpesh të në vend të njëra tjetrës. Sipas Sedgwick (2010) termi “radikal” është shndërruar në një “fjalë standarde për të përshkruar çfarë ndodh përpara se të shpërthejë një “bombë”. Nga ana tjetër, termi “ekstrem” në një kuptim konvencional i referohet devijimit nga norma, ndonëse kaq nuk mjafton për të përkufizuar një kërcënim të sigurisë.

Duke iu referuar Fjalorit të Gjuhës Angleze të Oksfordit (Oxford English Dictionary), fjala “ekstremist”

përkufizohet si “një person i cili ka pikëpamje ekstreme politike ose fetare, veçanërisht dikush i cili mbështet veprime të paligjshme, të dhunshme apo ekstreme”.¹¹ Ndërsa një kuptim i fjalës “radikal” është “përfaqësimi apo mbështetja e një seksioni ekstrem të një partie”. Në këtë kontekst, termi “radikal” mund të përdoret si sinonim për “ekstremist” dhe antonim i “moderuar”. Sipas Sedgwick (2010), fjala “radikal” shërben për të treguar një pozicion relativ në një hapësirë opinioni të organizuar. Rrjedhimisht, fjala “radikalizim” nënkupton lëvizjen brenda kësaj hapësire. Përdorimi i këtij termi në kuptimin relativ duket jo problematik. Megjithatë, me të drejtë Sedgwick thekson se sipas këtij përkufizimi është e vështirë të dallosh apo heqësh vijën ndarëse midis një mendimi radikal dhe një mendimi të moderuar.¹²

“Radikalizmi” përdoret në literaturë në dy kuptime: atë të ngushtë dhe të gjerë të fjalës. Në kuptimin e ngushtë, theksi vihet mbi radikalizmin e dhunshëm, i cili konsiston në veprime aktive apo pranimin e dhunës si mjet për arritjen e objektivave të caktuara. Ndërsa në një kuptim më të gjerë të radikalizmit, vëmendja shtrihet mbi të gjitha veprimet aktive apo pranimin e ndryshimeve madhore në shoqëri, të cilat mund të përbëjnë ose jo në rrezik për demokracinë dhe mund të përfshijnë ose jo rrezikun apo përdorimin e dhunës për arritjen e objektivave të shpalosura.¹³ Megjithatë, në shumë raste termi “radikalizim” ngatërrohet me “terrorizëm”. Borum (2011) nënvizon se duhet mbajtur parasysh që shumica e njerëzve që

kanë bindje radikale nuk përfshihen në terrorizëm, dhe shumë terroristë – madje edhe ata që pretendojnë të ndjekin ndonjë “kauzë”, nuk janë njohës apo mbështetës të fortë të një ideologjie të caktuar dhe mund të mos “radikalizohen” në një kuptim tradicional. Për këtë arsye, edhe fokusimi ngushtësisht në togfjalëshin “radikalizim ideologjik” rrezikon të na drejtojë në arritjen e konkluzioneve të gabuara duke cilësuar bindjet radikale si tregues të nevojshëm të terrorizmit. Radikalizmi përmes zhvillimit dhe përfaqimit të bindjeve ekstremiste që justifikojnë përdorimin e dhunës është një mundësi drejt përfshirjes në terrorizëm, por sigurisht që nuk është e vetmja.¹⁴ Radikalizmi dhe rekrutimi për terrorizëm nuk kufizohen në një bindje politike apo fetare të vetme dhe kjo është faktuar nga llojet e ndryshme të terrorizmit që Evropa ka përjetuar përgjatë historisë.¹⁵ Shumica e qytetarëve evropianë, pavarësisht besimit të tyre, nuk përqafojnë ideologji ekstremiste. Për më tepër, vetëm pak prej tyre që kanë bindje ekstremiste përfshihen në terrorizëm.¹⁶ Rezultatet e sondazheve të kryera nga Gallup në dhjetë vende të ndryshme tregojnë se rreth 7% e popullsisë së përgjithshme të tyre janë mundësisht të prirur ndaj pikëpamjeve ekstremiste apo ‘radikalë’, ndonëse shumica e tyre nuk ushtrojnë dhunë.¹⁷ Sipas të dhënave të analizuara nga Atran (2010) një tregues i besueshëm për përfshirjen ose jo të dikujt në ekstremizëm të dhunshëm lidhet me faktin e të qenit pjesëtar i një grupi shokësh të përfshirë në një aktivitet të caktuar. Përfshirja në grupe dhe aktivitete terroriste lidhet me shumë arsye të ndryshme. Ideologjia dhe veprimi janë ndonjëherë të ndërlidhura, por jo gjithmonë. Nevojitet që të kuptojmë dallimet midis bindjeve radikale në vetvete dhe veprimeve të dhunshme.¹⁸

Studiues të ndryshëm kanë ofruar përkufizime të ndryshme mbi radikalizmin. Kështu, sipas McCauley dhe Moskalenko (2008) radikalizmi është “ekstremiteti në rritje i bindjeve, ndjenjave dhe sjelljeve në drejtim të justifikimit gjithmonë e më tepër të dhunës ndërmjet grupeve dhe kërkesës për sakrificë ndaj grupit”.¹⁹ Ndërsa sipas Crosset dhe Spitaletta (2010) radikalizmi nënkupton “procesin përmes të cilit një individ, grup njerëzish i nënshtrohen një transformimi nga pjesëmarrja në procesin politik me mjete të ligjshme në mbështetjen apo përdorimin e dhunës për qëllime politike.”²⁰ Duke e parë ekstremizmin e krijuar brenda vendit si një proces të vazhdueshëm të të mësuarit transformues, Wilner dhe Dubouloz (2010) sugjerojnë se “radikalizmi është një proces personal në të cilin individ i përshtat ideale dhe aspirata ekstreme politike, shoqërore, dhe/apo fetare, dhe ku arritja e objektivave të caktuar justifikon përdorimin pa dallim të dhunës”.²¹

Por a mund të konsiderohen të gjitha proceset radikalizuese dhe bindjet ekstreme si një kërcënim për sigurinë e një vendi apo më gjerë dhe, rrjedhimisht, të meritojnë vëmendjen dhe ndërhyrjen e agjencive ligjzbatuese? A nevojitet që ndërhyrja institucionale të kushtëzohet nga prania e dhunës së shfaqur në kuadër të ideologjive ekstreme dhe cila do të ishte rëndësia e këtyre ideologjive në mungesë të akteve të dhunës?

Përtej interpretimeve të doktrinave fetare, është e nevojshme që të shqyrtohen me kujdes të gjitha ideologjitë ekstremiste duke bërë dallimet midis tyre dhe veçuar ideologjitë, të cilat nxisin dhe lehtësojnë kalimin nga të menduarit radikal në të vepruar të dhunshëm.²² Kështu për shembull, Jordan dhe Boix

sugjerojnë disa elementë përkufizues për ideologjitë Islamike që mund të paraqesin një shqetësim për sigurinë, veçanërisht ata që janë përjashtuese apo anti-demokratike, që fajësojnë Perëndimin për të gjitha problemet e vendeve me shumicë myslimane, dhe mund të mbështesin (drejtpërdrejtë apo tërthorazi) ose tolerojnë akte terroriste. Sipas Borum (2011) “kjo duket të jetë një pikënisje e arsyeshme, të paktën për shtetet demokratike perëndimore”. Megjithatë, ai shton se “edhe sikur të injorohet larmishmëria e ideologjive të dhunshme nëpër botë dhe të limitohet fokusi në ideologjitë e Islamizmit militant, nuk do ishte e qartë se ku ndahej kufiri”.²³ Neuman (2010) gjithashtu pohon se ideologji ekstreme janë ato të cilat kundërshtojnë parimet dhe vlerat themelore të një shoqërie dhe në kontekstin e shoqërive demokratike liberale kjo do të përkthehej në propagandim të supremacisë raciale apo fetare dhe/apo kundërshtim të të drejtave universale të njeriut dhe parimeve themelore të demokracisë. Për më tepër, Neuman thekson se termi “ekstremist” mund të përdoret edhe për mënyrat e përdorura për arritjen e qëllimeve politike, të cilat karakterizohen nga mungesa e respektit për jetën, lirinë dhe të drejtat e tjetrit”.²⁴ Për të theksuar pasojën e dhunshme nga radikalizimi dhe në mënyrë që të bëhet dallimi nga forma jo të dhunshme të menduarit radikal disa studiues preferojnë të përdorin togfjalëshin “radikalizim i dhunshëm”.²⁵

Krahas përkufizimeve të mësipërme dhe të tjera të ofruara nga studiues të ndryshëm për termat “radikalizim” dhe “ekstremizëm i dhunshëm”, përkufizime të ngjashme janë krijuar edhe nga agjenci ligjzbatuese të shteteve evropiane për të lehtësuar punën e tyre në këtë drejtim. Kështu për shembull, Shërbimi Holandez

i Sigurisë (AIVD) e përkufizon radikalizmin si “gatishmëria në rritje për të ndjekur dhe/apo mbështetur edhe përmes mjeteve jo demokratike nëse është e nevojshme, ndryshime madhore në shoqëri, të cilat bien ndesh apo paraqesin rrezik për rendin demokratik”.²⁶ Ndërsa sipas Shërbimeve të Inteligjencës Daneze (PET), ‘radikalizmi i dhunshëm’ nënkupton ‘procesin përmes të cilit një person pranon në një masë të konsiderueshme përdorimin e mjeteve jo demokratike apo të dhunshme, duke përfshirë terrorizmin, në përpjekje për të arritur një objektiv të caktuar ideologjik ose politik’.²⁷ Ndërsa në strategjinë kundër terrorizmit të Mbretërisë së Bashkuar radikalizmi përkufizohet si “proces përmes të cilit njerëzit fillojnë të mbështesin ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, dhe në disa raste, u bashkëngjiten grupeve terroriste”.²⁸

Me gjithë mungesën e një përkufizimi të konceptit nga institucionet shqiptare, “rritja e radikalizmit fetar konsiderohet si një rrezik ndaj vlerave të harmonisë fetare në Shqipëri dhe që mund të shkaktojë tension shoqëror”. Megjithatë, ky rrezik klasifikohet i nivelit të dytë për sigurinë kombëtare, që do të thotë se ka gjasa të ulëta për t’u shfaqur, por do të kishte pasoja të larta për sigurinë.²⁹

4.2. RADIKALIZMI SI PROCES

Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk ndodhin brenda një dite. Në të shkuarën, studimet rreth terrorizmit përgjithësisht fokusoheshin mbi individin dhe përpiqeshin të jepnin shpjegime klinike mbi aktet terroriste të mbështetura në supozimin se ata reflektonin një farë çrregullimi mendor apo të personalitetit të personit. Në këtë mënyrë, shumë studiuës përpiqeshin të identifikonin një profil unik të personave të ‘çmendur’, të cilët përfshiheshin në akte terroriste.³⁰ Në ditët e sotme, supozimet të tilla janë braktisur dhe terrorizmi nuk trajtohet më si një ‘gjendje e caktuar’ por si një ‘proces dinamik’.³¹ Megjithëse në literaturë njihet koncepti i ‘radikalizmit të vetë-nisur apo të vetë-kontrolluar’ i cili lidhet me vullnetin dhe zgjedhjen personale për të frekuentuar ose refuzuar grupe dhe mjedise të caktuara, pjesa dërrmuese e studimeve dhe raporteve zyrtare në këtë fushë e konsiderojnë radikalizmin si një proces të vazhdueshëm ndërveprimi midis individit dhe influencave të jashtme, siç mund të jenë propaganduesit dhe rekrutuesit, veprimet e autoriteteve publike dhe situatat shoqërore, politike dhe ekonomike.³²

Studiuës dhe ekspertë të agjencive ligjzbatuese të vendeve të ndryshme kanë propozuar të paktën pesë modele sipas të cilave mund të ndodhë procesi i radikalizimit. Këto modele janë të strukturuar sipas një vijimësie fazash, ngjarjesh apo çështjesh të cilat mund të na ndihmojnë të kuptojmë se si njerëz të ndryshëm fillojnë të përqafojnë ideologji ekstremiste të dhunshme (radikalizohen), t’i përkthejnë ato (ose jo) në justifikime apo nevojë për përdorimin e dhunës dhe terrorit, si dhe

të zgjedhin (ose jo) të përfshihen në veprime të dhunshme dhe aktivitetet të kryera në shërbim të këtyre ideologjive.³³ Sipas këtyre modeleve, radikalizmi shihet si një “rrugëtim” apo “transformimi psikologjik” i një individi apo grupi personash dhe jo si produkt i një vendimi të vetëm të marrë në një moment të caktuar.³⁴ Megjithatë, duhet mbajtur parasysh se studimet dhe raportet e shkruara deri më tani mbi procesin e radikalizmit janë më tepër konceptuale sesa empirike.³⁵

Një prej modeleve më të njohura të procesit të radikalizmit është ai i ofruar nga Departamenti i Policisë së Nju Jorkut, i njohur si modeli i *radikalizmit Salafist-Xhihadist*. Sipas këtij modeli, qytetarë të shteteve perëndimore përqafojnë ideologjinë Salafi-Xhihadiste përmes një procesi linear të përbërë nga katër faza të ndryshme. Këto faza përfshijnë: 1) *Para-radikalizmi* i cili karakterizon periudhën përpara ekspozimit të një individi ndaj ideologjisë Salafi-xhihadiste; 2) *Vetë-identifikimi* gjatë të cilës personi fillon të zbulojë dhe përqafojë rrymën Salafiste dhe të njihet me ndjekës dhe mbështetës të saj; 3) *Indoktrinimi* është faza e intensifikimit, si për forcimin e besimit në këtë ideologji ashtu edhe përkushtimin ndaj saj me ide, veprime dhe ndaj grupit të mbështetësve të tjerë; 4) *Xhihadizmi* është faza përfundimtare e cila shënon pranimin dhe përkushtimin ndaj detyrës personale për të vepruar në emër të kauzës.³⁶ Një model i ngjashëm është propozuar edhe nga Precht (2007) i cili sugjeron se fazat përmes të cilave ndodh radikalizmi janë: 1) *Para-radikalizmi*; 2) *Konvertimi dhe identifikimi me Islamin radikal*; 3)

Indoktrinimi dhe forcimi i lidhjeve në grup; dhe 4) Planifikimi apo kryerja e akteve terroriste. Për më tepër, Precht thekson se dinamika brenda grupeve të vogla dhe identifikimi janë shpesh stimuj të fuqishëm të përkushtimit ndaj ideologjisë ekstremiste.³⁷

Një tjetër model i radikalizmit si proces është ai i propozuar nga Borum (2003), i cili përshkruan një "rrugëtim" psikologjik tipik përmes të cilit individët zhvillojnë dhe përshtatin ideologji që justifikojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.³⁸ Sipas tij, ky proces kalon nëpër katër faza. Në fazën e parë, personi gjykon situatën e tij si të padëshirueshme. Më pas, personi fillon të krahasojë situatën në të cilën ai ndodhet me kushtet më të favorshme të personave/grupeve të tjera dhe e konsideron këtë pabarazi si të padrejtë dhe të paligjshme. Disa persona do fajësojnë një grup tjetër personash për kushtet e paligjshme të grupit të tyre. Ky grup personash ka mbërritur kështu në fazën e tretë e cila konsiston në fajësimin e një grupi tjetër dhe zhveshjen e këtij grupi nga vlerat njerëzore. Në fazën e fundit, ndaj grupit të personave të fajësuar fillojnë dhe krijohen stereotipe negative që përfshijnë të gjithë anëtarët e grupit. Në këtë fazë, dhuna konsiderohet legjitime pasi drejtohet ndaj një grupi të keq, i cili është përgjegjës për të gjitha padrejtësitë e perceptuara.

Teoria e anëtarësimit në një grup ekstremist është një tjetër model i radikalizmit si proces i propozuar nga Viktorowicz (2004).³⁹ Megjithëse termi 'radikalizëm' nuk përmendet më vete aspak, kjo teori shpjegon se si një person i bashkohet një grupi ekstremist fetar duke ndjekur katër procese. Këto procese janë: 1) hapja njohëse; 2) kërkimi fetar; 3) rreshtimi dhe 4) shoqërimi. Faza e parë, 'hapja njohëse' është shpesh rezultat i një

krize personale që e bën personin të ndjeshëm ndaj ideve të cilat me shumë gjasa do të injoroheshin përpara krizës së pësuar. Kriza mund të nxitet nga ngjarje në sfera të ndryshme të jetës së personit, si për shembull humbja e vendit të punës, përjetime të diskriminimit apo viktimitimit. Sipas autorit të kësaj teorie, kriza mund të precipitohet edhe për shkak të bisedave me anëtarë të një grupi ekstremist fetar. Në fazën e dytë – 'kërkimi fetar', ndjeshmëria e personit drejtohet për nga besimi fetar. Ky kërkim fetar dhe ndjeshmëri bëjnë që personi me shumë gjasa të fillojë të marrë në konsideratë pikëpamjet mbi botën të promovuara nga grupet ekstremiste. Përmes debatit dhe eksplorimit të këtyre pikëpamjeve, personi mbërrin në fazën e tretë – 'rreshtimi', gjatë të cilës duket sikur pikëpamjet e personit dhe të grupeve ekstremiste përkojnë. Në mënyrë që kjo të ndodhë, nevojitet që personi i radikalizuar të ushqejë një farë respekti për ekspertizën fetare të personave që promovojnë këta pikëpamje. Në fazën përfundimtare – 'shoqërimi dhe anëtarësimi', personi i bashkëngjitet grupit zyrtarisht, përqafon ideologjinë e tyre, dhe përshtat identitetin e grupit. Ideologjia dhe identiteti i grupit ruhen përmes kontakteve të vazhdueshme me anëtarë të tjerë të grupit, duke u tërhequr në të njëjtën kohë prej shoqërisë së mëparshme. Megjithëse ndërveprimet ballë-për-ballë janë më të fuqishme, shoqërimi mund të ndodhë edhe përmes internetit, si për shembull përmes rrjeteve sociale apo dhomave të 'chat-it'. Në këtë fazë, ideologjia e grupit është përvetësuar dhe identiteti i individit është riformuluar.

Në kontrast me modelet e mësipërme të cilat shfaqen në vijë lineare dhe ndjekin faza të caktuara, Marc Sageman sugjeron se procesi i radikalizmit ndodh kur ndërthuren katër faktorë të ndryshëm.⁴⁰ Tre prej këtyre faktorëve

mund të konsiderohen njohës, ndërsa faktori i katërt paraqitet rrethanor. Një faktor njohës që çon drejt radikalizmit është ndjesia e nëpërkëmbjes apo dhunimit moral, e cila është rezultat i perceptimit të ngjarjeve të ndryshme si shkelje morale. Një shembull konkret i kësaj mund të jetë reagimi ndaj pushtimit të Irakut, i cili sipas agjencive të shërbimit informativ konsiderohet si 'mjeti kryesor i rekrutimit nga ekstremistët e dhunshëm Islamikë'.⁴¹ Një tjetër faktor njohës është korniza përmes të cilës shihet dhe interpretohet bota. Një kornizë e tillë e përdorur nga ekstremistët e ditëve të sotme është ajo e 'luftës kundër Islamit' prej Perëndimit. Faktori i tretë njohës është rezonanca me përvojat personale. Këto përvoja janë dhunime morale të personit, si, për shembull, diskriminimi apo papunësia. Këta tre faktorë njohës forcojnë njëri-tjetrin. Përjetimet personale të nëpërkëmbjes morale e bëjnë një person të ndjeshëm ndaj diskriminimit të vuajtur nga personat e tjerë. Të gjitha këto së bashku

mund të përforcojnë perceptimin e një konspiracioni për sulm global ndaj Islamit. Përveç këtyre faktorëve, Sageman thekson se ndërveprimi midis personave të të njëjtit mendim është thelbësor për radikalizmin që të ndodhë si proces. Ai këtë grup personash me të njëjtat ide e quan 'një grumbull djemsh' apo 'mobilizimi përmes rrjeteve'. Ky faktor i fundit shërben për të vleftësuar dhe përforcuar me personat e tjerë të radikalizuar idetë dhe interpretimet e individit.

Së fundmi, McCauley dhe Moskalenko (2008) propozojnë një model shumë të gjerë, i cili përfshin 12 mekanizma radikalizmi që shtrihen në planin individual, të grupit dhe masës së gjerë. Shkurtimisht, këto mekanizma fillojnë me përvojat personale të viktimizimit, forcohen me anëtarësimin në grupe të përbëra nga persona me pikëpamje ekstremiste dhe kulmojnë me "martirizimin", i cili shënon dëshminë e besnikërisë më të lartë ndaj kauzës.⁴²

4.3. SHKAQET THEMELORE TË RADIKALIZMIT

Në literaturë ekzistojnë teori të ndryshme, të cilat përpiqen të shpjegojnë shkaqet themelore të radikalizmit. Në raportin e tyre, Crosssett dhe Spitaletta (2010) numërojnë dhe bëjnë një përmbledhje të 16 teorive të tilla. Për analizën e tij, Borum (2011) mbështetet vetëm mbi tre teori të ndryshme për të shpjeguar shkaqet e radikalizmit, të cilat janë: teoria e lëvizjes sociale, psikologjia sociale dhe teoria e konvertimit.

Teoria e lëvizjes sociale përpiqet përgjithësisht të shpjegojë arsyet e mobilizimit shoqëror, format në të cilat ai shfaqet dhe pasojat potenciale që mund të vijnë në rrafshin shoqëror, kulturor, politik dhe ekonomik. Sipas kësaj teorie, ideologjitë mund të zhvillohen deri në atë masë që kapërcejnë kufijtë e një grupi të caktuar.

Ndërsa teoria e psikologjisë sociale

thekson rëndësinë e situatave të caktuara dhe ndërveprimit shoqëror, influencës dhe konflikteve në nivel kolektiv. Sipas një prej pionierëve të hershëm të kësaj teorie, Gordon Allport, “psikologjia sociale përpiqet të kuptojë dhe shpjegojë se si mendimet, ndjenjat dhe sjellja e individëve ndikohen nga prania reale, e imagjinuar apo e nënkuptuar e të tjerëve”. Në ndryshim nga teoria e parë, e cila ka një dimension më të gjerë, teoria e psikologjisë sociale fokusohet në proceset influencuese në nivel grupi. Disa nga kontributet kryesore të kësaj teorie lidhen me shpjegimin e qëndrimeve ekstreme të kultivuara brenda grupit (“polarizimi i grupit”), vendimmarrjen e anshme dhe më pak të arsyeshme të grupit në përpjekje të gjetjes së konsensusit të përbashkët, gjykimet e njëanshme përgjithësisht pozitive për pjesëtarët e grupit dhe negative për ata jashtë tij, fuqinë e grupit për të diktuar norma dhe pritshmëri për sjelljen e anëtarëve, motivet dhe përfitimet e pritshme nga pjesëmarrja në grup dhe ndjenja e një përgjegjësie më të vogël prej individëve për veprimet e “grupit”.

Teoria e tretë fokusohet më tepër në nivel individual dhe përpiqet të shpjegojë procesin e transformimit të bindjeve dhe ideologjive të një personi- i konsideruar si ‘konvertim’. Teoria e konvertimit mbështetet mbi dekada studimesh në disiplinat e sociologjisë dhe psikologjisë së fesë. Sipas Lewis Rambo (1993), konvertimi ndodh sipas një procesi të përbërë nga shtatë komponentë apo ‘faza’ të cilat ndikojnë tek njëra tjetra, si më poshtë:

- i. Konteksti: përfshin fushën e faktorëve të mjedisit rrethues- kulturorë, historikë, politikë, dhe shoqërorë që veprojnë përgjatë procesit të konvertimit dhe mund të nxisin apo pengojnë zhvillimin e tij.

- ii. Kriza: është një gjendje personale çekuilibri e shkaktuar zakonisht nga ndonjë problem personal apo shoqëror.
- iii. Kërkimi: pas një krize të pësuar fillon procesi i kërkimit për zgjidhje dhe aktivitete që do të rikthenin ekuilibrin e mëparshëm.
- iv. Takimi: shënon kontaktin fillestar midis një kërkuesi (personi të përfshirë në ‘kërkim’) dhe një mundësie apo frymëzuesi shpirtëror.
- v. Ndërveprimi: përshkruan shkëmbimin midis kërkuesit dhe udhëheqësit shpirtëror për të zhvilluar më shumë informacion rreth opsionit shpirtëror dhe për tu njohur me persona të tjerë.
- vi. Përkushtimi: përfshin dy elementë të rëndësishëm, së pari vendimin apo serinë e vendimeve që dëshmojnë investim apo besnikëri ndaj besimit; dhe së dyti, një zotim për lidhje të fortë me grupin dhe deklaram publik të besimit, gjë e cila konsolidon statusin e personit si pjesë e lëvizjes.
- vii. Pasoja: janë efektet e veprimeve, angazhimeve dhe vendimeve të marra në shërbim të besimit. Ata monitorohen dhe vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme.

Sipas L. Rambo, gjatë procesit të konvertimit ‘marrëdhëniet, ritet, retorika dhe rolet e caktuara ndërveprojnë dhe përforcojnë njëra tjetrën. Në literaturë bëhet dallimi midis faktorëve ‘shtytës’ dhe ‘tërheqës’ të radikalizmit me qëllim identifikimin e faktorëve të ndryshëm që ndërveprojnë në situata

të ndryshme dhe nevoja për të kuptuar më mirë natyrën dhe rëndësinë e tyre. Kështu, për shembull, kontakti dhe shoqërimi me një rekrutues karizmatik mund të ndikojë mbi individin duke e tërhequr atë drejt radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Faktorë të tjerë si, viktimizimi dhe përjetimi i dhunës, përfshirë atë të ushtruar nga agjencitë ligjzbatuese, mund ta bëjnë një person vulnerabël ndaj 'tërheqjes' së ekstremizmit të dhunshëm, duke e shtyrë atë drejt radikalizmit dhe akteve të dhunës.⁴³

Në mënyrë të përmbledhur, konstatohen tre grupime kryesore të studiuesve dhe shpjegimeve mbi faktorët që ndikojnë në radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Në grupin e parë përfshihen ata studiues të cilët punojnë brenda traditës së sociologjisë franceze. Këtu mund të përmendim Gilles Kepel, Fahrhad Khosrokhavar dhe Oliver Roy, të cilët në përpjekjet për të shpjeguar radikalizmin në Evropë fokusohen gjerësisht mbi Islamizmin si një fenomen politik, shoqëror dhe ekonomik. Ata theksojnë se radikalizmi nuk është thjesht një çështje e reagimit ndaj shtypjes politike dhe privimit ekonomik. Sipas tyre, radikalizmi ndodh si pasojë e përpjekjeve të individit për të rindërtuar identitetin e humbur në një botë antagonistë, e cila perceptohet si armiqësore.⁴⁴ Ky terren i favorshëm për radikalizmin është krijuar sipas tyre nga faktorë të përgjithshëm sociologjikë, si globalizmi dhe shpërbërja e komuniteteve dhe identiteteve tradicionale. Faktorë të tjerë konsiderohen marginalizimi socio-ekonomik, mungesa apo edukimi i dobët, mungesa e solidaritetit në komunitet dhe presioni shoqëror.⁴⁵ Sipas sociologëve francezë, një grup radikal duket sikur ofron kompensim për ndjenjën e identitetit dhe komunitetit të munguar dhe mund

të shërbejë si mjet për të kërkuar të drejtën për dinjitet dhe vetë-përcaktim-një 'zgjidhje' e përqaftuar vetëm nga një pakicë e vogël e myslimanëve në të gjithë botën.⁴⁶

Grupi i dytë i studiuesve, të cilët punojnë mbi teorinë e lëvizjes sociale apo 'teoria e rrjetit', i mbështesin argumentet e tyre mbi faktorë që shfaqen në nivel grupi, siç janë dinamikat dhe ndërveprimet e ndryshme në rrjetet shoqërore. Sipas këtyre studiuesve, thelbi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm ka të bëjë me personat që njej dhe shoqërohesh-identetë radikale transmetohen përmes rrjeteve shoqërore dhe ekstremizmi i dhunshëm shfaqet ndër grupe të vogla në të cilat lidhja, presioni i grupit dhe indoktrinimi ndryshojnë gradualisht pikëpamjet e personit mbi botën. Siç është përmendur dhe më sipër, një nga pionierët e kësaj teorie është Viktorowicz, i cili e konsideron radikalizmin si një proces përmes të cilit pikëpamjet ekstremiste të anëtarëve të grupit dhe ato të individit mbi mënyrën si e sheh botën fillojnë të përkojnë dhe përputhen.⁴⁷ Kjo njihet dhe si 'konturimi' apo 'rreshtimi' i pikëpamjeve personale në përputhje me ata të grupit. Megjithatë, studiuesit e 'teorisë së rrjetit' nuk arrijnë të japin të dhëna empirike dhe të shpjegojnë se çfarë i bën disa individë më të cenueshëm apo rezistentë ndaj ekstremizmit të dhunshëm në krahasim me persona të tjerë.

Grupi i tretë i studiuesve përpjek të plotësojë këtë handicap duke punuar me raste studimore praktike, të cilat u mundësojnë identifikimin e faktorëve të ndryshëm që veprojnë në nivel individual. Faktorë të tillë konsiderohen nevojat, motivet apo prirjet e veçanta të çdo personi. Megjithëse asnjë nga teoritë aktuale nuk mund të japë një shpjegim se çfarë i bën disa persona më të ndjeshëm / të mbrojtur ndaj radikalizmit në krahasim me të tjerët,

studiuesit e grupit të tretë kanë ofruar shpjegime empirike të vlefshme mbi arsyet personale të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Kështu, disa prej faktorëve që veprojnë në nivel individual përmenden: kërkesa për respekt, kuptim, stabilitet dhe status shoqëror, arritje të dobëta në shkollë, histori krimesh të lehta, besim fetar i heshtur por intensiv, vetë-izolimi dhe mungesa e besimit në aftësinë personale për të kontribuar në ndryshime efektive përmes rrugëve të ligjshme etj.⁴⁸

Duhet thënë se të tre grupimet e mësipërme të studiuesve kanë meritën e ofrit të shpjegimeve mjaft të vlefshme rreth faktorëve të radikalizmit, qofshin këta në nivel makro, të mesëm apo mikro. Me të drejtë Precht në analizën e tij pohon se "përgjithësisht, ky fenomen mund të shihet si dukuri shoqërore në të cilën çështje si përkatësia, identiteti, dinamikat e grupit dhe vlerat janë elementë të rëndësishëm në procesin e transformimit". Feja, sipas tij, luan një rol të rëndësishëm, megjithëse për disa persona shërben më tepër si mjet për përmbushjen e qëllimeve të tjera. Një emërues i përbashkët për të gjithë faktorët e radikalizmit të personave dhe përfshirjes së tyre në ekstremizëm të dhunshëm është fakti se ata janë në udhëkryq dhe kanë nevojë për një kauzë".⁴⁹

Ky hulumtim dhe raport i IDM sugjeron se radikalizmi duhet parë si një seri procesesh të larmishme me anë të cilave individë të ndryshëm fillojnë të adoptojnë bindje që jo vetëm justifikojnë dhunën por e propagandojnë atë, dhe synon të zbulojë mënyrat se si dhe pse një pjesë e personave me bindje radikale përfshihen ose jo në ekstremizëm të dhunshëm. Kjo nuk është një detyrë e thjeshtë për një studim, teori apo disiplinë të vetme. Çdo përpjekje serioze dhe e dobishme duhet të marrë nën shqyrtim një shumëllojshmëri faktorësh dhe mekanizmash, të cilat veprojnë në nivel makro (shoqërore, politike, kulturore, etj.), rrjeti/grupi dhe mikro (individuale). Qasja e duhur duket ajo "zhvillimore", e cila e shikon radikalizimin si "produkt jo të një vendimi të vetëm por rezultat përfundimtar i një procesi dialektik që shtyn gradualisht një individ të përkushtohet ndaj dhunës me kalimin e kohës".⁵⁰ Është e rëndësishme që të formojmë dhe zotërojmë një kuptim sa më të plotë të mënyrës se si zhvillohet ky proces tek një individ si dhe brenda dhe ndërmjet grupeve të ndryshme në mënyrë që të jemi në gjendje të zhvillojmë politika dhe praktika efikase në zbutjen dhe parandalimin e përhapjes së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

4.4. TIPOLOGJI E GRUPEVE RADIKALE

Empiristët, përveç sa më sipër, kanë kontribuar edhe në kuptimin më të mirë të tipeve të ndryshme të aktivistëve që përbëjnë grupet radikale dhe rolet e ndryshme që ata kanë. Peter Nesser, një prej studiuesve më të hershëm

dhe të njohur me qasje empirike në këtë fushë, pohon se profilet socio-ekonomike të anëtarëve të këtyre grupeve janë të larmishme. Bazuar në punën e tij mbi raste studimore të një numri celulash terroriste të zbuluara

në Evropë, Nesser ka identifikuar disa lloje personalitetesh dhe rolesh brenda këtyre grupeve. Sipas tij, Drejtuesi është zakonisht një person karizmatik dhe idealist, mjaft i interesuar rreth politikës dhe me karakter aktivist. Ndjekësi, është një person i ri në moshë, inteligjent, dhe ndonjëherë i kompletuar në aspektin e edukimit apo të një zanati, i cili e admiron drejtuesin e grupit dhe ndan me të tjerët mendësinë e tij aktiviste. Problematiku është personi me një të shkuar problematike, ndoshta i përfshirë në krime të lehta apo përdorim drogash. Shëtitësi është personi që i bashkëngjitet grupit përmes lidhjeve shoqërore me individë që janë të lidhur drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë me grupin. Arsyet se përse ky person i bashkohet grupit janë të ndryshme dhe në të përfshihet besnikëria ndaj miqve, presioni i grupit shoqëror, ndonjë takim i rastësishëm me rekrutuesin karizmatik apo edhe dëshira për 'aventurë'. Arsyet dhe motivet që kanë shtyrë personat e mësipërm t'i bashkohen grupit janë të ndryshme.⁵¹ Sipas Nesser, Drejtuesi është figura kyçe dhe forca shtytëse pas rekrutimit dhe radikalizmit në Evropë.⁵²

Po ashtu, Slooman dhe Tillie (2006) kanë ofruar detaje të tjera rreth profileve, roleve dhe motiveve të pjesëtarëve të ndryshëm të grupeve radikale. Duke u mbështetur në informacionin e përftuar nga intervista në terren, këta studiues kanë identifikuar tre motive kryesore të radikalizmit. Kështu, disa persona radikalizohen si rezultat i përpjekjeve për të fituar respekt, stabilitet dhe kuptim. Këta janë zakonisht individë, të cilët kanë pasur rezultate të dobëta në shkollë dhe kanë qenë të përfshirë në krime të lehta. Përkatësia në një grup radikal u ofron atyre një kuptim qenësor dhe respekt nga ambienti rrethues. Për ta, veshja dhe identifikimi

si muxhahedin afgan është diçka e veçantë dhe karakterizohen nga përfshirja në një nënkulturë ku spikasin fjalori dhe këngët e luftës. Motivi i dytë pas radikalizmit është nevoja për të pasur një grupim shoqëror, komunitet me të cilin identifikohesh. Personat që radikalizohen për këtë arsye, sipas studiuesve, janë të rinj të cilët më parë nuk kanë qenë të shoqërueshëm dhe karakterizohen nga një stil i devotshëm jetese dhe besim fetar të heshtur por intensiv. Këta persona fitojnë ndjesinë e një komuniteti shoqëror dhe pranimin nga shoqërimi me një grup të ngushtë "vëllezërish". Së fundmi, disa persona radikalizohen për shkak të perceptimeve për padrejtësi të bëra ndaj myslimanëve në zona të ndryshme si Afganistan, Territorët Palestinezë, etj. Zakonisht, janë këta persona të cilët drejtojnë grupin në aspektin shoqëror dhe intelektual. Drejtuesit janë kryesisht persona të kompletuar, të mirë arsimuar, relativisht më të mëdhenj në moshë, me më shumë njohuri rreth shkrimeve fetare, njohës më të mirë të gjuhës arabe dhe përgjithësisht më të sigurt në vetvete se pjesa tjetër e grupit. Drejtuesit janë më të ndërgjegjshëm politikisht dhe ideologjikisht dhe drejtojnë mënyrën e të menduarit mbi çështje të fesë, politikës dhe përdorimit të dhunës nga pjesëtarët e tjerë të grupit. Ata përcaktojnë se cilat burime duhen konsultuar për një mendim më "autoritar" për çështje të fesë dhe udhëzojnë pjesëtarët e grupit të lexojnë materiale të përzgjedhura, të cilat mbështesin një interpretim shumë strikt dhe të dhunshëm të Kuranit. Drejtuesit shpenzojnë shumë kohë duke kritikuar interpretime të ndryshme jo të dhunshme të Kuranit. Ndryshe nga pjesëtarët e tjerë të grupit, drejtuesit janë përgjithësisht elokuentë, koherentë dhe të menduar në shprehjen e pikëpamjeve të tyre.

Slooman dhe Tillie theksojnë se,

megjithëse anëtarët e grupit radikal mund të mos i kenë mjaft të forta bindjet dhe pikëpamjet radikale, dalëngadalë ata veçohen nga shoqëria dhe izoloohen brenda grupit. Shpesh ata përzihen nga xhamitë për shkak të frikës së përhapjes së pikëpamjeve të tyre ekstreme dhe kanë gjithmonë e më pak kontakt me persona që mendojnë ndryshe prej tyre. Ky izolim forcon akoma më tej pikëpamjet e tyre ekstreme dhe ambienti që i rrethon shihet gjithmonë e më shumë si i korruptuar dhe armiqësor. Sipas këtyre studiuesve, të rinjtë nuk radikalizohen për shkak të imamëve, prindërve, kërkimit në internet apo përpjekjeve të tyre për të gjetur vetë materiale dhe propagandë ekstremiste. Radikalizmi i tyre ndodh për shkak të ndërveprimit të vazhdueshëm me një person me influencë mbi ta, si p.sh. një lider karizmatik, i afërm apo shok i besuar dhe njëkohësisht izolimit në rritje nga pjesa tjetër e shoqërisë.⁵³

5



RIKTHIMI I FESË DHE
LUFTA KUNDËR
RADIKALIZMIT:
SHQIPËRIA NË 25
VJET

5.1. NEVOJA EMERGJENTE DHE REAGIM SPONTAN NDAJ SFIDAVE TË PAPRITURA

Pas një periudhe të gjatë armiqësie të shtetit ndaj bashkësive fetare gjatë sundimit komunist,⁵⁴ sfidat e fillim-viteve 1990 për rikthimin e institucioneve fetare dhe ndërtimin e komuniteteve të besimtarëve ishin jashtëzakonisht të mëdha. Jo vetëm mungesa e infrastrukturës dhe konfliktet e pronësisë mbi atë ekzistuese, por edhe mungesa e institucioneve të arsimit dhe personelit fetar përbënin vështirësi të mëdha në këtë rrugë. Të përballur me probleme të rënda ekonomike dhe sfidat shoqërore të periudhës së tranzicionit, rikthimi i "besimtarit fetar" ishte një sfidë më vete. Nga ana tjetër, përpjekjet e brishta në proceset e demokratizimit, ndërtimit të institucioneve dhe shtetit të së drejtës menjëherë pas rënies së komunizmit u goditën edhe nga kriza e vitit 1997 që kaploi Shqipërinë, çka bëri që shteti të ishte një lojtar i dobët për të ndihmuar institucionet fetare në trajtimin e sfidave të tyre gjatë viteve 1990.

Si komuniteti më i madh fetar në vend, sfidat dhe nevojat e Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH) ishin qartësisht më të mëdha. Si pasojë, shumë organizata të huaja, fondacione fetare dhe humanitare, dhe aktorë të tjerë hynë në "skenë" në fillim të viteve 1990 për të ndihmuar institucionet fetare për të ringritur komunitetet e besimtarëve, për të ndërtuar infrastrukturën ose për të ofruar arsimin për brezin e ri të klerikëve fetarë, kryesisht jashtë vendit. Kriza e refugjatëve nga Kosova (1998) i dha një tjetër shtysë pranisë së fondacioneve fetare në vend, disa prej të cilave mendohej se kishin lidhje me

organizatat terroriste.⁵⁵ Ndërkohë që Shqipëria po bënte ende përpjekje për të kapërcyer statusin e saj si "shtet i dobët", organizatat e huaja fetare mbetën jashtë çdo procesi monitorimi apo "verifikimi" nga ana e autoriteteve shtetërore dhe, madje edhe më pak, nga ana e institucioneve fetare shqiptare "që ishin në zhvillim e sipër".⁵⁶ Në vitet e mëvonshme vetë KMSH u përball me sfida të brendshme, jo vetëm për shkak të mungesës së burimeve, por edhe për shkak të "përplasjeve" midis traditës vendase Hanefi dhe ideologjive salafiste që u sollën nga fondacionet e huaja fetare dhe të rinjtë shqiptarë (të kthyerit) të arsimuar tashmë në vende si Arabia Saudite dhe Egjipti.

Edhe pse disa ngjarje të vogla e të izoluara në mesin e viteve 1990 po sinjalizonin tashmë ndikimin që vinte nga qendra të caktuara të huaja fetare (p.sh., incidentet në komunën Bradashesh në 1994, Voskopojë 1996, në Myftininë e Elbasanit 1997), reagimi i autoriteteve shtetërore ishte mjaft i dobët. KMSH ndaloi shkollën "El Faruk" në Cërrik (1994) ndërkohë që vazhdonte të luftonte me qendra salafiste në Elbasan. Shenjat e para të përqsjes dhe përgjigjes më të vëmendshme të shtetit, më së shumti në sajë të bashkëpunimit me partnerët e huaj, vijuan në gjysmën e dytë të viteve 1990 dhe arritën kulmin me arrestimin e një celule të xhihadit islamik egjiptian dhe mbylljen e një sërë fondacionesh islamike që operonin në Shqipëri. Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001, që transformuan tërësisht çështjen e terrorizmit, duke e kthyer atë nga një

kërcënim rajonal në kërcënim global, autoritetet shtetërore shqiptare e kanë trajtuar këtë problem deri më sot më shumë në formë reagimi sesa me masa parandaluese.

Rrjedhimisht, aktorët kryesorë dhe të vetëm në anën e autoriteteve shtetërore për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin fetar gjatë kësaj periudhe kanë qenë agjencitë e zbatimit të ligjit. Për sa i përket parandalimit, janë ndërmarrë shumë pak ose pothuajse asnjë veprim. Pavarësisht ecurisë mjaft të mirë, Komuniteti Mysliman

Shqiptar nuk ka arritur veçse rezultate modeste në këtë drejtim. Debati në shoqërinë civile dhe veprimtaria e kësaj të fundit për sfidat mbi radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm të bazuar në ideologji fetare kanë qenë më tepër një përjashtim sesa një fokus tipik. Në përgjithësi, përpjekjet e aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë kanë qenë kryesisht "marketingu" i harmonisë fetare në vend. Këto përpjekje kanë qenë larg një qasjeje të strukturua për të kuptuar dhe mbështetur në mënyrë aktive faktorët që mundësojnë harmoninë fetare.

5.2. RADIKALIZMI FETAR NË SHQIPËRI: KUADRI I NJË DUKURIE NË FAZËN E HERSHME

Vlera e harmonisë dhe bashkëjetesës fetare prej shumë kohësh është marrë si e mirëqenë në Shqipëri. Pothuajse asnjëherë nuk është bërë një debat publik gjithëpërfshirës dhe i informuar për marrëdhëniet mes shtetit, bashkësive fetare dhe shoqërisë në tërësi si dhe për kërcënimet ndaj bashkëjetesës fetare në vend. Nga ana tjetër, mbi-mediatizimi i rasteve të përfshirjes së qytetarëve shqiptarë në konfliktin sirian rrezikon të dëmtojë këtë vlerë nëse nuk shoqërohet me "veprime të informuara" nga të gjithë aktorët. Më e rëndësishmja, harmonia fetare do të goditet rëndë nëse radikalizimi fetar apo ekstremizmi i dhunshëm i "fshihen" debatit dhe vëmendjes së aktorëve kryesorë, apo edhe më keq, nëse identifikohen si "simptoma kalimtare" dhe trajtohen vetëm në aspektin e sigurisë.⁵⁷

Edhe pse perceptimi i përgjithshëm është se radikalizimi është një "episod" i izoluar i qytetarëve shqiptarë që i bashkohen konfliktit në Siri apo i kufizuar tek veprimtaria e xhamive të paligjshme, si ajo në Mëzez apo Xhamia e Unazës në Tiranë, pjesa më e madhe e të intervistuarve të informuar (zakonisht ekspertët, profesionistët dhe përfaqësues të tjerë nga agjencitë e zbatimit të ligjit, media investigative, bota akademike dhe organizatat kërkimore) sugjerojnë se ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi fetar në fazën aktuale mund të kategorizohen si një "dukuri në fazën e hershme". Disa prej tyre argumentojnë se Shqipëria po shfaq shenja të tefkirizmit ndërkohë që përfaqësues nga KMSH priren ta minimizojnë rëndësinë apo seriozitetin e kësaj dukurie në Shqipëri. Megjithatë, pavarësisht "fazës së hershme" të radikalizimit fetar, të anketuarit e

mirë-informuar në intervistat gjysmë të strukturuar sugjerojnë se analiza duhet të marrë parasysh elementët e mëposhtëm:

1 Së pari, edhe pse Shqipëria i përket traditës hanefi të Islamit, një pjesë e konsiderueshme e klerikëve të KMSH-së në xhami vijnë nga shkolla më konservative.⁵⁸ Ndryshe nga pjesa më e madhe e këtyre klerikëve, disa prej tyre nuk janë përshtatur me traditën hanefi të Islamit, duke propaganduar kështu një traditë më konservatore. Përpyqjet e KMSH-së për t'i "përshtatur" ata janë minuar shpesh nga divergjencia të fshehura e të vazhdueshme brenda vetë KMSH-së.⁵⁹ Shumë informues kyçë argumentojnë se tensione të tilla të brendshme mund të përdoren nga grupet radikale për të shkaktuar një çarje mes xhemitit në nivel vendor.

2 Së dyti, edhe pse salafizmi/uahabizmi nuk mund të konsiderohen si lëvizje tipike në Shqipëri, ndër të tjera edhe për shkak të mungesës së një udhëheqësi shpirtëror, kontestimi i autoritetit të KMSH-së mund të çojë në manipulimin e komunitetit të xhemitit. Disa nga informuesit kryesorë të këtij studimi sugjerojnë se "ekzistenca e xhamive të paligjshme dhe rastet e izoluara të klerikëve brenda KMSH-së që propagandojnë Islamin konservativ sugjeron se 'kontestimi i autoritetit të KMSH-së' është mbështetur të paktën me mjete financiare për të bërë diçka të tillë." Shumë nga shqiptarët e kthyer që kanë studiuar dhe janë ndikuar nga ideologjitë salafiste/uahabiste kanë përfituar mbështetje (financiare) nga fondacione të huaja fetare jo vetëm gjatë periudhës së studimeve por edhe pasi janë kthyer në Shqipëri.⁶⁰

3 Së treti, intervistat me informuesit kyç konfirmojnë faktin se tradita konservative e Islamit nuk gëzon mbështetje të gjerë nga komuniteti i besimtarëve myslimanë. Megjithatë,

izolimi (veçanërisht nga klerikët lokalë) i individëve që mbështesin traditën konservative të Islamit bën më tepër dëm. Shpesh një gjë e tillë ka shkaktuar radikalizim më të madh të këtyre individëve. Duke pasur parasysh faktin se ata janë pjesë e komunitetit mysliman që vizitojnë të njëjtat institucione (të ligjshme) fetare, izolimi i tyre shpesh mund të sjellë si rezultat tensione me anëtarët më liberalë të xhemitit apo edhe me komunitetet e tjera fetare.⁶¹

4 Së katërti, edhe pse KMSH pretendon se ka nën kontroll të plotë institucionet e arsimit fetar (medresetë) dhe xhamitë nën autoritetin e tij, ekspertët janë të mendimit se problem mbeten ende objektet fetare jashtë autoritetit të KMSH-së. Mungesa e burimeve për institucionet e KMSH-së në zonat e largëta të vendit mund të përdoret nga grupet radikale për të përhapur ndikimin e tyre tek xhemitit, shpesh me anë të kurseve fetare apo atyre të formimit profesional.

5 Së pesti, pasiviteti i institucioneve shtetërore jashtë sektorit të sigurisë për të bashkëpunuar ngushtësisht me KMSH-në për trajtimin e shqetësimeve të ndryshme të komunitetit mysliman mund të shërbejë për zgjerimin e grupeve radikale në dëm të besimit publik tek partneriteti "shtet-KMSH" apo tek "përgjigjshmëria" dhe "paanshmëria" e përjasjes së shtetit ndaj komunitetin më të madh fetar në vend. Disa parakushte të një skenari të tillë konfirmohen edhe nga sondazhi i këtij studimi me qytetarët.

6 Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, mungesa e shoqërisë civile (në zonat e largëta) apo e veprimeve konkrete për problemet e varfërisë, rinisë dhe komunitetit ka lënë një boshllëk të madh dhe ka krijuar hapësira të mjaftueshme për radikalizimin (fetar). Madje edhe përtej këtyre zonave, shoqëria civile

nuk ka inkurajuar kurrë një diskutim të hapur publik të bazuar në fakte edhe për vlerat pozitive dhe realitete të tilla si mungesa e mbështetjes publike për Islamin konservator në vend. Vlera dhe tradita të tjera fetare nuk janë diskutuar dhe promovuar, së paku për të trajtuar perceptimin e gabuar të publikut për sjelle dhe rite specifike fetare (të tilla si haxhi apo të tjera) që mund të nxisin rritjen e islamofobisë.

Duke marrë parasysh kompleksitetin e shkaqeve bazë, zhvillimet dhe nxitësit që ndikojnë në radikalizimin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm, trajtimi dhe parandalimi i fenomenit kërkojnë bashkërendim veprimesh mes aktorësh të ndryshëm. Megjithatë, përqsja dhe veprimet (apo mungesa e tyre) e aktorëve kryesorë gjatë viteve të fundit në Shqipëri nuk duket se tregojnë për një gjë të tillë.

5.3. REAGIMI I AKTORËVE KRYESORË NDAJ RADIKALIZIMIT FETAR: PASIVITET MES PAQARTËSISË?

Që nga përshkallëzimi i konfliktit sirian (2011-2012) media ndërkombëtare ka raportuar për shtetas të huaj që i bashkohen konfliktit. Në muajt nëntor dhe dhjetor 2012, mediat raportuan për viktimat e para nga Shqipëria që luftonin në Siri,⁶² ndërkohë që numri i raporteve të tilla për viktimat apo qytetarë shqiptarë që i bashkohen konfliktit u rrit në gjysmën e dytë të vitit 2013.⁶³ Megjithatë, pothuajse të gjithë aktorët kryesorë të shoqërisë në vend, institucionet shtetërore, KMSH, shoqëria civile, etj., në fillim ishin të papërgatitur për këto zhvillime dhe dinamikën e tyre. Me rritjen e ndjeshmërisë në periudhën e mëvonshme, shumë nga aktorët kyçë shpesh i identifikuan këto zhvillime me sfida strikte të sigurisë apo të shtetit ligjor duke dështuar kështu në zhvillimin e një qasje më proaktive ndaj radikalizimit fetar në një kontekst më të gjerë shoqëror.

SHTETI:

Vetëm në fund të vitit 2013 dhe fillim të 2014 u intensifikua debati publik për këtë çështje ndërkohë që veprimet e autoriteteve shtetërore (më së shumti ato të sigurisë) evolvuan më tej. Në korrik të vitit 2014 Kuvendi i Shqipërisë futi në Kodin Penal amendamente që kishin të bënin me veprën penale të përfshirjes në veprime ushtarake në një shtet të huaj. Siç shpjegohet edhe në një raport të Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, amendamentet kishin si synim të trajtonin këtë shqetësim dhe për të parandaluar zhvillimin e mëtejshëm të këtij fenomeni.⁶⁴ Megjithatë, reagimi i shtetit ka qenë i kufizuar më tepër tek agjencitë e zbatimit të ligjit dhe më së shumti me anë të masave prapavepruese e shtrënguese. Institucione të tjera shtetërore që duhet të përfshiheshin në masat parandaluese janë edhe ministrisë (si Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale),

inspektoratet dhe shërbimet shtetërore (p.sh., Inspektorati i Arsimit, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, etj.), njësitë e qeverisjes vendore, drejtoritë rajonale të arsimit dhe të tjerë. Në shumë prej intervistave me përfaqësues të këtyre institucioneve sugjerohet se radikalizmi apo ekstremizmi i dhunshëm me baza fetare nuk ka qenë në fokus të punës së tyre.⁶⁵

KMSH (KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË):

Informues kyçë në Tiranë dhe ekspertët e intervistuar në këtë studim janë të mendimit se edhe vetë KMSH u gjend e papërgatitur, por më së shumti në aspektin se “si të reagonte” duke pasur parasysh faktin se KMSH ishte plotësisht në dijeni të disa zhvillimeve si psh xhamitë e paligjshme. Edhe pse KMSH ka qenë aktive në dhënien e mesazheve në të cilat dekurajon përfshirjen e shqiptarëve në konfliktin sirian, informuesit kyçë të këtij studimi janë të mendimit se kjo duhet të shoqërohet me veprime më konkrete. Në këto veprime përfshihen jo vetëm puna më e ngushtë me autoritetet shtetërore dhe xhematin (brenda dhe jashtë strukturave formale të KMSH-së) por edhe shpjegimi për besimtarët myslimanë se përse zhvillime dhe tendenca të tilla nuk janë në përputhje me vlerat dhe traditën hanefi të Islamit. Përdorimi i plotë i Këshillit të Teologëve të KMSH-së për të ndihmuar imamët në nivel vendor apo nxitja e klerikëve të suksesshëm për ndarjen e përvojave të tyre me kolegët dhe më gjerësisht me xhematin janë disa nga “hapat e munguar” që sugjeruan ekspertët. Po ashtu, ndërkohë që Prokuroria ka nisur ndjekjen penale ndaj klerikëve të një xhamie të paligjshme, mbetet ende e paqartë se përse KMSH nuk i kishte evidentuar dhe raportuar këto institucione të paligjshme dhe veprimtarinë e tyre

brenda komunitetit të vet para vitit 2014.⁶⁶ Për më tepër, Neni 3, pika ‘f’ e Marrëveshjes mes Shtetit dhe KMSH parashikon që në raste të tilla ky i fundit duhet të informojë autoritetet përkatëse shtetërore.⁶⁷

KOMITETI SHTETËROR I KULTEVE (KSHK):

Sipas Marrëveshjes mes Shtetit dhe KMSH-së, Shteti përfaqësohet nga KSHK në marrëdhëniet me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë (Neni 6). Tradita hanefi e KMSH-së referohet në Nenin 2 të Marrëveshjes, ndërsa në Nenin 3, pika ‘f’ garanton veprimet e KMSH-së ndaj deformimeve, prirjeve ekstremizuese. “Kështu, KSHK-së i njihet një rol aktiv në këtë marrëveshje si përfaqësues i shtetit për të ruajtur dhe zhvilluar marrëdhëniet mes Shtetit dhe KMSH-së. Megjithatë, disa informues kyçë argumentojnë se KSHK ka dështuar në punën e saj për inkurajimin e një qasjeje proaktive dhe bashkëpunuese mes institucioneve fetare dhe autoriteteve shtetërore jo vetëm nën dritën e ngjarjeve të fundit (shtetas shqiptarë që i bashkohen konfliktit sirian), por edhe për sa i përket zhvillimeve të tjera ku përfshihet apo ndikohet KMSH (p.sh. xhami të paligjshme, arsimimi i klerikëve jashtë vendit). Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e informuesve kyçë theksojnë se nuk është vetëm ndjeshmëria e zhvillimeve të tilla që kërkojnë, mbi të gjitha, një KMSH më aktive, por edhe mungesa e burimeve, kapaciteteve dhe madje edhe mandati i paqartë që kufizojnë KSHK-në për të ndërmjetësuar ose për të marrë përsipër një rol proaktiv.

SHOQËRIA CIVILE:

Shoqëria civile ka munguar pothuajse

plotësisht në inkurajimin apo zhvillimin e një debati të informuar për tendencat e radikalizimit, islamofobinë dhe për zhvillimet e tjera fetare në vend. Në të kaluarën në programet e shoqërisë civile nuk janë përfshirë asnjëherë “gërmimi më thellë” në kontekstin e gjerë të çështjeve që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin fetar dhe prirje të tjera shqetësuese (përfshirë këtu rastet e shtetasve shqiptarë që përfshihen në luftime jashtë vendit), inkurajimi i një debati të bazuar në fakte për nevojën dhe mekanizmat e parandalimit të tyre. Duke qenë sektor i drejtuar kryesisht nga donatorët, organizatat e shoqërisë civile dhe ato të kërkimeve të pavarura vetëm kohët e fundit kanë shprehur interes dhe kanë ngritur shqetësimet e tyre për radikalizimin fetar tek disa donatorë.⁶⁸ Gjithsesi, me përjashtim të pak nismave tek të cilat janë përdorur qasje bashkëpunimi me institucionet fetare për çështjet specifike, në përpjekjet e tjera të shoqërisë civile institucionet fetare dhe aktorët e tjerë në këtë fushë janë synuar si audiencë periferike.

Sfida e trajtimit të radikalizimit fetar dhe krijimi i mekanizmave efikas për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm kërkon lidhshmëri nga ana e disa institucioneve, përqasje të hapur nga ana e disa aktorëve të tjerë dhe, pa asnjë dyshim, kërkon përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve të shoqërisë në një diskurs të mirë-informuar me qëllim elaborimin e alternativave relevante për kontekstin dhe proceseve me ndikim të qëndrueshëm. Hapi i parë dhe parakushti kryesor për një debat të tillë të informuar, për evidentimin e nxitësve përkatës të ekstremizmit të dhunshëm dhe për vlerësimin e seriozitetit dhe shkallës së tij është njohja e zonave “të cenueshme” – sfidat sociale dhe ekonomike dhe dinamika e sfidave të tjera në nivel vendor.

Në kapitujt e mëposhtëm të këtij studimi shqyrtohen lidhja dhe rëndësia e nxitësve kryesorë të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm në tetë zonat e synuara të përfshira në këtë projekt. Në këtë mënyrë, studimi merr parasysh një sërë burimesh dhe të dhënash që lidhen me një grup të pasur të variablave dhe treguesve të mbledhura me anë të analizave cilësore dhe instrumente të kërkimit sasior siç u theksua edhe në pjesën e metodologjisë.

6



VLERËSIMI I
FAKTORËVE QË
MUNDËSOJNË
RADIKALIZIMIN DHE
NXITËSIT KRYESORË
TË EKSTREMIZMIT TË
DHUNSHËM

Ky studim shqyrton radikalizimin si seri procesesh të ndryshme me anë të të cilave individë adoptojnë këndvështrime që përligjin dhe propagandojnë dhunën. Nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm nuk kufizohen tek faktorë të veçantë, por përfshijnë procese shoqërore, lidhje personale dhe dinamika grupi që lehtësojnë përfshirjen në veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm. Radikalizimi fetar (si proces) dhe ekstremizmi i dhunshëm (si rezultat) mundësohen, nxitën dhe/ose formësohen nga një sërë faktorësh dhe nxitësish që operojnë në një kontekst të caktuar të vendit në nivel makro (shoqëror) dhe mikro (individ/grup). Zakonisht, ndikimi që krijojnë këta faktorë është i ndërlikuar dhe i ndërlidhur, ndërkohë që rezultati jo gjithmonë arrin nivelet e ekstremizmit të dhunshëm pavarësisht potencialit të madh për diçka të tillë. Prandaj, gjatë hetimit të fenomenit në një mjedis të caktuar shoqëror-ekonomik dhe politik dhe evidentimit të shkaqeve bazë dhe burimeve duhet të merren parasysh jo thjesht nxitësit e individualizuar dhe rëndësia e secilit prej tyre, por edhe dinamika e ndërveprimit, mënyra se si dhe pse materializohet ndikimi i tyre në radikalizëm fetar dhe ekstremizëm të dhunshëm në një kontekst të caktuar, si dhe pse ndërlidhje të njëjta apo të tjera të faktorëve nxitës duken më pak kërcënuese në një rajon tjetër.

Kjo përjasje dhe ky arsyetim kanë orientuar identifikimin e kuadrit të nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm që i shërbejnë studimit për të kuptuar fenomenin veçanërisht nga një perspektivë e orientuar nga parandalimi. Duke u bazuar në supozimin se nuk ka teori të përgjithshme (globale) se pse dhe si ndodh përdorimi i ekstremizmit të dhunshëm, studimi merr në shqyrtim kontekstin vendor. Kështu, u krye një verifikim i relevancës së kuadrit të

nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm duke pasur parasysh kontekstin shqiptar si dhe karakteristikat kryesore të radikalizimit fetar dhe fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm në vend me anë të proceseve të vlefësimimit dhe mjeteve të kontekstualizimit.

Në studim përdoret kuadri i nxitësve të zhvilluar nga Guilain Denoëux dhe Lynn Carter (2009),⁶⁹ të cilët identifikojnë tre kategori të ndryshme nxitësish të ekstremizmit të dhunshëm: social-ekonomikë (6 nxitës), politikë (11 nxitës) dhe kulturorë (3 nxitës). Siç sugjerojnë edhe autorët, "këta nxitës nuk përfaqësojnë një listë shteruese, por literatura për ekstremizmin e dhunshëm tregon se ato shpesh luajnë një rol të rëndësishëm." Po ashtu, "Guida e Nxitësve të Ekstremizmit të Dhunshëm" sugjeron se ekstremizmi i dhunshëm duhet të shihet në kontekst, ndaj edhe faza fillestare e studimit të IDM-së zhvilloi një analizë të kujdesshme të kuadrit të nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm.⁷⁰

Si rezultat, hulumtimi skualifikoi tre nxitës politikë (nga 11 gjithsej), të cilët, sipas analizës së kontekstit dhe të dhënave nga informues kyçë (faza fillestare) u sugjeruan si jo-relevantë për Shqipërinë e ditëve të sotme. Këta nxitës, siç përshkruhen nga G. Denoëux dhe L. Carter (2009) janë:

1. Konfliktet lokale

Përshkrimi: "Konfliktet lokale të një shkalle të mjaftueshme mund të krijojnë kaos, t'i bëjnë të paafta institucionet shtetërore dhe mund të sjellin si rezultat një vakuum pushteti që shfrytëzohet nga organizatat e ekstremizmit të dhunshëm. Këto grupe do të përipiqen të koptojnë anëtarë të një krahu të konfliktit dhe të imponojnë axhendat e tyre trans-nacionale në dinamika krejtësisht vendore."

2. Mbështetja shtetërore

Përshkrimi: “Qeveritë e vendit dhe shtetet e huaja—apo grupe/individë brenda tyre— shpesh mbështesin lëvizje të ekstremizmit të dhunshëm, ndërkohë që më vonë humbasin kontrollin mbi to.”

3. Qeveritë e diskretituara dhe mungesa apo kooptimi i opozitave ligjore

Përshkrimi: Kur një regjim diskretitohet krejtësisht dhe nuk ka opozitë të shëndetshme, ata që duan të kundërshtojnë qeverinë dhe të sjellin reforma do të shtyhen përmes kanaleve normale politike dhe mund të mbështesin grupet e ekstremizmit të dhunshëm.

Për dy nga nxitësit e tjerë politikë, faza fillestare e këtij studimi arrit në përfundimin se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë për kontekstin e vendit (së brendshmi). Megjithatë, hulumtimi sugjeroi se disa nga motivet e aktivitetit radikal fetar (të manifestuar me anë të rasteve të shtetasve shqiptarë që marrin pjesë në konflikte të armatosura jashtë vendit) lidheshin me perceptimet për këta faktorë/nxitës jashtë kufijve të vendit, si më poshtë vijon, (G. Denoeux dhe L. Carter:2009):

1. Pushtimi i huaj

Përshkrimi: “Vendet nën pushtimin e huaj ushtarak përballen me rrezikun e kryengritjeve dhe abuzimit me të drejtat. Mbështetja për veprimtaritë e ekstremizmit të dhunshëm mund të vijë nga njerëz që duan të hakmerren për turpërimin e tyre personal ose të komunitetit.”

2. Cenimi politik dhe/ose ushtarak

Përshkrimi: “Ndërhyrja politike apo ushtarake në shkallë të gjerë në punët e brendshme mund të shërbejë si element bashkues, ku komuniteti i kthehet dhunës për të rikthyer nderin individual dhe kolektiv. Në komunitetet që historikisht kanë pasur shkallë të lartë autonomie dhe vetë-rregullimi, ka gjasa të ketë rezistencë të fortë.”

Së fundi, në bazë të gjetjeve të fazës fillestare ku shqyrtohen karakteristikat kryesore të fenomenit të radikalizimit fetar në Shqipëri, në kuadrin e nxitësve që u përdor në këtë studim u përcaktua dhe u përfshi një kategori e re (e katërt) e nxitësve të mundshëm të ekstremizmit të dhunshëm që janë specifike për kontekstin shqiptar. Kjo kategori nxitësish u përfshi për të investuar më thellë gjetjet e fazës fillestare ku një numër i konsiderueshëm informuesish kyçë raportonin frikën për një nivel shkëputjeje dhe një boshllëku mes institucioneve (të ligjshme) fetare dhe besimtarëve të tyre. Kjo kategori nxitësish u shqyrtua për të vlerësuar nivelin në të cilin zhvillime dhe shqetësime të ndryshme që lidhen me veprimtarinë e institucioneve fetare ofrojnë një mjedis mundësues për radikalizim.

Si rezultat, kuadri i nxitësve të radikalizimit fetar dhe të ekstremizmit të dhunshëm në këtë studim përbëhet nga katër kategori me një total prej 21 nxitësish, siç tregohet edhe në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1: Matrica e nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm

NXITËSIT SOCIAL-EKONOMIKË		NXITËSIT KULTURORË	
Perceptimet e përjashtimit dhe marginalizimit social	Rrjetet shoqërore dhe dinamikat e grupit	Islami nën rrethim	Agjendat "Proaktive" fetare
Diskriminimi shoqëror	Nevoja të papërbushura sociale dhe ekonomike	Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës	
Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ	Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike		
NXITËS POTENCIALË TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM SPECIFIKË PËR SHQIPËRINË		NXITËSIT POLITIKË	
Tolerimi i institucioneve të paligjshme fetare (legjitimiteti)	Niveli i përgatitjes së klerikëve lokalë	Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile	Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta
Autoriteti i kontestuar i institucioneve fetare në Shqipëri	(Mungesë) Ndikimi i klerikëve lokalë	Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut	Zonat e paqeverisura ose të qeverisura dobët
		Pushtimi i huaj	Frikësimi apo kërcënim nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm
		Cenimi politik dhe/ose ushtarak	Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë

(Burimi: Guilain Denoëux dhe Lynn Carter: 2009 dhe IDM:2015)

Në seksionet e mëposhtme shqyrtohen veçmas çdo kategori dhe nxitës në lidhje me rëndësinë, kontekstin dhe shkallën e rrezikut, ndërsa vlerësimi i tyre mbështetet në trekëndëzimin metodologjik të burimeve dhe të

dhënave, ku përfshihen:

- Analiza e kontekstit dhe të dhënat zyrtare për profilin e zonave të synuara dhe popullsisë së tyre

- Sondazhi i IDM-së me qytetarë dhe komunitetin e besimtarëve në zonat e synuara⁷¹
- Informacioni i vërtetuar dhe gjetjet e gjeneruara nëpërmjet intervistave gjysmë të strukturuar dhe fokus grupeve⁷²
- Shqyrtimi i literaturës, raporteve, kuadri ligjor dhe i politikave dhe burimet e tjera dytësore

Për të shtjelluar një nxitës të caktuar janë përdorur të paktën dy burime informacioni, ndërkohë që analiza për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin fetar shqyrton dinamikën dhe marrëdhëniet mes nxitësve të të katër kategorive.

Një nga burimet dhe të dhënat që ka gjeneruar IDM për të kuptuar dhe/ose vlerësuar çdo nxitës specifik të ekstremizmit të dhunshëm është sondazhi i realizuar në të tetë zonat me qytetarë të përzgjedhur në mënyrë rastësore (50% e kampionit) dhe me

anëtarë të komunitetit të besimtarëve myslimanë.⁷³ Më poshtë jepet një përshkrim i shkurtër i demografisë së të intervistuarve të sondazhit.⁷⁴

KUSH JANË TË INTERVISTUARIT E SONDAZHIT TË IDM-SË?

Pjesa më e madhe e të anketuarve në sondazh janë meshkuj (59%), ndërsa femrat përfaqësohen në 41% të kampionit. Me përjashtim të të anketuarve të moshës “18-25 vjeç”, që përfaqësojnë 31% të kampionit, grupmoshat e mbetura qëndrojnë në nivelet 15% deri në 20%.

Pothuajse gjysma e të intervistuarve raportojnë se kishin përfunduar arsimin e mesëm si nivelin më të lartë arsimor dhe 29.29% që kishin përfunduar studimet universitare ose pasuniversitare.

Figura 1. Grupmoshat [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]






Figura 2. Arsimi [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]



Duke qenë se sondazhi synonte anëtarë të komunitetit të besimtarëve myslimanë në masën 50% dhe gjysma tjetër e kampionit me qytetarë të zgjedhur në mënyrë rastësore,

pjesa më e madhe e gjysmës së dytë të kampionit raportojnë se janë myslimanë. Si rrjedhojë, 88% e totalit të kampionit përbëhet nga të intervistuar me besimin fetar mysliman.


Figura 3. Përkatësia fetare [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]



Kur u pyetën nëse përkatësia e tyre fetare është e njëjtë me atë të prindërve (të të dyve ose të paktën e njërit prej tyre) 95% e të intervistuarve konfirmuan faktin, ndërsa 4% thanë se përkatësia e tyre fetare është e ndryshme nga ajo e prindërve dhe vetëm 1% refuzuan të përgjigjeshin ose nuk e dinin.

Gjithsesi, jo të gjithë të intervistuarit e ushtrojnë rregullisht besimin e tyre. Kur u pyetën nëse e praktikojnë rregullisht besimin e tyre fetar, 37% konfirmojnë "ushtrimin e rregullt të gjithë riteve dhe rregullave fetare", 32% "praktikojnë ritet kryesore fetare" dhe 29% "nuk i praktikojnë ritet dhe rregullat fetare". Shih figurën 4 mëposhtë.

Figura 4. Praktikimi i fesë [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]



6.1. NXITËS SOCIO-EKONOMIKË

Në kapitullin e shqyrtimit të literaturës theksohet se procese të ndryshme shoqërore janë jashtëzakonisht të rëndësishme për lehtësimin, pengimin apo mbrojtjen e individëve nga rekrutimi prej grupeve radikale dhe ekstremiste të dhunshme apo edhe vetë komunitetit në mbështetje të tyre. Procese të tilla mund të jenë të një

natyre të gjerë, si, p.sh., fragmentimi i shoqërisë dhe marginalizimi i grupeve të caktuara, diskriminimi shoqëror, frustrimi i shkaktuar nga mospërbushja e pritshmërive të ndryshme, privimi nga të drejta ekonomike dhe shoqërore, si dhe lulëzimi i aktiviteteve të paligjshme ekonomike i shoqëruar nga një lakmi

dhe pranim i përfitimeve të shpejta dhe të kundërligjshme.⁷⁵ Në një plan më të ngushtë, procese të tilla kritike mund të jenë dhe dinamikat që zhvillohen brenda grupeve të ndryshme shoqërore. Gjatë punës kërkimore në terren janë marrë në shqyrtim të gjithë këta faktorë socio-ekonomikë me qëllim për të kuptuar domethënien, praninë ose jo të tyre në zonat e vizituara si dhe rrezikun që ata mund të paraqesin për këta komunitete në drejtim të ekspozimit dhe mbështetjes së grupeve radikale fetare dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Me një popullsi të përgjithshme prej rreth 2.8 milion banorë, Shqipëria paraqet tregues të ndryshëm socio-

ekonomikë të cilët dallojnë në mënyrë të theksuar midis rajoneve të ndryshme të vendit. Në veçanti, zonat malore dhe ato rurale shënojnë shifrat më të ulëta të zhvillimit socio-ekonomik. Përfshirja shoqërore konsiderohet një nga sfidat më serioze për zhvillimin afatgjatë shoqëror dhe ekonomik të vendit.⁷⁶ Në vitin 2013, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë ishte 471 mijë lekë e cila e shprehur në Standardin e Fuqisë Blerëse është pothuajse sa një e treta e mesatares së PBB-së për frymë të vendeve të Bashkimit Evropian.⁷⁷ Ndërsa niveli i përgjithshëm papunësisë në vend gjatë vitit 2014 përlllogaritej rreth 17.9 % dhe 32.5 % midis të rinjve (15-29 vjeç).⁷⁸

Tabela 2. Kategoria e nxitësve socio-ekonomikë

NXITËSI	PËRSHKRIMI
Perceptimet e përjashtimit dhe margjinalizimit social	Ky perceptim mund të jetë më shumë i përhapur tek të rinjtë nga zonat urbane/periferike dhe në mjedise ku strukturat e familjes janë të mangëta, kontrollet sociale normale nuk i shqyrtojnë sjelljet, dhe të rinjtë kanë shumë kohë që rrinë pa bërë asgjë. Kjo sjell si rezultat një ndjesi izolimi dhe dëshirë për të shkelur ligjet. Grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund ta shfrytëzojnë këtë izolim duke ofruar një arratisje, një ndjenjë me qëllime dhe përfshirje në një lëvizje kolektive.
Rrjetet shoqërore dhe dinamikat e grupit	Rrjetet shoqërore janë një faktor i rëndësishëm në radikalizim dhe rekrutim. Njerëzit mund të përfshihen në grupe të ekstremizmit të dhunshëm së bashku me miqtë ose si rezultat i ndikimit të afërmve, fqinjëve apo të ndonjë predikuesi karizmatik lokal.
Diskriminimi shoqëror	Diskriminimi i perceptuar apo i vërtetë ndaj një individi ose komuniteti (ose të dyja), në një kuptim të gjerë mund të jetë një nxitës për ekstremizmin e dhunshëm. Në vendet ku myslimanët janë një pakicë e vogël, diskriminimi social-ekonomik dhe/ose politik mund të perceptohet si i lidhur me mungesën e respektit për Islamin dhe myslimanët, duke provokuar radikalizimin.

NXITËSI	PËRSHKRIMI
Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ	Privimi relativ dhe pritshmëritë e dështuara janë nxitës të fuqishëm për veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm mes të rinjve duke pasur parasysh përmirësimet në arsimim, sidomos në nivelin e shkollës së mesme dhe të universitetit. Të rinjtë me nivel më të lartë arsimor prirën të mendojnë se meritojnë rezultate më të mira në jetë nga ç'mund t'u ofrojë shoqëria e tyre. Në përgjithësi ata nuk mund të marrin vendet punës që mendojnë se i meritojnë; ata e dinë që nepotizmi pengon mundësitë për punë. Meshkujve të rinj mund t'u mungojnë burimet ekonomike që nevojiten për të krijuar familje dhe në përgjithësi në shoqëritë tradicionale ju mohohet mundësia të thonë fjalën e tyre.
Nevoja të papërbushura sociale dhe ekonomike	Privimi i nevojave social-ekonomike, veçanërisht kur ndërthuren me faktorë të tjerë, siç janë korrupsioni i përhapur dhe mungesa e sigurisë dhe drejtësisë, mund të jetë një faktor që shfrytëzohet nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat mund të ofrojnë paga dhe shërbime. Megjithatë, nuk është varfëria, por forma e tejskajshme e përjashtimit social nga ana e qeverisë dhe shoqërisë që shkakton mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm.
Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike	Veprimtaritë e paligjshme të organizatave të ekstremizmit të dhunshëm ofrojnë mundësi ekonomike fitimprurëse për ata që kërkojnë të ardhura të lehta. Rrjetet që ushtrojnë ekstremizëm të dhunshëm dhe veprimtari ekonomike të paligjshme kanë marrëdhënie me përfitime të ndërsjella, duke i ofruar njëri-tjetrit përvojë për të fshehur sjelljen e paligjshme dhe ideologjinë për ta legjitimuar atë. Burgjet janë një vend i njohur rekrutimi për ekstremizmin e dhunshëm.

Burimi: Guilain Denoëux dhe Lynn Carter (2009)⁷⁹

Pjesa në vijim e këtij seksioni shqyrton gjetjet e përfuara nga burime parësore dhe dytësore për secilin nga nxitësit e mësipërm.

6.1.1. PERCEPTIMI I PËRJASHTIMIT SHOQËROR DHE MARGJINALIZIMI

“Ky perceptim mund të jetë i përhapur veçanërisht ndërmjet të rinjve në zona periferike dhe të pazhvilluara dhe në mjedise ku strukturat familjare janë gërryer, mekanizmat shoqërorë nuk kontrollojnë më sjelljen e individëve dhe të rinjtë kalojnë shumë kohë larg aktiviteteve të dobishme. Si rrjedhojë, përjetohet një ndjesi anemie dhe izolimi. Grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të shfrytëzojnë këtë izolim përmes ofrimit të një rrugëdaljeje, një ndjesie kauze dhe përfshirjeje në një lëvizje kolektive”⁸⁰

Sipas Komisionit Evropian '*përrjashtimi social është procesi ku disa individë pengohen të marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri si rezultat i varfërisë apo diskriminimit të tyre.*'⁸¹ Koncepti i përrjashtimit social pasqyron shkallën e (mos)përrmbushjes së nevojave të individëve në shoqëri. Këto nevoja nuk janë vetëm të natyrës ekonomike, por edhe sociale, kulturore e politike.⁸² Ky koncept thekson rëndësinë e përrqendrimit në përrjashtimin social në krahasim me konceptin e varfërisë (që është një ndër dimensionet e tij) edhe për arsyen se ka më shumë shkaktarë që nxisin përrjashtimin social.⁸³ Për sa i përket niveleve të varfërisë në vend, të dhënat më të fundit janë përrftuar nga anketa e matjes së nivelit të jetesës në vitin 2012. Mbështetur në vlerësimet e konsumit, sipas kësaj ankete, 14.3% e popullsisë së përrgjithshme konsiderohet e varfër dhe 2.3% si tejte e varfër.⁸⁴ Në këtë aspekt, zonat më të varfra janë ato rurale bregdetare dhe malore.⁸⁵ Përrjashtimi shoqëror theksohet nga problematika që lidhen me mbrojtjen shoqërore të grupeve të cënueshme, ofrimin e mundësive të barabarta dhe mbrojtjen nga aktet diskriminuese. Të dhënat statistikore lidhur me nivelin e jetesës në Shqipëri evidentojnë grupet shoqërore që jetojnë në varfëri dhe që janë të rrezikuar nga përrjashtimi shoqëror. Në këto grupe përrfshihen gratë dhe fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje dhe pakicat e margjinalizuara, si komunitetet Rome dhe Egjiptiane.⁸⁶ Për zbutjen e përrjashtimit shoqëror për këto grupe parashikohen politika shtetërore ndër-sektorale të përrmbledhura në një strategji kombëtare për përrfshirje dhe mbrojtje shoqërore (2014-20), e cila nuk është përrfunduar ende.⁸⁷

Papunësia është një faktor i fuqishëm në forcimin e perceptimeve apo eksperiencave të përrjashtimit shoqëror,


pasi mungesa e të ardhurave të mjaftueshme nuk është vetëm shkak i një jetese në kushtet e varfërisë, por sjell për më tepër pasoja socio-psikologjike të pasqyruara në uljen e nivelit të socializimit.⁸⁸ Kështu, në fillim të vitit 2015 numri i personave të moshës 15-29 vjeç në Shqipëri arrinte në rreth 690 mijë. Rreth 63% e tyre banojnë në zona urbane dhe 37% në zona rurale.⁸⁹ Në total, 32.5% e të rinjve shqiptarë rezultojnë të papunë.⁹⁰ Grupet e të rinjve më të ndikuar nga papunësia janë meshkuj (35.6%), të cilët kanë përrfunduar vetëm shkollën e mesme të përrgjithshme (1 në 4 apo 24.3%).⁹¹

Krahas kësaj kornize të përrgjithshme që mund të krijojë kushtet e favorshme për radikalizëm dhe aktivitete ekstremiste të dhunshme, ky studim shqyrton drejtpërdrejtë perceptimet personale të qytetarëve në lidhje me përrjashtimin shoqëror. Të intervistuarve, të cilët kanë qenë ose jo pjesëtarë të komuniteteve fetare në zonat e synuara, u janë parashtruar pohimet e mëposhtme (pyetje kontrolli):

- a) *Sjellja e të rinjve në zonën ku banoj ndikohet ndjeshëm nga familja dhe opinioni publik.*
- b) *Të rinjtë e zonës ku banoj janë mjaftueshëm të angazhuar në aktivitete që i mbajnë larg nga veset apo sjelljet e rrezikshme.*

Rëndësia dhe mundësia që ky nxitës të favorizojë radikalizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm janë vlerësuar mbi bazë të "përrgjigjeve negative" për të dy pyetjet e kontrollit (a) ndikimi i familjes dhe opinionit publik mbi të rinjtë, dhe (b) përrfshirja e të rinjve në aktivitete që i mbajnë larg nga sjelljet e rrezikshme. Grafiku 5 më poshtë paraqet gjetjet e sondazhit në lidhje me këtë nxitës.

Figura 5. Përrjashtimi shoqëror dhe marginalizimi [Burimi: Sondazhi IDM 2015]



Shumica e të intervistuarve, rreth 64 % besojnë se të rinjtë e zonave ku ata banojnë ndikohen ndjeshëm nga familja dhe opinioni publik. Sipas perceptimit të tyre, normat shoqërore të kontrollit të sjelljes në komunitet janë të pranishme. Nga të gjithë zonat e anketuara, rreth 24 % e të intervistuarve janë të mendimit se sjellja e të rinjve nuk ndikohet apo kontrollohet nga presioni i familjes dhe opinionit publik. Ndërsa në nivel zonash të caktuara gjeografike, numri më i lartë i të intervistuarve që besojnë se të rinjtë nuk ndikohen nga familjet e tyre dhe opinioni i komunitetit rrethues regjistrohet në Cërrik (55%). Ndërsa numri më i ulët i të intervistuarve që ndajnë të njëjtin mendim shënohet në Bulqizë ku vetëm 10% e tyre besojnë se familja dhe komuniteti rrethues nuk

kanë ose kanë shumë pak ndikim mbi të rinjtë e zonës së tyre.

Siç dallohet nga grafiku 5, një shumicë e konsiderueshme e të intervistuarve, 70% besojnë se të rinjtë nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në aktivitete të dobishme, të cilat i mbajnë ato larg veseve dhe sjelljeve të rrezikshme. Vetëm 17% e të intervistuarve besojnë të kundërtën. Këto rezultate paraqiten shqetësuese në drejtim të kohës së madhe në dispozicion të të rinjve dhe ekspozimit të mundshëm të tyre ndaj veseve dhe sjelljeve të rrezikshme, duke përfshirë rekrutimin prej grupeve radikale dhe ekstremisht të dhunshme. Zona rurale e komunës Qendër Librazhd paraqet numrin më të lartë të të intervistuarve me rreth 79% që mohojnë përfshirjen e të rinjve në

aktivitete të dobishme. Në krahasim me të gjitha zonat e anketuara, numri më i lartë i të intervistuarve (23%) të cilët besojnë se rinia e shfrytëzon shumicën e kohës me aktivitete të dobishme shënohet në Cërrik dhe Librazhd.

Perceptimi se *sjellja e të rinjve nuk ndikohet apo kontrollohet nga presioni i familjes dhe opinionit publik* (24%) është më i fortë ndërmjet të intervistuarve: meshkuj (26%), 36-40 vjeç (28.13%) me nivel arsimor 9 vjeçar ose më pak (28.7%). Për sa i përket statusit të punësimit, ky perceptim është më i fortë tek personat e papunë (27.4%). Të intervistuarit që praktikojnë vetëm rregullat dhe ritet kryesore (27.7%) shfaqen më të prirur të besojnë mungesën e ndikimit të familjes dhe opinionit publik mbi sjelljen e të rinjve.

Në lidhje me pyetjen e dytë të kontrollit për këtë nxitës, personat më të prirur për të besuar se *të rinjtë e zonës së tyre nuk janë mjaftueshëm të angazhuar në aktivitete që i mbajnë larg veseve dhe sjelljeve të rrezikshme* janë: femra (69.7% e tyre), grupmosha 36-40 vjeç (76.6%), persona që kanë përfunduar

arsimin e mesëm (72%), dhe të papunë (72.9%). Personat që praktikojnë rregullisht ritet fetare (77.5%) janë më të prirur të besojnë se rinia nuk është e angazhuar mjaftueshëm në aktivitete të dobishme.

Shumica e aktorëve kyç të intervistuar në tetë zonat e synuara kanë pohuar rolin dhe mundësinë e nxitjes të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm si pasojë e perceptimeve të përjashtimit shoqëror dhe marginalizimit ndërmjet të rinjve. Sipas tyre, faktorë të rëndësishëm të radikalizmit janë *niveli i ulët ekonomik dhe arsimor, zonat kryesisht periferike dhe rurale, papunësia si dhe mungesa e përfshirjes në aktivitete të dobishme dhe pritshmërive për të ardhmen*. Në disa raste, këto faktorë janë ndërthurur me *propagandën e grupeve radikale dhe prirjen për aventurë të të rinjve*.⁹² Nga intervistat individuale dhe fokus grupet e realizuara, në disa zona është raportuar një shkallë e lartë dhe shqetësuese e konsumit të alkoolit dhe lëndës narkotike të kanabisit midis të rinjve.

6.1.2. RRJETET SHOQËRORE DHE DINAMIKAT BRENDA GRUPEVE

*“Rrjetet shoqërore janë një faktor i rëndësishëm i rekrutimit dhe radikalizimit. Individët mund të përfshihen në grupe ekstremiste të dhunshme përmes shokëve apo si rezultat i ndikimit nga të afërm, fqinj, apo të ndonjë predikuesi karizmatik në zonën e tyre.”*⁹³

Studime dhe raportime të shumta mediatike kanë hedhur dritë mbi ekzistencën dhe rëndësinë e marrëdhënieve shoqërore apo familjare midis personave të përfshirë në procese të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Sipas studiuesve të teorisë së lëvizjes shoqërore dhe teorisë së rrjetit, radikalizmi dhe ekstremizmi i

dhunshëm kanë të bëjnë në thelb me personat që njohim- idetë radikale transmetohen përmes rrjeteve shoqërore dhe elementë të dhunës shfaqen brenda grupeve të vogla shoqërore. Lidhjet, presioni i grupit dhe indoktrinimi ndryshojnë gradualisht pikëpamjet e individit rreth botës.⁹⁴ Sageman (2004, 2007) thekson se ndërveprimi midis personave të të


njëjtimit mendim është thelbësor për radikalizimin që të ndodhë si proces. Ai këtë grup personash me të njëjtat ide e quan 'një grumbull djemsh' dhe vetë procesin 'mobilizimi përmes rrjeteve'.⁹⁵ Kështu që dinamikat brenda grupeve shoqërore shërbejnë për të vleftësuar dhe përforcuar me personat e tjerë të radikalizuar idetë dhe interpretimet e individit. Nga ana tjetër, raportime të medias në Shqipëri kanë konfirmuar praninë e lidhjeve shoqërore dhe familjare midis personave të radikalizuar dhe të përfshirë në aktivitete ekstremiste të dhunshme në Siri. Këto marrëdhënie mund të kenë ekzistuar përpara rekrutimit, ashtu siç mund të jenë formuar edhe gjatë procesit të propagandimit dhe radikalizimit. Raportime të Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Investigative (BIRN) kanë evidentuar se midis personave të rekrutuar dhe radikalizuar dhe rekrutuesve kanë ekzistuar ose janë krijuar lidhje shoqërore gjatë ekskursioneve të organizuara apo predikimeve fetare të rekrutuesve.⁹⁶

Në disa raste, njohjet janë mundësuar përmes rrjeteve sociale në internet apo brenda komuniteteve të emigrantëve jashtë vendit.⁹⁷ Po ashtu, midis tyre janë faktuar edhe raste të lidhjeve familjare, fisnore dhe të krushqisë.⁹⁸ Lidhjet familjare kanë ekzistuar edhe midis personave, të cilët janë larguar nga Shqipëria për t'u rreshtuar përkrah formacioneve si Al-Nusra dhe ISIS. Mjaft shqetësuese kanë qenë rastet e tërheqjes të bashkëshorteve dhe fëmijëve drejt Sirisë nga të larguarit.⁹⁹

Duke marrë shkas nga informacioni i mësipërm, roli dhe potenciali radikalizues i rrjeteve shoqërore dhe dinamikave brenda grupeve është testuar përmes mbledhjes dhe analizimit të perceptimeve rreth këtij faktori të të intervistuarve në këtë studim, ku shumica prej tyre deklaroi se përkatësia fetare e rrethit të tyre shoqëror është e të njëjtimit besim (si i të intervistuarve).

Kështu, të intervistuarve të cilët janë ose jo pjesëtarë të komuniteteve fetare në

Figura 6. Përkatësia fetare e rrethit shoqëror [Burimi: Sondazhi IDM 2015]



zonat e synuara, u janë parashtruar pohimet e mëposhtme (pyetje kontrolli):

- a) Shumica e njerëzve që njoh janë bërë besimtarë për shkak të rrethit të tyre shoqëror.
- b) Në zonën ku banoj veprojnë individë apo grupe që nxisin radikalizimin e krishterë/islamik.


Rëndësia dhe mundësia që ky nxitës të favorizojë radikalizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm janë vlerësuar mbi bazë të "përgjigjeve pozitive" për të dy pyetjet e kontrollit (a) besimi i nxitur nga rrethi shoqëror, dhe (b) prania e grupeve radikale fetare në komunitet.

Shumica e të intervistuarve (46.5%) nuk besojnë se personat që ata njohin të jenë bërë besimtarë për shkak të

rrethit të tyre shoqëror. Pjesa e dytë më e madhe e të intervistuarve (34.2%) deklaroi se nuk ka informacion mbi shkaqet e fillimit të besimit nga të njohurit e tyre, qofshin këto të një natyre individuale, të nxitura nga miqtë dhe të afërm apo tjetër. Ndërsa 19.3% e të intervistuarve kanë pohuar se personat që ata njohin janë bërë besimtarë për shkak të shokëve dhe miqve të tyre. Ndërsa në nivel zonash të caktuara gjeografike, numri më i lartë i të intervistuarve që pohojnë këtë regjistrohet në Kukës (36.6%) dhe Pogradec (25%). Nga ana tjetër, numri më i ulët i 'përgjigjeve pozitive' për këtë pyetje është shënuar në Cërrik (8%).

Grafiku 7, më poshtë paraqet gjetjet e sondazhit lidhur me pohimin e dytë (ekzistencën e grupeve).

Figura 7. Rrjetet shoqërore dhe dinamikat brenda grupeve [Burimi: Sondazhi IDM 2015]



Siç dallohet nga grafiku 7, shumica e të intervistuarve (62% dhe 65%) mohojnë praninë e individëve apo grupeve radikale fetare në komunitetet e tyre. Prania në komunitet e individëve apo grupeve që nxisin radikalizmin e krishterë apo islamik pohohet respektivisht vetëm në masën 9 % dhe 12 %. Në krahasim me të gjitha zonat e anketuara, numri më i lartë i personave që besojnë se në zonën e tyre ka individë apo grupe nxitëse të radikalizmit të krishterë është në zonën e Librazhdit, si në qytet (18.2%) ashtu dhe komunë (Qendër 15.3%). Ndërsa numri më i lartë i personave që besojnë se në zonën ku ata banojnë janë të pranishëm individë apo grupe nxitëse të radikalizmit islamik është në Bulqizë (21%).

Perceptimi se *'njerëzit që njoh janë bërë besimtarë për shkak të rrethit të tyre shoqëror* (19.3%) është më i fortë midis: të intervistuarve femra (25% e tyre), personave të grupmoshës 31-35 vjeç (23.5%) dhe atyre me arsim universitar apo pasuniversitar (25.2 %). Për sa i përket statusit të punësimit, personat e punësuar (18.7%) janë më të prirur të besojnë fillimin e besimit për shkak të rrethit shoqëror. Ky perceptim është më i fortë midis të intervistuarve të cilët nuk janë praktikantë të ndonjë besimi fetar (23.3%).

Në lidhje me pyetjen e dytë të kontrollit për këtë nxitës, personat më të prirur të besojnë se në komunitetin e tyre ekzistojnë individë apo grupe të caktuara që nxisin radikalizmin e Krishterë, janë: meshkuj (9.4% e tyre), grupmosha 36-40 vjeç (12.5%), persona me arsim 9-vjeçar ose më pak (13%), të punësuar (11.3%). Të intervistuarit më të prirur për të besuar se në komunitetin e tyre ekzistojnë individë apo grupe të caktuara që nxisin radikalizmin islamik janë: meshkuj (12.4% e tyre), persona të grupmoshës 18-25vjeç (15%), të

anketuar me arsim 9-vjeçar ose më pak (14.7%), të papunë (13.7%). Kjo bindje prevalon midis personave të cilët nuk praktikojnë rregulla dhe rite fetare (18%).

Aktorë kyçë të intervistuar në zonat e synuara kanë shpjeguar rolin dhe rëndësinë e rrjeteve shoqërore si dhe dinamikave brenda tyre në lidhje me indoktrinimin, rekrutimin dhe radikalizmin e të rinjve. Sipas tyre, personat e përfshirë në grupe me pikëpamje radikale fetare nuk janë të shoqërueshëm, por izolohen brenda grupeve të tyre, të cilët shpesh zgjedhin rrugën e bojkotit duke përfshirë atë ekonomik (p.sh. nuk blejnë produkte në biznesin e një myslimani tradicional). Takimet e pjesëtarëve të këtyre grupeve realizohen në xhami apo jashtë saj. Brenda grupeve spikasin dy apo tre individë me më tepër influencë dhe kontakte të zgjeruara brenda apo jashtë vendit. Rekrutimi i anëtarëve të rinj në grup bëhet përmes lidhjeve të afërta dhe familjare. Të intervistuarit pohojnë se rekrutimi mund të ndodh edhe përmes internetit (rrjetit social Facebook). Sipas të intervistuarve, dinamikat brenda grupit sjellin më shumë indoktrinim të pjesëtarëve dhe arrijnë deri në pranimin nga e gjithë familja të interpretimeve të rrepta dhe ekstremiste të Islamit dhe në disa raste prishjen e marrëdhënieve të familjes me fisin.¹⁰⁰

6.1.3. DISKRIMINIMI SHOQËROR

“Diskriminimi i perceptuar apo real ndaj një individi ose komuniteti (ose të dyja) në një kuptim të gjerë mund të jetë një nxitës për ekstremizmin e dhunshëm. Në vendet ku myslimanët janë një pakicë e vogël, diskriminimi social-ekonomik dhe/ose politik mund të perceptohet si i lidhur me mungesën e respektit ndaj Islamit dhe myslimanëve, duke provokuar radikalizimin.”¹⁰¹

Duke qenë se rreth 20% e të intervistuarve në Censusin e vitit 2011 refuzuan të përgjigjeshin pyetjes jo të detyrueshme lidhur me përkatësinë fetare, vlerësimet rreth përmasave të komuniteteve fetare në vend nuk mund të jenë plotësisht të sakta. Megjithatë, sipas Censurit 2011, myslimanët sunitë në Shqipëri përbëjnë rreth 57% të popullsisë së përgjithshme.¹⁰² Pavarësisht mbizotërimit të këtij komuniteti fetar, nuk përjashtohet mundësia që individë apo grupe të kësaj përkatësie fetare të perceptojnë ose përjetojnë realisht forma të ndryshme diskriminimi për shkak të identitetit të tyre fetar.

Në fakt, gjatë vitit 2014 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 5 çështje diskriminimi (3 ankesa dhe 2 çështje të nisura kryesisht) për shkak të bindjes fetare. Sipas Komisionerit në një çështje është konstatuar diskriminim për shkak të besimit fetar.¹⁰³ Në një rast tjetër, dy efektivë të forcave RENEA pretenduan se janë larguar nga puna për shkak se ishin besimtarë praktikantë të fesë Islame.¹⁰⁴ Megjithatë, pas një takimi midis Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Myftiut të Tiranës, ky i fundit mohoi që largimi nga puna i efektivëve të policisë të ishte akt diskriminimi për shkak të fesë.¹⁰⁵

Krahas tablosë së pasqyruar më sipër, roli dhe potenciali radikalizues i diskriminimit shoqëror për shkak të përkatësisë fetare është testuar përmes mbledhjes dhe analizimit të perceptimeve rreth këtij faktori të të


intervistuarve në këtë studim. Kështu, të intervistuarve, të cilët kanë qenë ose jo pjesëtarë të komuniteteve fetare në zonat e synuara, u janë parashtruar pohimet e mëposhtme (pyetje kontrolli):

- a) *Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social pikërisht për shkak të besimit fetar.*
- b) *Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore.*

Rëndësia dhe mundësia që ky nxitës të favorizojë radikalizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm janë vlerësuar mbi bazë të “përgjigjeve pozitive” për pyetjen e parë a) perceptime të diskriminimit socio-ekonomik për shkak të besimit fetar, dhe të “përgjigjeve negative” të dhëna për pyetjen e dytë të kontrollit b) perceptime të diskriminimit politik për shkak të besimit fetar. Grafiku 8, më poshtë paraqet gjetjet e sondazhit në lidhje me këtë nxitës.

Shumica e të intervistuarve (55.1%) nuk besojnë se njerëzit diskriminohen në aspektin ekonomik dhe shoqëror për shkak të besimit të tyre fetar. Megjithatë, 21.5% perceptojnë forma socio-ekonomike të diskriminimit për shkak të fesë. Numri më i lartë i të intervistuarve që perceptojnë forma të tilla diskriminimi ndaj personave me besim fetar të njëjtë me ta regjistrohët

Figura 8. Perceptime të diskriminimit shoqëror për shkak të fesë [Burimi: Sondazhi IDM 2015]



në Buçimas (39.4%) dhe Cërrik (39%). Niveli më i ulët i perceptimeve të diskriminimit socio-ekonomik për shkak të fesë shënohet në Librazhd (4%) dhe Komuna Qendër-Librazhd (11.2%).

Ndryshe nga niveli relativisht i ulët i perceptimeve për diskriminim socio-ekonomik për shkak të fesë, shumica e të intervistuarve besojnë se njerëzit diskriminohen politikisht për shkak të fesë. Një në dy persona beson se njerëz të të njëjtit besim fetar me të nuk përfaqësohen sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore (51%). Në krahasim me të gjitha zonat e anketuara, perceptimi më i lartë i diskriminimit politik (mospërfaqësim i mjaftueshëm në institucione) për shkak të besimit fetar raportohet në Komunën

Qendër-Librazhd (67.4 %) dhe Librazhd (62.5%). Interesant është fakti se pikërisht në këto dy zona janë shënuar vlerat më të ulëta të perceptimit për diskriminim socio-ekonomik dhe ato më të larta të për diskriminim politik (përfaqësim i pamjaftueshëm) për shkak të besimit fetar.

Perceptimi se *'personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social pikërisht për shkak të besimit fetar'* (21.5%) është më i fortë midis: të intervistuarve meshkuj (26.5% e tyre), personave të grupmoshës 31-35 vjeç (27%) dhe atyre me arsim të mesëm (22.1%). Për sa i përket statusit të punësimit, personat e papunë (25.6%) janë më të prirur të perceptojnë forma

të diskriminimit socio-ekonomik për shkak të besimit fetar. Ky perceptim është më i fortë midis të intervistuarve të cilët janë praktikantë të rregullt të rriteve fetare (36%).

Në lidhje me pyetjen e dytë të kontrollit për këtë nxitës, personat më të prirur të besojnë se *'komuniteti fetar të cilit i përkas nuk është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore'* (51%) janë: meshkuj (56.3% e tyre), grupmosha 31-35 vjeç (57.7%), persona me arsim 9-vjeçar ose më pak (55.3%), dhe të papunë (58.3%). Perceptime të diskriminimit politik (përfaqësim i pamjaftueshëm) për shkak të besimit fetar janë më të theksuara midis të intervistuarve të cilët janë praktikantë të rregullt të rriteve fetare (62%).

Disa prej aktorë kyç të intervistuar në zonat e synuara kanë konfirmuar rolin e diskriminimit shoqëror, ekonomik dhe politik (të përjetuar apo të perceptuar) për shkak të identitetit fetar si nxitës të mundshëm të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Të intervistuarit shpjegojnë se duke qenë se disa prej besimtarëve vijnë nga zona të thella dhe të pazhvilluara të vendit, ndonjëherë ata ndihen inferiorë përballë besimtarëve të qytetit, të cilët janë më të shkolluar dhe të komunikueshëm. Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror i këtyre zonave dhe ndjesia e pabarazisë dhe inferioritetit të personave nga këto zona

i bën ata lehtësisht të manipulueshëm dhe vulnerabël ndaj radikalizmit. Përfaqësimi i papërshtatshëm apo i pamjaftueshëm në media perceptohet si një formë tjetër e diskriminimit shoqëror ndaj besimtarëve myslimanë. Si ilustrim i raportimit të ulët apo mosraportimit në media janë përmendur raste të ndryshme të perceptuara si 'padrejtësi' ndaj besimtarëve myslimanë (p.sh. pretendimi i efektiveve të RENEA-s për largimin diskriminues nga puna për shkak të besimit). Në mënyrë të veçantë, një i intervistuar ka qenë i mendimit se diskriminimi shoqëror për shkak të besimit shprehet edhe në formën e përplasjes 'fanatik/radikal' brenda të njëjtit besim dhe zone gjeografike. Kjo nënkupton se në zona të caktuara ku besimtarët prirën të jenë më fanatikë, është e mundur që këndvështrime të ndryshme të shprehen në mënyra më radikale. Gjithashtu, forma të diskriminimit janë raportuar edhe ndaj personave të kthyer nga konflikti në Siri. Të kthyerit përballen me diskriminim shoqëror (paragjyqime, 'tregohen me gisht' në komunitet) dhe ekonomik (mosgjetja e një pune apo kushtëzimi i saj me 'heqjen e mjekrës apo ndryshimin e veshjes'). Sipas një të intervistuarit, i cili citon një prej personave të kthyer, paragjyqimet, diskriminimi dhe presioni i ndier (përbuzje dhe ndjesia e të qenit nën survejim) e bëjnë të vështirë jetën këtu për këta persona.¹⁰⁶

6.1.4. PRITSHMËRI TË DËSHTUARA DHE PRIVIM RELATIV

"Privimi relativ dhe pritshmëritë e dështuara janë nxitës të fuqishëm për veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm mes të rinjve duke pasur parasysh përmirësimet në arsimim, sidomos në nivelin e shkollës së mesme dhe të universitetit. Të rinjtë me nivel më të lartë arsimor prirën të mendojnë se meritojnë rezultate më të mira në jetë nga ç'mund t'u ofrojë shoqëria e tyre. Në përgjithësi ata nuk mund të marrin vendet punës që mendojnë se i meritojnë; ata e dinë që nepotizmi pengon mundësitë për punë. Meshkujve të rinj mund t'u mungojnë burimet ekonomike që nevojiten për të krijuar familje dhe në përgjithësi në shoqëritë tradicionale ju mohohet mundësia të thonë fjalën e tyre."¹⁰⁷

Gjatë vitit 2014, rreth 32.5% e të rinjve të moshës 15-29 vjeç rezultojnë të papunë.¹⁰⁸ Sipas statistikave zyrtare, grupi më i prekur nga papunësia janë meshkujt e kësaj grupmoshe. Përlllogaritet se të paktën një në tre meshkuj (35.6%) të kësaj grupmoshe nuk kanë një punë. Krahasuar me një vit më parë, papunësia ndërmjet të rinjve të kësaj grupmoshe është thëlluar me rreth 6%. Në të njëjtën kohë, 47,860 persona të moshës 20-34 vjeç janë regjistruar në kërkim të një pune.¹⁰⁹ Në lidhje me nivelin e arsimit të personave të papunë, në vitin 2014 rreth 57 mijë persona të cilët kanë mbaruar arsimin e mesëm janë regjistruar në kërkim të një vendi pune. Në të njëjtën kohë, e njëjta kërkesë është regjistruar nga 8,143 persona, të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë.¹¹⁰

Të dhëna interesante në lidhje me edukimin, punësimin dhe pritshmëritë e të rinjve shqiptarë janë gjeneruar nga studimi në nivel kombëtar "Rinia Shqiptare 2011".¹¹¹ Sipas këtij studimi, i cili bazohet në një anketë kombëtare me 1200 të intervistuar, të cilët janë të rinj të moshës 16-27 vjeç, rezultojnë se:

- Shpërndarja rajonale e papunësisë midis të rinjve nuk është e njëtrajtshme. Punësimi i të rinjve është më i lartë në zonat e Tiranës, Durrësit dhe zonat e tjera urbane dhe më i ulët në zonat rurale të vendit. Në zonat urbane punësimi është në masën 37-38%, ndërsa në zonat rurale në masën 32%.
- Të rinjtë shqiptarë nuk janë shumë optimistë në lidhje me mundësitë e tyre të punësimit në të ardhmen. Rreth 30.7% e të intervistuarve nuk besojnë se do të gjejnë një punë së shpejti. Më pesimistë në këtë drejtim janë të rinjtë meshkuj (50.1%).
- Të rinjtë në zonat rurale shfaqen më pak optimistë për gjetjen e një pozicioni pune në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre nga zonat urbane. Shpresat për gjetjen e një vendi pune zbehen me rritjen në moshë. Gjithashtu, personat që kanë një diplomë pas-universitare kanë pritshmëri më të ulëta se ata me një diplomë universitare.
- Nga të intervistuarit, të cilët e kanë një punë, vetëm një masë e vogël e tyre punojnë në fushën për të cilën janë diplomuar. Rreth 36% e të intervistuarve kishin deklaruar se puna që ata bënin nuk përputhej me diplomën e marrë. Mundësitë për të kryer një punë, e cila përputhet me diplomën e marrë, janë më të pakta në zonat rurale se në ato urbane (respektivisht 26.9% në zonat rurale dhe 38.3% në zonat urbane).
- Të intervistuarit besojnë se për të fituar një vend pune njohjet dhe miqtë janë elementi më i rëndësishëm, i ndjekur nga kapacitetet profesionale, edukimi dhe lidhjet politike. Me rritjen në moshë, vlerësimi për rëndësinë e miqve dhe lidhjeve politike për sigurimin e një vendi pune rritet. Nga ana tjetër, besimi tek rëndësia e kapaciteteve profesionale dhe nivelit të edukimit për sigurimin e një vendi pune zvogëlohen.

Tabloja e mësipërme pasqyron situatën e privimit dhe pritshmërive të dështuara të të rinjve shqiptarë. Roli dhe potenciali radikalizues i privimit dhe zhgënjimit tek të rinjtë është testuar në këtë studim përmes mbledhjes dhe analizimit të perceptimeve të të intervistuarve

në lidhje me këto faktorë. Kështu, të intervistuarve, të cilët kanë qenë ose jo pjesëtarë të komuniteteve fetare në zonat e synuara, u janë parashtruar pohimet e mëposhtme (pyetje kontrolli):


- a) *Të rinjtë e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë mundësi më të larta punësimi.*
- b) *Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku jetoj është puna individuale.*

Rëndësia dhe mundësia që ky nxitës të favorizojë radikalizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm janë vlerësuar mbi bazë të "përgjigjeve negative" për dy pyetjet e mësipërme të cilat testojnë: a) perceptime të pritshmërive të dështuara për punësim të të rinjve të mirë-arsimuar; dhe (b)

perceptime të privimit relativ të të rinjve. Grafiku 9 më poshtë paraqet gjetjet e sondazhit në lidhje me këtë nxitës.

Shumica e të intervistuarve (49%) nuk besojnë se të rinjtë e mirë-arsimuar në zonën e tyre kanë mundësi më të larta punësimi. Ndërsa një pjesë relativisht më e vogël e të intervistuarve (43%) besojnë të kundërtën. Lidhur me këtë, ekzistojnë dallime të theksuara në perceptimet e të intervistuarve në zona të ndryshme. Kështu, 84% e të intervistuarve në Komunën Qendër Librazhd janë të mendimit se të rinjtë e mirë-arsimuar në zonën e tyre nuk kanë mundësi më të larta punësimi. Perceptimet më të ulëta të pritshmërive të dështuara për punësim të të rinjve të mirë-arsimuar shënohen në Kukës (33%) dhe Përrenjas (35%).

Figura 9. Privim relativ dhe pritshmëri të dështuara [Burimi: Sondazhi IDM 2015]



Shumica e të intervistuarve pohojnë se burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë e zonës së tyre është puna individuale (61%). Ndërsa 27% e të intervistuarve nuk besojnë se të ardhurat kryesore të të rinjve sigurohen nga puna e tyre individuale. Në Komunën Qendër-Librazhd dhe në Librazhd shënohet numri më i lartë i të intervistuarve që perceptojnë privim relativ midis të rinjve të zonës së tyre. Respektivisht, 45% e të intervistuarve në Komunën Qendër-Librazhd dhe 38% e të intervistuarve në Librazhd nuk besojnë se puna individuale është burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë. Niveli më i dobët i perceptimit të privimit relativ të të rinjve është në Përrenjas, ku 95% e të intervistuarve besojnë se puna individuale është burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë e kësaj zone.

Perceptimi se *'të rinjtë e mirë-arsimuar në zonën ku banoj nuk kanë mundësi më të larta punësimi'* (49%) është më i fortë midis: të intervistuarve femra (50% e tyre), personave të grupmoshës 41-45 vjeç (59%) dhe atyre të cilët kanë përfunduar vetëm arsimin e detyrueshëm (56%). Për sa i përket statusit të punësimin, personat e papunë (54%) janë më të prirur të perceptojnë zhgënjim të pritshmërive për punësim të të rinjve të mirë-arsimuar në zonën e tyre. Ky perceptim është më i fortë midis të intervistuarve të cilët nuk praktikojnë fenë (53%).

Në lidhje me pyetjen e dytë të kontrollit për këtë nxitës, personat më të prirur të besojnë se *'burimi kryesor i të*

ardhurave për të rinjtë e zonës së tyre nuk është puna individuale' (27%) janë: femra (29% e tyre), persona të grupmoshës 36-40 vjeç (33%), ata të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm (27%), dhe persona të papunë (32%). Perceptime të privimit relativ midis të rinjve janë më të theksuara midis të intervistuarve të cilët nuk janë praktikantë të rregullave dhe riteve fetare (31%).

Në intervistat me aktorë kyç në zonat e synuara është raportuar se niveli i lartë i arsimit i ndërthurur me shkallën e lartë të papunësisë shkaktojnë dekurajim dhe zhgënjim tek të rinjtë të cilët nuk gjejnë asgjë për të bërë në Shqipëri. Si shembull për këtë është sjellë qyteti i Kukësit, i cili ka një nivel të lartë të personave me arsim të lartë (14.12% krahasuar me 11.8% e nivelit të përgjithshëm kombëtar) por në të njëjtën kohë, një shkallë të lartë papunësie midis të rinjve (75% krahasuar me 53% të nivelit të përgjithshëm kombëtar).¹¹² Sipas të intervistuarve, kjo situatë sjell emigrimin apo përfshirjen e tyre në veprimtari të rrezikshme si pasojë e ndikimit, propagandës apo edhe në ndjekje të aventurës. Situata të tilla përjetohen jo vetëm nga të rinjtë e mirë-arsimuar por edhe prej atyre që janë kthyer nga emigracioni dhe nuk kanë një punë apo angazhim të qëndrueshëm në zonën e tyre. Për më tepër, të intervistuarit rekomandojnë trajtimin e problemit të papunësisë së lartë midis të rinjve dhe forcimin e arsimit profesional.

6.1.5. NEVOJA SOCIALE DHE EKONOMIKE TË PAPËRMBUSHURA

"Mospërbushja e nevojave social-ekonomike, veçanërisht kur ndërthuren me faktorë të tjerë, siç janë korrupsioni i përhapur dhe mungesa e sigurisë dhe drejtësisë, mund të jetë një faktor që shfrytëzohet nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat mund të prezantohen me anë të pagave dhe shërbimeve.

*Megjithatë, nuk është varfëria, por forma e tejskajshme e përjashtimit social nga ana e qeverisë dhe shoqërisë që shkakton mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm.*¹¹³

Gjatë viteve të fundit të regjimit komunist dhe fillimet e proceseve demokratike, Shqipëria përshkruhej si vendi më i varfër i Evropës. Kriza e ashpër ekonomike dhe nivelet e larta të papunësisë reflektonin efektet e një vendimi ekstrem për vetë-izolim.¹¹⁴ Nga ana tjetër, institucionet e sistemit të ri politik ishin mjaft të dobëta përballë situatës së emergjencës ekonomike. Në pamundësi për të përthithur ndihma dhe financime nga Perëndimi, në nivelet e kërkuara për tranzicionin normal të vendit, qeveria shqiptare 'hodhi sytë' drejt investimeve dhe financimeve të organizatave dhe vendeve islamike.¹¹⁵ Në një situatë të tillë, dhe vend ku liria e besimit u lejua pas ndalimit me ligj që ishte bërë që nga viti 1967, një numër organizatash jo-qeveritare islamike u prezantuan për herë të parë përmes përfaqësive të tyre në Tiranë dhe zona të tjera të Shqipërisë.¹¹⁶

Në vitin 1997, numri i përfaqësuesve të organizatave islamike në Shqipëri arrinte në 95.¹¹⁷ Ndërsa një pjesë e këtyre organizatave ndërmerrnin aktivitet humanitar, një pjesë tjetër vepruan nën maskimin e 'OJQ-ve bamirëse' duke përfituar nga mungesa e agjencive efikase ligjzbatuese. Fondacionet "bamirëse" që vepronin në Shqipëri si Organizata Ndërkombëtare e Ndihmës Islamike, Fondacioni Al-Haramain, Taibah International, Global Relief Fund, Benevolence International Foundation (Fondacioni Ndërkombëtar i Mirësisë) dhe Revival Islamic Society dyshoheshin ose kishin lidhje me organizata terroriste si Xhiahadi Islamik Egjiptian, Grupin e Armatosur Islamik Algjerian, GIA, dhe Al-Kaedan.¹¹⁸

Përfaqësues të tyre të prezantuar si 'investues' merrnin shtetësinë shqiptare pa ndonjë verifikim të posaçëm paraprak.¹¹⁹

Duke shfrytëzuar varfërinë e përgjithshme dhe mungesën në vend të drejtuesve fetarë të kualifikuar, këto organizata morën një rol aktiv në "rigjallërimin e Islamit" sipas një tradite të panjohur nga shumica myslimane e vendit, ndërsa mënyrat e prezantimit në komunitet ishin përmes financimit të bursave për studime islamike për të rinjtë, ndërtimit të xhamive dhe ndihmave për familjet e varfra, etj.¹²⁰ Karakteristikë e përbashkët e këtyre komuniteteve ishte shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë. Në këmbim të mbajtjes me ndihma të familjeve dhe komuniteteve më të varfra në vend, banorëve u kërkohej të përqafojnë dhe ndiqnin rrymat e tyre fetare.¹²¹ Raste të ngjashme u identifikuan edhe në Përrenjas, Peshkopi, dhe zonën e Qafë-Thanës.¹²²

Historiku i mësipërm hedh dritë mbi situatën dhe kushtet e rënduara social-ekonomike në të cilat gjendeshin zona të caktuara brenda vendit. Ishin pikërisht shkalla e lartë e varfërisë dhe papunësisë në këto zona që i bënë ato vulnerable (të cenueshëm) dhe tërheqëse për aktivitetet e organizatave të tilla të cilat vepruan lirisht në mungesë të vëmendjes dhe kontrollit prej institucioneve shtetërore. Për të kuptuar më shumë kontekstin e sotshëm në eksperiencën ose perceptimin e publikut, të intervistuarve në tetë zonat e synuara nga ky studim, u janë parashtruar pohimet e mëposhtme (pyetje kontrolli):

a) *Institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike në zonën ku banoj punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime.*

b) *Familjet/individët në nevojë në zonën ku jetoj i plotësojnë nevojat bazë të jetesës.*


Rëndësia dhe mundësia që ky nxitës të favorizojë radikalizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm janë vlerësuar mbi bazë të "përgjigjeve negative" për dy pyetjet e mësipërme të cilat mund të nxjerrin në pah: a) perceptime të përjashtimit shoqëror nga institucione jo-efikase dhe të korruptuara; dhe (b) perceptime të mospërbushjes së nevojave bazë dhe cënueshmërisë. Grafiku 10 më poshtë

paraqet gjetjet e sondazhit në lidhje me këtë nxitës.

Shumica e të intervistuarve (57%) nuk besojnë se institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime dhe 17% mendojnë të kundërtën. Këto perceptime paraqiten më të theksuara në Komunën Qendër-Librazhd (75%) dhe Bashkinë Librazhd (68%). Ky perceptim është më i dobët në Komunën Buçimas (45%), megjithëse duhet shtuar se këtu numri i të intervistuarve, të cilët shprehen se nuk kanë dijeni, është më i lartë se në të gjithë zonat e tjera (34%).

Të pyetur nëse individët dhe familjet në nevojë arrijnë të plotësojnë

Figura 10. Nevoja sociale dhe ekonomike të pa përmbushura [Burimi: Sondazhi IDM 2015]



nevojat bazë të jetesës, shumica e të intervistuarve në këtë studim janë përgjigjur negativisht (66%). Ky perceptim është më i përhapur në Komunën Qendër-Librazhd (83%) dhe Bashkinë Librazhd (74%), ndërsa është më pak i përhapur (ndonëse mbizotërues) në Përrenjas (53%).

Perceptimi se *'institucionet e ndihmës sociale dhe ekonomike nuk punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime'* (57%) është më i fortë midis: të intervistuarve meshkuj (61% e tyre), personave të grupmohës 31-35 vjeç (63%), atyre të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm (62%) dhe të intervistuarve të papunë (61%). Gjithashtu, ky perceptim është më i fortë tek të intervistuarit që janë praktikantë të rregullt të riteve fetare (66% e tyre).

Në lidhje me pyetjen e dytë të kontrollit për këtë nxitës, personat më të prirur të besojnë se *'familjet/individët në nevojë nuk i plotësojnë nevojat bazë të jetesës* (66%) janë: meshkuj (72% e tyre), persona të grupmohës 41-45 vjeç (74%), të anketuar me arsimin 9-vjeçar ose më pak (76%), dhe persona të papunë (75%). Ky perceptim është më i theksuar midis të intervistuarve, të cilët janë praktikantë të rregullt të riteve fetare (72%).

Në intervistat me aktorë kyç në zonat

e synuara, duke përfshirë punonjës të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale është raportuar se disa familje në zonat e synuara jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme. Shumë familje të tjera kanë si burim kryesor të ardhurat nga anëtarë të tyre në emigracion (remitanca). Mundësitë e punësimit janë shumë të kufizuara për shkak të administratës së vogël dhe sipërmarrjeve private të pakta. Gjithashtu, njësitë vendore ofrojnë mundësi minimale të formimit profesional. Kështu, të rinjtë në Kukës shkojnë në Kosovë për të ndjekur programe formimi profesional për profesione si mekanik, hoteleri apo informaticien. Të intervistuarit kanë deklaruar, gjithashtu, se ekonomia e dobët ka bërë që personat e rekrutuar dhe radikalizuar të bien 'pre' e manipulimeve. Sipas një gazetari të intervistuar, me eksperiencë në investigimin dhe raportimin e rasteve të personave të radikalizuar dhe larguar drejt konfliktit në Siri, rezultoi se disa prej tyre kanë qenë të punësuar në bizneset private apo xhamitë në të cilat predikohej rryma radikale e Islamit. Një tjetër i intervistuar shpjegon se si marrëdhëniet e punës kanë shërbyer për vendosjen e kontakteve të vazhdueshme dhe vijimin e propagandës duke prodhuar gradualisht radikalizim të personit të punësuar dhe indoktrinuar.

6.1.6. LAKMIA PËR PASURIM TË SHPEJTË DHE PRANIMI PËR TU PËRFSHIRË NË ÇDO AKTIVITET FITIMPRURËS

*"Veprimtaritë e paligjshme të organizatave të ekstremizmit të dhunshëm ofrojnë mundësi ekonomike fitimprurëse për ata që kërkojnë të ardhura shpejta. Rrjetet që janë të përfshira në ekstremizmin e dhunshëm dhe veprimtari ekonomike të paligjshme kanë marrëdhënie me përfitime të ndërsjella, duke i ofruar njëri-tjetrit përvojë për të mbuluar sjelljen e paligjshme dhe ideologjinë për ta legjitimuar atë. Burgjet janë një vend i njohur rekrutimi për ekstremizmin e dhunshëm."*¹²³

Siç është diskutuar më sipër, në fillim të viteve 1990 një numër organizatash jo-qeveritare islamike, të cilat erdhën në Shqipëri ndërmorën veprime të ndryshme si për shembull ndërtim xhamish, ofrim bursash studimore dhe ndihmash financiare për familjet në nevojë, shpërndarje ilaçesh dhe tekste fetare falas, dhe investime në ndërtim dhe sistemin bankar. Në një vend të kapluar nga varfëria, papunësia dhe mungesa e kredive dhe financimeve nga vendet perëndimore për të ndihmuar tranzicionin normal drejt demokracisë, përfaqësitë dhe veprimtaritë e këtyre organizatave u lejuan, madje u mirëpritën. Sipas studiuësit Zoto, organizatat jo-qeveritare të njohura botërisht për lidhje me terrorizmin, të cilat vepruan në Ballkan, u siguronin terroristëve dokumente false të prodhuara lehtësisht në tregun e zi ose nga zyrtarë shtetërorë të korrumpuar, ndërsa përmes transfertave bankare të parave ata financonin udhëtimet e terroristëve nëpër rajon.¹²⁴ Kështu, prezenca e këtyre organizatave solli jo vetëm të ardhura të shpejta dhe ndihma lehtësisht të përfutueshme për familjet e varfra, por përfitime edhe për vetë këto organizata. Në përfundim të aksioneve të ndërmarra nga autoritetet shqiptare nga viti 2001-05 për mbylljen e shumë prej këtyre organizatave jo-qeveritare, deportimin e shtetasve të huaj dhe sekuestrimin e aseteve të bizneseve të tyre private, llogaritet se vlera e këtyre aseteve arrinte në 20 milion dollarë.¹²⁵

Në literaturë është trajtuar lidhja mes përfshirjes në aktivitete të mëparshme kriminale dhe përfshirjes në grupe radikale dhe ekstremizëm të dhunshëm. Në disa raste, përqafimi i pikëpamjeve radikale dhe të dhunshme mund të shërbejë si mjet për justifikimin (para vetes dhe të tjerëve) të përfshirjes së vazhdueshme në aktivitete të paligjshme. Më tej, përqafimi i një

interpretimi veçanërisht të rreptë i fesë mund të shikohet si 'falje' dhe çlirim nga 'mëkatet' kriminale.¹²⁶ Një tjetër vend ku ndërthuren kriminaliteti dhe radikalizmi/ekstremizmi i dhunshëm janë burgjet. Ka të dhëna të mjaftueshme empirike që tregojnë se si burgjet kanë shërbyer si inkubatorë të xhihadizmit selafist. Trajtimi çnjerëzor dhe denigrues nëpër burgje mund të lehtësojë radikalizmin dhe rekrutimin nga grupe të ekstremizmit të dhunshëm.¹²⁷

Për të kuptuar nëse rrethana të tilla kanë relevancë si dhe nëse ndërveprimi kriminalitet-ekstremizëm i dhunshëm përbën rrezik potencial për Shqipërinë, është përdorur dhe analizuar më poshtë informacioni i përfutur nga sondazhi, intervistat dhe fokus grupet e kryera në kuadër të këtij studimi.

Me qëllim mbledhjen e perceptimeve në lidhje me lakminë dhe tolerancën ndaj pasurimit të shpejtë, të intervistuarve u janë parashtruar pohimet e mëposhtme (pyetje kontrolli):


- a) *Të gjithë e duan pasurimin e shpejtë pavarësisht se si arrihet.*
- b) *Çdo mundësi/aktivitet ekonomik që më sjell të ardhura të mira është e pranueshme.*

Grafiku 11 në vijim paraqet gjetjet e sondazhit në lidhje me këtë nxitës.

Shumica e të intervistuarve pohojnë se 'pasurimi i shpejtë pavarësisht se si arrihet' pranohet nga të gjithë (49%). Numri më i madh i të intervistuarve të cilët besojnë në lakminë e përgjithshme për pasurim të shpejtë është në Cërrik (62%) dhe Kukës (61%), ndërsa numri më i vogël i atyre që ndajnë të njëjtin perceptim është në Pogradec (30%).

Në ndryshim nga pyetja e parë e cila ka karakter përgjithësues, shumica e të intervistuarve u përgjigjën negativisht

Figura 11. Lakmia për pasurim [Burimi: Sondazhi IDM 2015]



ndaj pyetjes më të drejtpërdrejtë, nëse për ta është e pranueshme përfshirja në çdo aktivitet fitimprurës (53%). Megjithatë, 38% deklarojnë se çdo aktivitet apo mundësi që do t'u sillte të ardhura të mira do të ishte e pranueshme për ta. Përballë kësaj pyetje, numri i të intervistuarve të pavendosur përgjysmohet në favor të një përgjigjeje negative. Numri më i madh i të intervistuarve me qëndrim pranues ndaj çdo mundësie apo aktiviteti me të ardhura të mira shënohet në komunën Buçimas (një në dy të anketuar apo 51%), ndërsa numri më i vogël rezultojnë në Përrenjas (28%).

Perceptimi se 'të gjithë e duan pasurimin e shpejtë pavarësisht se si arrihet' (49%) është më i fortë ndërmjet të intervistuarve: meshkuj dhe femra në mënyrë të barabartë (49%), personave

të grupmoshës 18-25 vjeç (59%) me arsim të lartë (54%). Për sa i përket statusit të punësimit, ky perceptim është më i fortë midis personave të papunë (53%). Të intervistuarit të cilët nuk praktikojnë rregulla dhe rite fetare (61%) janë më të prirur të besojnë se të gjithë lakmojnë pasurimin e shpejtë pavarësisht se si arrihet.

Në lidhje me pyetjen e dytë të kontrollit për këtë nxitës, 'pranimi i çdo mundësie apo aktiviteti që do të sillte të ardhura të mira' është më i theksuar midis të intervistuarve: meshkuj (41% e tyre), persona të grupmoshës 18-25 vjeç (45%), persona që kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar ose më pak (40%), të papunë (41%). Të intervistuarit që nuk praktikojnë rite fetare (71%) janë më të prirur të përgjigjen pozitivisht ndaj kësaj pyetje.

Në përgjithësi, të intervistuarit kyç të studimit nuk kanë evidentuar ndonjë lidhje midis personave të përfshirë në aktivitete të mëparshme kriminale, qoftë fitimprurëse ose jo, dhe personave të përfshirë në grupe radikale dhe atyre të larguar drejt konfliktit në Siri. Shumë prej tyre kanë shpjeguar se nevoja për të ardhura apo lakmia për pasurim mund të nxisë emigrimin drejt vendeve të Bashkimit Evropian apo edhe përfshirje në aktivitete kriminale fitimprurëse por jo domosdoshmërisht vajtjen si luftëtar i huaj në Siri. Për më tepër, sipas tyre nuk ka fakte që këta persona të radikalizuar të kenë shkuar si mercenarë. Megjithëse burimet e

financimit të udhëtimeve drejt Sirisë të këtyre personave mbetën të paqarta, sipas reporterëve të BIRN rezultojnë se barra financiare ndahet mes imamëve dhe ndjekësve të tyre, të cilët besonin se të financosh një luftëtar është njësoj si të kesh bërë vetë sakrificën e xhihadit. Përmes kësaj teorie, shumë xhihadistë shqiptarë u kthyen njëherazi edhe financues për të tjerët, duke u blerë biletat apo paguar “zekat” për luftën.¹²⁸ Vetëm një prej të intervistuarve në këtë studim ka qenë i mendimit se shumë prej të larguarve xhihadistë kanë pasur probleme ligjore dhe shoqërore në të shkuarën. Sipas tij, precedentët penalë të tyre përfshijnë dënime për prodhim dhe shitje lëndësh narkotike, vjedhje, etj.

6.2. NXITËS POLITIKË

Kuadri i nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm, kuadër i zhvilluar nga Denoeux G. dhe Carter L. (2009), u hartua në kontekstin e vendeve dhe rajoneve (Lindje e Mesme dhe Afrika Veriore si dhe Azia Jugore) që janë shumë të ndryshme nga Shqipëria apo rajoni i Ballkanit Perëndimor, veçanërisht nga perspektiva e treguesve politikë. Si vend anëtar i NATO-s dhe kandidat për në BE, Shqipëria ka bërë hapa të mëdha për zhvillimin e institucioneve dhe proceseve demokratike, qeverisjen dhe shtetin ligjor. Gjithsesi, Shqipëria dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor kanë ende sfida për të arritur e statusit të “demokracive të konsoliduara” sipas shumë vlerësimeve botërore.

Raporti “Freedom in the World” i organizatës Freedom House e konsideron Shqipërinë dhe disa vende të tjera të Ballkanit Perëndimor si

pjesërisht të lira.¹²⁹ Një tjetër dokument i organizatës Freedom House, “Nations in transit”, e përshkruan Shqipërinë si “qeveri tranzitore ose regjim hibrid”.¹³⁰ Po ashtu, në Treguesit Mbarëbotërorë të Qeverisjes 2013, përveç treguesit të “cilësisë rregullatore” ku Shqipëria është para vendeve të tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor, në shumë nga treguesit e tjerë Shqipëria mbetet e fundit në rajon.¹³¹

Pavarësisht diferencave kontekstuale mes Ballkanit Perëndimor dhe rajoneve të tjera të studiuara nga Denoeux dhe Carter, nxitësit politikë të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit fetar mbeten mjaft të aplikueshëm për vendet “pjesërisht të lira” dhe me “regjime hibride”. Megjithatë, ndryshimet dhe variablat e tjerë politike dhe kulturore diktojnë nevojën për një validim të vëmendshëm të nxitësve politikë të ekstremizmit të dhunshëm

në rastin e Shqipërisë. Siç u shpjegua edhe më sipër, IDM ka përjashtuar tre nxitës politikë nga matrica e Denoeux dhe Carter (konfliktet lokale, mbështetja nga shteti, dhe qeveri të diskretituara apo opozitë ligjore inekzistente ose e kooptuar), ndërkohë që vazhdon të

shqyrtojë nga perspektiva e perceptimit të jashtëm dy nxitës të tjerë (pushtimi i huaj dhe kërcënimi politik dhe/ose ushtarak) pavarësisht relevancës së diskutueshme në kontekstin shqiptar. Rrjedhimisht, studimi analizon nxitësit e mëposhtëm politikë.

Tabela 3. Kategoria e nxitësve politikë

NXITËSI	PËRSHKRIMI
Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile	Mungesa e të drejtave politike dhe lirive civile dhe ekzistenca e një sistemi politik të mbyllur e të papërgjegjshëm mund të mbrujnë një besim se dhuna është mjete i vetëm që sjell ndryshimin politik. Edhe liritë civile e të drejtat politike mund të përfaqësojnë një lidhje kritike, por jo përfaqësuese, mes zhvillimit ekonomik dhe cenueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.
Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut	Drejtësia është vlerë me rëndësi kritike në Islam. Trajtimi mizor e degradues (përfshirë këtu edhe torturën) i një individi në duart e policisë apo forcave të sigurisë mund të çojë në dëshirën për hakmarrje. Sa më i ashpër e më i përhapur të jetë brutaliteti, aq më e madhe do të jetë përhapja e veprimtarive të ekstremizmit të dhunshëm dhe aq më shumë mbështetje do të marrë ekstremizmi i dhunshëm nga komunitetet vendore.
Pushtimi i huaj	Vendet nën pushtimin e huaj ushtarak përballen me rrezikun e kryengritjeve dhe abuzimit me të drejtat. Mbështetja për veprimtaritë e ekstremizmit të dhunshëm mund të vijë nga njerëz që duan të hakmerren për turpërimin e tyre personal ose të komunitetit.
Kërcënimi/Cënimi politik dhe/ose ushtarak	Ndërhyrja politike apo ushtarake në shkallë të gjerë në punët e brendshme mund të shërbejë si element bashkues, ku komuniteti i kthehet dhunës për të rikthyer nderin individual dhe kolektiv. Në komunitetet që historikisht kanë pasur shkallë të lartë autonomie dhe vetë-rregullimi, ka gjasa të ketë rezistencë të fortë
Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta	Ky nxitës shkakton të paktën pasivitet civil e apati politike dhe mund të ushqejë një ndjesi të madhe të dhunës morale. Sa më i korruptuar të jetë mjedisi, aq më të lehtë e kanë grupet e ekstremizmit të dhunshëm të shpallin veten si alternativa e drejtë dhe t'i sulen elitave imorale qeverisëse.

NXITËSI	PËRSHKRIMI
Zona të paqeverisuar ose të qeverisuar dobët	Këto zona janë të izoluara, rajone me dendësi të ulët të popullsisë dhe që përbëjnë vatra të sigurta ku grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të krijohen pa pengesa të mëdha dhe, madje, të marrin mbështetje nga komunitetet e lëna në harresë nga qeveria. Duhet të kuptohet se grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të tërhiqen drejt “shteteve me forcë të kufizuar”, në krahasim me shtetet e dështuara apo në dështim e sipër, ku mund të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar rrjetin e tyre dhe për të kryer operacionet.
Frikësimi apo kërcënim nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm	Aty ku qeveritë nuk mund t’u japin qytetarëve të tyre mbrojtje dhe siguri, grupet e ekstremizmit të dhunshëm do të përdorin frikën dhe kërcënimin për të detyruar mbështetje për lëvizjen e tyre.
Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë	Popullsia mund të pranojë propagandën e ekstremizmit të dhunshëm se sistemi botëror politik dhe ekonomik diskriminojnë botën myslimane, gjë që mund të ngatërrohet me ndjenjat personale ose komunitare të diskriminimit.

Burimi: *Guilain Denoeux dhe Lynn Carter (2009)*

Në pjesën e mëposhtme të këtij seksioni shtjellohen gjetjet për secilin nga nxitësit e bazuar në burime parësore e dytësore të informacionit.

6.2.1. MOHIMI I TË DREJTAVE POLITIKE DHE LIRIVE CIVILE

Mungesa e të drejtave politike dhe lirive civile dhe ekzistenca e një sistemi politik të mbyllur e të papërgjegjshëm mund të mbrojnë një besim se dhuna është mjeti i vetëm që sjell ndryshimin politik. Edhe liritë civile e të drejtat politike mund të përfaqësojnë një lidhje kritike, por jo përfaqësuese, mes zhvillimit ekonomik dhe cenueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Raporti “Liria në Botë” (Freedom in the World) i organizatës Freedom House mat tre kategori të drejtash politike (procesi zgjedhor; pluralizmi politik dhe

pjesëmarrja; funksionimi i qeverisë) dhe katër të tjera nga liritë civile (liria e shprehjes dhe besimit; të drejtat e krijimit dhe pjesëmarrjes në shoqata

e organizata; shteti ligjor; autonomia personale dhe të drejtat e individit).¹³² Sipas këtij burimi, Shqipëria ruan të njëjtin status në 2015 tek të gjitha nënkategoritë e të drejtave politike dhe lirive civile.¹³³ Procesi zgjedhor dhe funksionimi i qeverisë (të drejtat politike) dhe shteti ligjor e autonomia personale dhe të drejtat e individit (liritë civile) duket se janë nënkategoritë më të dobëta në këto vitet e fundit. Edhe pse vendi nuk vuan nga mungesa totale e të drejtave dhe lirive, (renditja e përgjithshme – “pjesërisht i lirë”), besimi i publikut tek partitë politike dhe disa institucione shtetërore (p.sh., gjyqësor) është në nivel më të ulët rekord.¹³⁴ Zbatimi në praktikë i kuadrit, përgjithësisht të përparuar ligjor në këtë drejtim shpesh konsiderohet si shqetësim. Raporti i Progresit për Shqipërinë (2014) i Komisionit Evropian (KE) sugjeron se “edhe pse Shqipëria ka ratifikuar pjesën më të madhe të konventave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duhet të veprohet më shumë në drejtim të zbatimit të tyre.”¹³⁵ Gjithsesi, për sa i përket lirisë fetare, Shqipëria merr vlerësime nga pjesa më e madhe e burimeve të referuara më sipër.¹³⁶

Përkundër këtij kuadri të gjerë që mund të krijohet hapësira për veprimtari radikale dhe të ekstremizmit të dhunshëm, studimi i IDM-së shqyrton perceptimin e qytetarëve, anëtarë dhe jo anëtarë të bashkësive fetare në zonat e synuara. Në sondazhin e IDM-së të intervistuarit u pyetën nëse ishin dakord me dy pohimet e mëposhtme (pyetjet kontroll):

- a) *Përgjithësisht, të drejtat dhe liritë civile të qytetarëve respektohen nga institucionet shtetërore; dhe*
- b) *Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar edhe me dhunë po qe nevoja.*


Rëndësia dhe potenciali i këtij nxitësi për të krijuar hapësirë për radikalizimin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm vlerësohen në bazë të “përgjigjeve negative” për “pyetjen e parë të kontrollit” (mohimi i të drejtave dhe lirive civile të qytetarëve) dhe qëndrimit pohues për të dytën (përdorimin e forcës për ndryshimin e sistemit politik). Në grafikun 12 paraqiten gjetjet e sondazhit në këtë aspekt.

Pjesa më e madhe e të intervistuarve, 55%, besojnë se institucionet shtetërore nuk tregojnë respekt për të drejtat dhe liritë civile të qytetarëve. Një perceptim i tillë është më shumë i pranishëm tek të intervistuarit nga zonat rurale – komunat Qendër Librazhd (76%) dhe Buçimas (60%) – dhe ky perceptim mbizotëron përgjithësisht brenda secilës kategori demografike. Më pak se një e treta e të anketuarve (30%) nga të gjitha tetë zonat e synuara besojnë se institucionet shtetërore i respektojnë të drejtat dhe liritë, ndërsa të intervistuarit në Kukës dhe Cërrik tregojnë përqindje më të lartë të këtij këndvështrimi (43% secili).

Siç tregohet edhe në grafikun 12, një e katërta e të intervistuarve të sondazhit (26%) besojnë se “Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar edhe me dhunë po qe nevoja.” Kjo pikëpamje është më e pranishme në Kukës (44%) dhe Komunën Buçimas (32%). Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e të intervistuarve që nuk bien dakord me pohimin vijnë nga zonat e Cërrikut (74%), Komuna Qendër Librazhd (72%) dhe Librazhd (60%).

Demografia e përgjithshme e të intervistuarve të cilët besojnë se “Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar edhe me dhunë po qe nevoja” (26%) reflekton karakteristikat demografike të shumicës së të intervistuarve (të rinj, meshkuj, të papunë, me arsim të mesëm). Megjithatë, ky nuk është

Figura 12. "Mohimi i të drejtave/lirive" vs. "Përdorimi i dhunës" [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]



tregues për të nxjerrë përfundime mbi karakteristikat e një "të intervistuarit tipik", sepse gjetjet mund të anojnë si rezultat i një kampionimi me kuota (jo-probabilitetit) të aplikuar. Për një pamje më të mirë të tendencave të tilla kemi shqyrtuar peshën specifike që mbart secila prej kategorive të demografisë dhe krahasimi brenda dhe mes nëngrupeve/kategorive.

Në mënyrë të veçantë, pikëpamja se "Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar edhe me dhunë po qe nevoja" është e pranishme tek të intervistuarit meshkuj (30.9% e të gjithë të intervistuarve meshkuj). Duke analizuar grupmoshat e të intervistuarve që e konfirmojnë këtë pohim, kjo pikëpamje përfaqësohet

më shumë tek të intervistuarit e rinj të grupmoshës 18-25 vjeç (34.7% e të gjithë të intervistuarve të kësaj grupmoshe) dhe 26-30 vjeç (26.4%). Niveli arsimor i të intervistuarve tregon se ata që e konsiderojnë "Sistemin politik në Shqipëri si të padrejtë (dhe që duhet ndryshuar edhe me dhunë po qe nevoja)" kanë një përqindje më të lartë mes të intervistuarve me arsim universitar (29.6% e të gjithë të intervistuarve nga kjo kategori) dhe atyre me deri në nëntë vjet arsim (28.2%). Edhe të intervistuarit e papunë priren të kenë këtë pikëpamje pasi 28.4% e të gjithë të intervistuarve të papunë janë të mendimit se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar edhe me dhunë po qe nevoja.

Analiza e të dhënave tregon prirje interesante kur përqindja e atyre që thonë se “sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet të ndryshojë edhe me dhunë po qe nevoja” (26%) është analizuar në kuadër të kategorive të të intervistuarve që “praktikojnë të gjitha ritet fetare”, që “praktikojnë vetëm ato kryesoret” ose që “nuk e praktikojnë fare fenë”. Në mënyrë të veçantë, kjo pikëpamje është më e përfaqësuar në kategorinë e të intervistuarve të cilët nuk praktikojnë fare ritet dhe rregullat fetare (37,7% e të intervistuarve që nuk praktikojnë ritet fetare).

Puna në terren e studimit – intervista me aktorët kyçë në nivel vendor në të tetë zonat e synuara – nuk raportoi për spikatje të këtij nxitësi apo rëndësisë më të madhe të tij për mundësimin

e radikalizimit fetar, edhe pse nga disa prej tyre raportohen raste të caktuara të trajtimit të padrejtë të besimtarëve myslimanë, veçanërisht nga institucionet e sigurisë. Megjithatë, disa informues nga Tirana (kryesisht ekspertë dhe profesionistë), të intervistuar gjatë fazës fillestare të studimit, ishin të mendimit se perceptimi i “mohimit të të drejtave politike dhe lirive civile” mund të ndikojë në sjelljen e individëve ose grupeve të izoluara të qytetarëve besimtarë. Një skenar i tillë nuk mund të përjashtohet duke pasur parasysh rezultatet e sondazhit të IDM-së sipas të cilit 22.5% e të gjithë të intervistuarve që praktikojnë ritet fetare dhe 20.2% e atyre që e praktikojnë vetëm ritualet kryesore fetare ndajnë pikëpamjen se sistemi politik është i padrejtë dhe duhet të ndryshojë qoftë edhe me dhunë.


6.2.2. SHTYPJA E PAMËSHIRSHME NGA QEVERIA DHE SHKELJA FLAGRANTE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Drejtesia është vlerë me rëndësi kritike në Islam. Trajtimi mizor e degradues (përfshirë këtu edhe torturën) i një individi në duart e policisë apo forcave të sigurisë mund të çojë në dëshirën për hakmarrje. Sa më i ashpër e më i përhapur të jetë brutaliteti, aq më e madhe do të jetë përhapja e veprimtarive të ekstremizmit të dhunshëm dhe aq më shumë mbështetje do të marrë ekstremizmi i dhunshëm nga komunitetet vendore.

Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe politikave anti-diskriminuese është një nga pesë prioritetet e KE-së në të cilën Shqipëria duhet të tregojë përparim në mënyrë që të hapë negociatat për anëtarësim në BE. Si përgjigje ndaj këtij prioriteti Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës në Zyrën e Avokatit të Popullit ka monitoruar në mënyrë aktive situatën në burgjet dhe qendrat e paraburgimit. Edhe pse Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë

trajtimin dhe dënimin mizor, çnjerëzor ose degradues, Departamenti Amerikan i Shtetit në Raportin e të Drejtave të Njeriut për Shqipërinë për vitin 2013 raporton për keqtrajtim nga policia dhe rojet e burgut të të dyshuarve dhe të ndaluarve.¹³⁷ Megjithatë, pavarësisht rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut të raportuar në mënyrë sporadike nga organizatat e shoqërisë civile dhe media gjatë viteve të fundit, Shqipëria

Figura 13. Përqindja e mbështetjes për të bërë sheriatin ligj zyrtar [Burimi: Të dhëna të Pew Research Center 2013]



aktualisht nuk është "pikë e nxehtë" e represionit të ashpër qeveritar ose shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.

Në një raport vlerësimi të IDM-së për integritetin dhe korrupsionin policor (2014) konstatohet se edhe pse përdorimi i dhunës së tepërt nga policia nuk ndodh shumë shpesh sipas pjesës më të madhe të publikut,¹³⁸ qëndrimi tolerant i punonjësve të policisë ndaj këtij akti është mjaft shqetësues.¹³⁹ Nga ana tjetër, Raporti i Progresit të KE-së për vitin 2014 sugjeron ndërmarrjen dhe forcimin e veprime të mëtejshme për të përmbushur rekomandimet e Avokatit të Popullit.¹⁴⁰

Duke pasur parasysh sa më sipër, studimi i IDM-së analizoi burime dhe të dhëna të ndryshme në lidhje me këtë nxitës dhe ndikimin e tij të mundshëm në krijimin e veprimtarive të ekstremizmit të dhunshëm, në mënyrë të veçantë mes anëtarëve të bashkësisë më të madhe fetare (të besimtarëve myslimanë).

Një sërë informuesish kyç të këtij studimi gjatë fazës fillestare sugjeruan se reagimi i ashpër dhe shkeljet nga autoritetet policore mund të tkurrin jo vetëm besimin e publikut tek ky institucion, por edhe tek sistemi i rregullave dhe ligjeve të shtetit. Ashtu siç sugjeron përshkrimi i këtij nxitësi se "drejtësia është një vlerë e rëndësishme në Islam", studimi shqyrton qëndrimin në tërësi të të intervistuarve në lidhje me rregullat fetare në krahasim me rregullat e shtetit si dhe pikëpamjen e tyre në një situatë kur institucionet shtetërore i privojnë ata nga të drejtat dhe liritë e tyre. Në mënyrë të veçantë, "pyetjet kontroll" të sondazhit të IDM-së (për të cilat të intervistuarit u pyetën nëse bien dakord apo jo) për këtë nxitës janë:

- a) Rregullat fetare janë më të drejta sesa ato shtetërore
- b) Njerëzit kanë të drejtë të hakmerren kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore

66% e të intervistuarve besojnë se “Rregullat fetare janë më të drejta sesa ato shtetërore”, 17% nuk janë dakord me këtë pohim dhe një tjetër 17% nuk kanë opinion për këtë pohim. Gjithsesi, kjo gjetje përshkruan një karakteristikë të përgjithshme të të intervistuarve besimtarë (69% e kampionit të sondazhit të IDM-së përbëhet nga të intervistuar që praktikojnë të gjitha ritet fetare ose të paktën ato më kryesoret), të cilët besojnë në “natyrën hyjnore të Zotit”. Rrjedhimisht, kjo nuk nënkupton


domosdoshmërisht gatishmërinë apo mbështetje për zëvendësimin e rregullave të shtetit me ato fetare (p.sh., ligjin e sheriatit për bashkësinë myslimane).

Nga ana tjetër, një studim i Qendrës Kërkimore Pew (2013) sugjeron se komuniteti mysliman në Shqipëri shfaq mbështetjen më të ulët për “sheriatin si ligj zyrtar” në krahasim me vendet e tjera në Evropën Juglindore.¹⁴¹

Në pohimin e mëposhtëm të pyetur në sondazhin e IDM-së mund të evidentohet potenciali për vepra të ekstremizmit të dhunshëm apo radikale nga individë si përgjigje për shkeljen e të drejtave të njeriut nga institucionet shtetërore.

Figura 14. Hakmarrja ndaj institucioneve [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Njerëzit kanë të drejtë të hakmerren kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore



Edhe pse pjesa më e madhe e të intervistuarve (55%) nuk e mbështesin “hakmarrjen”, një tjetër 30% e favorizon

një reagim të tillë, kur institucionet shtetërore u mohojnë të drejtat dhe liritë e tyre. Pjesa më e madhe e kësaj

kategorie e të anketuarve evidentohen në Bulqizë. Në mënyrë të veçantë, 55% e të anketuarve nga kjo zonë besojnë se njerëzit kanë të drejtë të hakmerren, kur institucionet shtetërore u mohojnë të drejtat dhe liritë e tyre. Mbështetja më e ulët për "hakmarrjen" evidentohet në Cërrik, ku 85% e të anketuarve nga kjo bashki nuk pajtohen me pohimin e mësipërm dhe vetëm 12% janë dakord me të (3% u përgjigj 'nuk e di').

Nga analiza e mëtejshme demografike e grupit prej 30% të të intervistuarve që favorizojnë "hakmarrjen" tregohet se kjo pikëpamje është më e pranishme mes të anketuarve meshkuj, që përfaqësojnë 34,5% të të gjithë të intervistuarve meshkuj; përgjigje-dhënësit e grupmohës "18-25 vjeç" (36.4% e të gjithë të intervistuarve të kësaj moshe); dhe të intervistuarit me nivel arsimor deri në nëntë klasë (31.5%) dhe me arsim të mesëm (31.1%); si dhe të intervistuarit e papunë (30.6%).¹⁴²

Për sa i përket "ushtrimit të fesë", të intervistuarit që "favorizojnë hakmarrjen kur institucionet shtetërore u mohojnë të drejtat" (30%) qëndrojnë në përqindje të përafërta tek të tre kategoritë. Në mënyrë të veçantë, kjo pikëpamje ndahet nga 33.3% e të anketuarve që nuk e praktikojnë fenë, 30.2% e atyre që praktikojnë ritet kryesore dhe nga 28.5% e të anketuarve të cilët praktikojnë rregullisht rregullat dhe ritet fetare.

Puna në terren e këtij studim, në mënyrë të veçantë intervistat gjysmë të strukturuar, nxjerrin në pah dallimet por edhe të përbashkëta e perspektivës mes informuesve kyçë jo-shtetërorë dhe atyre që përfaqësojnë institucionet shtetërore. Edhe pse në përgjithësi të gjithë informuesit bien dakord se "represioni i ashpër i qeverisë dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut" nuk përfaqëson episode të përsëritura në Shqipëri, shqetësime

ngrihen në lidhje me reagimin dhe veprimet e shtetit në rastet e fundit të aktivitetit radikal islamik në vend. Konkretisht, siç konfirmohet nga shumë prej intervistave gjysmë të strukturuar të këtij studimi, informuesit kyçë nga agjencitë shtetërore jashtë sektorit të sigurisë në nivel qendror apo vendor nuk raportojnë për ndonjë aktivitet të institucionit të tyre për të trajtuar radikalizimin fetar në Shqipëri. Mesazhi i përcjellë nga shumë prej informuesve kyçë është se "nëse përgjigja e parë dhe e vetme për një veprimtari të tillë janë masat shtypëse, një gjë e tillë mund të çojë në efekte të kundërta." Këta informues kyçë raportojnë edhe për efektet negative që vijnë nga hetimet e policisë dhe teknikave të aplikuara të mbikëqyrjes në kuadër të aktiviteteve të dyshuara radikale islamike, të cilat tek komuniteti i besimtarëve krijojnë ndjenjën e shtypjes dhe shkeljes së të drejtave të njeriut. "Në vend të kësaj, policia, por veçanërisht institucionet e tjera shtetërore, duhet të bashkëpunojnë me institucionet fetare dhe komunitetet e tyre për të kuptuar më mirë se cilat janë nevojat e ngutshme dhe shqetësimet e anëtarëve të tyre."¹⁴³

Mangësi të tilla në përfaqësimin e aktorëve shtetërorë pranohen në një shkallë të caktuar edhe nga disa prej informuesve kyçë nga agjencitë e zbatimit të ligjit, të cilët janë të mendimit se "parandalimi i radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm duhet të bëhet më herët dhe duhet të drejtohet nga institucione të tjera (jo të sigurisë)."¹⁴⁴

6.2.3. NXITËSIT “PUSHTIMI I HUAJ” DHE “CËNIMI POLITIK DHE/OSE USHTARAK”

Nxitësi ‘pushtimi i huaj’: Vendet nën pushtimin e huaj ushtarak përballen me rrezikun e kryengritjeve dhe abuzimit me të drejtat. Mbështetja për veprimtaritë e ekstremizmit të dhunshëm mund të vijë nga njerëz që duan të hakmerren për turpërimin e tyre personal ose të komunitetit.

Nxitësi ‘Cënimi politik dhe/ose ushtarak’: Ndërhyrja politike apo ushtarake në shkallë të gjerë në punët e brendshme mund të shërbejë si element bashkues, ku komuniteti i kthehet dhunës për të rikthyer nderin individual dhe kolektiv. Në komunitetet që historikisht kanë pasur shkallë të lartë autonomie dhe vetë-rregullimi, ka gjasa të ketë rezistencë të fortë.

Nxitësit “Pushtimi i huaj” dhe “Kërcënimi/cënimi politik dhe/ose ushtarak” nuk përshkruajnë realitetin aktual të Shqipërisë. Gjithsesi, faza fillestare e këtij studimi arriti në përfundimin se konteksti shqiptar dhe popullsia e synuar e këtij studimi duhet të analizohen në lidhje me të dy këta nxitës nga perspektiva e përcaktimit të perceptimeve për mbështetjen e mundshme të fenomenit të manipulimit fetar të shtetasve shqiptarë që bashkohen si luftëtarë të huaj në konfliktin sirian.

Edhe pse mungon informacioni zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) apo Policia e Shtetit (PSH) për numrin e saktë të shtetasve shqiptarë të përfshirë në këtë konflikt, vlerësimet e fundit tregojnë se ky numër mund të jetë mes 90 dhe 148 vetëve.¹⁴⁵ Vlerësohet se të paktën 13 shtetas shqiptarë kanë udhëtuar për në Siri me familjet e tyre mes viteve 2012 dhe 2015.¹⁴⁶

Në korrik të vitit 2014 Shqipëria bëri ndryshime në Kodin Penal në lidhje me pjesëmarrjen (përfshirë organizimin ose thirrje për pjesëmarrje) në veprimet ushtarake në një vend të huaj.¹⁴⁷ Shumë prej informuesve kyçë të këtij studimi raportuan se disa prej shtetasve

shqiptarë të përfshirë në konfliktin sirian u kthyen në vend para hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve për të shmangur pasojat ligjore dhe akuzat e mundshme.¹⁴⁸ Në mars 2014 Policia e Shtetit arrestoi një grup prej nëntë radikalësh islamikë me akuzën e rekrutimit të luftëtarëve për t’iu bashkuar konfliktit sirian dhe nxitjes së terrorizmit. Që prej muajit shkurt 2015 çështja e tyre është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda në Tiranë.

Ndërkohë që media raporton rregullisht për çështjen e luftëtarëve të huaj dhe reagimin e institucioneve shtetërore në Shqipëri apo për zhvillimet e ngjashme në vendet fqinj si Kosovë (përfshirë protestat e mbështetësve të grupeve të përndjekura), Komuniteti Mysliman Shqiptar ka udhëzuar klerikët vendorë të punojnë ngushtësisht me xhematin me qëllim ndalimin e radikalizimit fetar.¹⁴⁹ Megjithatë, shumë nga informuesit kyçë të këtij studimi sugjerojnë se përpjekjet e KMSH-së në këtë drejtim duhet të përforcohen edhe më tej. Po ashtu, mungesa e veprimit nga ana e disa institucioneve shtetërore jashtë kuadrit të agjencive të zbatimit të ligjit ka formësuar një përjasje të “*trajtimit të pasojave të një problemi strikt të sigurisë.*” Informuesit kyçë

të këtij studimi argumentojnë se “një përfaqje e tillë është e papërshtatshme, sepse ajo lë jashtë fokusit elementë të rëndësishëm – shkaqet bazë dhe nevojën për parandalimin që duhet të shtjellohen në bashkëpunim të ngushtë me institucionet fetare dhe agjencitë përkatëse shtetërore jashtë sektorit të sigurisë.”¹⁵⁰

Për të përcaktuar perceptimet e publikut dhe komunitetit më të madh fetar (ai mysliman) në zonat e synuara në lidhje me këta nxitës (pushtimi i huaj dhe kërcënimi politik/ushtarak), në këtë studim u pyetën të intervistuarit nëse ishin dakord me pohimet e mëposhtme të kontrollit.

- a) Misionet ushtarake të Shqipërisë në Afganistan e Irak janë një fyerje për myslimanët.
- b) Është detyrë e çdo besimtarit të mbrojë vlerat dhe dinjitetin fetar me çdo mjet brenda dhe jashtë kufijve.


Logjika e një zgjedhjeje të tillë është

të krahasohen dy “argumente” të ndërlidhura që përdoren shpesh nga grupet dhe/ose individë radikalë islamikë në Shqipëri, siç raportohet nga pjesa më e madhe e informuesve kyçë të këtij studimi. Konkretisht, edhe pse këto grupe i inkurajojnë besimtarët myslimanë të rifitojnë dinjitetin e komunitetit të tyre fetar brenda dhe jashtë kufijve të vendit, nga ana tjetër ato i konsiderojnë misionet ushtarake të Shqipërisë në vendet myslimane një turp dhe fyerje për myslimanët.

Siç tregohet edhe në grafikun 15, 24% e të intervistuarve i konsiderojnë misionet ushtarake të Shqipërisë në Afganistan dhe Irak si fyerje për myslimanët. Kjo pikëpamje është më e pranishme në dy zona të këtij studimi që janë edhe gjeografikisht shumë pranë njëra tjetrës, Pogradec (39%) dhe Buçimas (36%), ndërkohë që të intervistuarit nga Komuna Qendër-Librazhd kanë përqindjen më të ulët. Specifikisht, vetëm 8% e të intervistuarve nga kjo komunë besojnë se këto misione janë një fyerje për myslimanët.

Figura 15. Qëndrimi ndaj misioneve ushtarake [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Misionet ushtarake të Shqipërisë në Afganistan e Irak janë një fyerje për myslimanët




Ky opinion ka më shumë mbështetës mes të intervistuarve "aktivë nga pikëpamja fetare". Me fjalë të tjera, 34.3% e të gjithë të anketuarve që praktikojnë rregullisht fenë janë dakord me këtë pohim. Në karakteristikat e tjera demografike të këtij grupi (që i konsiderojnë misionet ushtarake të Shqipërisë si fyerje më myslimanët) përfshihen: 27.3% e të intervistuarve meshkuj të këtij sondazhi (19.2% e të intervistuarve femra në këtë sondazh); përqindje më të larta brenda grupmoshave "26-30 vjeç" (30%) dhe

"31-35 vjeç" (27.7%). Këta të intervistuar qëndrojnë pothuajse në të njëjtat përqindje (midis 22% dhe 25%) brenda secilës kategori tjetër demografike, pra niveli arsimor (bazë, të mesëm dhe të lartë) apo statusi i punësimit.

Në lidhje me pohimin e dytë të kontrollit për këta nxitës, pothuajse gjysma e të intervistuarve (47%) besojnë se "është detyrë e çdo besimtarit të mbrojë vlerat dhe dinjitetin fetar me çdo mjet brenda dhe jashtë kufijve."

Figura 16. Mbrojtja e vlerave dhe dinjitetit fetar [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Besimtarët duhet të mbrojnë vlerat dhe dinjitetin fetar me çdo mjet brenda dhe jashtë kufijve.



Ky opinion është i pranishëm tek të intervistuarit në zonat e Bulqizës (78% e të intervistuarve nga kjo zonë) dhe Përrenjas (62%). Analiza e karakteristikave demografike të këtyre të intervistuarve në krahasim me totalin e kampionit brenda secilit tipar demografik tregon se pjesa më e madhe e tyre janë meshkuj (52% e të gjithë meshkujve të intervistuar);

grupi vjen nga përqindje më të mëdha të kategorive të grupmoshës "31-35 vjeç" (53.7% dhe "26-30 vjeç" (50.3%). Po ashtu, pjesa më e madhe e të intervistuarve që kanë përfunduar arsimin e mesëm (52%) dhe afro 50% e të intervistuarve të punësuar janë dakord me këtë pohim. Së fundi, kjo pikëpamje mbështetet nga 59% e të intervistuarve që praktikojnë

rregullisht fenë e tyre, 43.3% e atyre që praktikojnë ritet kryesore dhe 38.4% e të intervistuarve jo-besimtarë (që nuk praktikojnë fare ritet/rregullat fetare).

Përkundër këtyre të dhënave dhe pavarësisht rasteve të përfshirjes së shtetasve shqiptarë në konfliktin sirian, shumë nga informuesit kyçë argumentojnë se dhuna nuk mbështetet nga xhemati në Shqipëri. Diskutimet e fokus-grupeve me besimtarët myslimanë që praktikojnë besimin sugjerojnë se pyetja e ngritur në sondazhin e IDM-së (*"është detyrë e çdo besimtarit të mbrojë vlerat dhe dinjitetin fetar me çdo mjet brenda dhe*

jashtë kufijve") mund të jetë keqkuptuar dhe përgjigjet e pjesës më të madhe të besimtarëve myslimanë ndoshta nuk i referohen 'dhunës'.

*"Islami e refuzon dhunën. Sondazhi i IDM-së tregoi se mbështetja "për ndryshimin e sistemit politik me dhunë" vjen nga njerëzit që nuk e praktikojnë fare fenë. Ata nuk e dinë se ç'është Islami ose janë të manipuluar."*¹⁵¹

Raporti i Qendrës Kërkimore Pew "Myslimanët e Botës: Feja, Politika dhe Shoqëria" sugjeron se myslimanët e Shqipërisë e refuzojnë me bindje dhunën në emër të Islamit.¹⁵²

6.2.4. KORRUPSIONI I PËRHAPUR DHE PANDËSHKUESHMËRIA E ELITAVE ME LIDHJE TË FORTA

Ky nxitës shkakton të paktën pasivitet civil dhe apati politike dhe mund të ushqejë një ndjesi të madhe të dhunës morale. Sa më i korruptuar të jetë mjedisi, aq më të lehtë e kanë grupet e ekstremizmit të dhunshëm të shpallin veten si alternativa e drejtë dhe t'i sulen elitave imorale qeverisëse.

Korrupsioni i përhapur minon kapacitetin e shtetit dhe bën të mundur krijimin e zonave të "paqeverisura", "me qeverisje të pamjaftueshme", "të keq-qeverisura", apo "të qeverisura dobët", të cilat, nga ana e tyre, mund të krijojnë mundësi për grupet e ekstremizmit të dhunshëm.¹⁵³ Korrupsioni dhe pandëshkueshmëria përfaqësojnë disa nga shqetësimet më kryesore prej shumë vitesh në Shqipëri. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2014) vëren se "korrupsioni është i përhapur në shumë fusha, përfshirë këtu gjyqësorin dhe zbatimin e ligjit, dhe mbetet në veçanti një problem serioz."¹⁵⁴ Në fakt, lufta kundër korrupsionit dhe forcimi i mëtejshëm i kuadrit të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve të rasteve të korrupsionit,

veçanërisht të nivelit të lartë, përfaqësojnë një nga pesë prioritetet për Shqipërinë në mënyrë që të hapen negociatat për anëtarësim në BE.

Raporti më i fundit i organizatës Transparency International, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (2014) e rendit Shqipërinë në vendin e 110 nga 176 shtete të përfshira në raport. Pavarësisht përmirësimeve nga viti 2013 (ku vendi renditej i 133ti), Shqipëria mbetet ende vendi më i korruptuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor së bashku me Kosovën, ku të dy vendet kanë të njëjtat pikë 33.¹⁵⁵ Për më tepër, "Legjitimiteti i shtetit" është treguesi i dytë më i dobët i Shqipërisë me 6.5 pikë (menjëherë pas "Largimit të njerëzve" me 6.9) të raportit më të fundit "Indeksi i shteteve të brishta 2014", i cili sugjeron se korrupsioni dhe mungesa e përfaqësimit pengojnë në


mënyrë të konsiderueshme kontratën e shoqërisë.¹⁵⁶

Në vitet e fundit në Shqipëri janë ndërmarrë shumë nisma për të nxitur qytetarët të denoncojnë korrupsionin në sektorët shtetërorë e jo-shtetërorë.¹⁵⁷ Megjithatë, duke pasur parasysh se gjyqësori konsiderohet si institucioni shtetëror më i korruptuar dhe më pak i besueshëm, publiku është skeptik për rezultatet.

Raporte dhe vlerësime të shumta arrijnë në përfundimin se me një fenomen të tillë të përhapur dhe veprimet vazhdimisht të dështuara të shtetit për të mundur rezultate të qëndrueshme, besimi i publikut tek institucionet dhe më gjerë,


tek përpjekjet për të trajtuar këto shqetësime, është në nivel të ulët rekord. Një studim i fundit (IDRA 2015) sugjeron se 96% e qytetarëve të anketuar e konsiderojnë mosndëshkimin si fenomen mjaft të përhapur: “Sipas qytetarëve, ligji aplikohet në mënyra të ndryshme për ta (qytetarët e zakonshëm), në krahasim me një person që ka pushtet”, që do të thotë se qytetarët kanë më shumë gjasa të dënohen për të njëjtat shkelje në krahasim me personat me pushtet.¹⁵⁸ Grafikët e mëposhtëm (17 dhe 18) paraqesin këto dallime të perceptuara nga qytetarët e intervistuar në kuadër të Sondazhit të IDRA-s “Pandëshkueshmëria - Opinioni publik mbi kuptimin, arsyet dhe rolin e institucioneve 2014 - 2015.”

Figura 17. Perceptimi i Pandëshkueshmërisë Personale [Burimi: IDRA 2015]
Perceptimi i pandëshkueshmërisë personale



Pavarësisht shenjave të “zgjimit qytetar” për ta bërë qeverinë të japë llogari dhe të përmbushë prioritetet e qytetarëve, Shqipëria mbetet ende një “mjedis mjaft i vështirë” për të nxitur aktivizimin.¹⁵⁹ Mungesa e madhe e besimit ndaj partive politike dhe institucioneve kryesore, të tillë si gjyqësori, krijon një rreth vicioz për apatinë shoqërore dhe mosbesimin se aktivizimi i qytetarëve mund të sjellë ndryshim për luftën kundër korrupsionit

Figura 18. Perceptimi i Pandëshkueshmërisë për Zyrtarët e Lartë [Burimi: IDRA 2015]
Perceptimi i pandëshkueshmërisë për zyrtarët e lartë



dhe pandëshkueshmërisë. Megjithatë, duke pasur parasysh traditën e fortë laike të vendit, perceptimet publike në qeverisjen apo korrupsionin jo domosdoshmërisht lidhen me vlerat fetare. Qëndrimet e komunitetit më të madh fetar në vend (komuniteti mysliman) ndaj besimit dhe moralit janë të ndryshme nga ato të shoqërive të tjera.¹⁶⁰

Për të testuar supozime të tilla në një

kontekst më aktual të zhvillimeve dhe për të analizuar potencialin që ka ky nxitës për ekstremizmin e dhunshëm në vend, në studimin e IDM-së u hartuan dy pohime kontrolli, si më poshtë:


a) *Vendet me besim fetar të fortë kanë qeveri më pak të korruptuara.*

b) *Nëse njerëzit do të ishin besimtarë të fesë sime në Shqipëri do të kishte më shumë drejtësi.*

Sondazhi i IDM-së konfirmon supozimin se pjesa më e madhe e të intervistuarve nuk korrelojnë mes qeverisjes së mirë apo të korruptuar dhe fesë.

Figura 19. Besimi fetar dhe korrupsioni [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Vendet me besim fetar të fortë kanë qeveri më pak të korruptuara



Kjo prirje është e pranishme në të gjitha zonat e synuara, përveç Përrenjasit dhe Bulqizës. Në mënyrë të veçantë, 58% e të anketuarve në Përrenjas dhe 48% në Bulqizë pajtohen me këtë pohim, ndërsa 29% dhe 37% respektivisht nuk janë dakord. Kjo deklaratë gjen më shumë përkrahës mes femrave dhe tek të rinjtë e moshës 18-25 vjeç.


Nga ana tjetër, mospajtimi me këtë deklaratë është më i pranishëm mes të intervistuarve meshkuj, tek kategoria e të anketuarve të papunë dhe të intervistuarve të cilët kanë përfunduar

arsimin bazë dhe të mesëm. Më shumë se gjysma (52.9%) e të intervistuarve të grupmoshës 41-45 vjeç dhe 52,5% e të intervistuarve të grupmoshës 31-35 vjeç nuk janë dakord me pohimin. Për më tepër, 65% e të gjithë të anketuarve që deklarojnë se praktikojnë rregullisht fenë nuk besojnë se "vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuar".

Ndryshe nga "qeverisja dhe feja", të intervistuarit priren të vendosin lidhje me vlerat kur pyeten për "drejtësinë dhe besimin (e tyre) fetar".

Figura 20. Besimi fetar dhe drejtësia [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Nëse njerëzit do të ishin besimtarë të fesë sime në Shqipëri do të kishte më shumë drejtësi



Më shumë se gjysma (nga 52% deri në 65%) e të intervistuarve në shtatë nga tetë zonat e synuara bien dakord me këtë pohim, ndërkohë që kjo shumicë është më pak se gjysma në Librazhd, ku 46% janë dakord, 31% nuk bien dakord dhe 23% nuk e dinë.

Nëse shohim demografinë e të intervistuarve që besojnë se “më shumë drejtësi lidhet me fenë e tyre”, studimi evidenton se ky perceptim është më i pranishëm tek të intervistuarit meshkuj (65.2% e të gjithë të intervistuarve meshkuj), tek ata që praktikojnë rregullisht ritet fetare (85.4%) dhe tek kategoria e grupmoshës 31-35 vjeç (67.9%). Rreth 60% e të intervistuarve të punësuar e të papunë, si edhe 63%

e të gjithë të intervistuarve me arsim të mesëm kanë të njëjtin opinion.¹⁶¹

Instrumentet cilësore të studimit të IDM-së, diskutimet në fokus-grupe dhe intervistat me informues kyçë nuk sugjerojnë ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë për sa i përket këtij nxitësi. Disa prej tyre theksojnë se kjo nuk duhet përjashtuar si ‘argument’ që mund të përdoret/të jetë përdorur nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm. “*Gjithsesi, korrupsioni dhe pandëshkueshmëria e elitave të korrupsionit në mendjen e besimtarëve fetarë lidhet më së shumti me zbatimin e shtetit ligjor dhe shtetin laik sesa me debatin fetar.*”¹⁶²

6.2.5. ZONAT E PAQEVERISURA OSE TË QEVERISURA DOBËT

Këto zona janë të izoluara, rajone me dendësi të ulët të popullsisë dhe që përbëjnë vatra të sigurta ku grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të krijohen pa pengesa të mëdha dhe, madje, të marrin mbështetje nga komunitetet e lëna në harresë nga qeveria. Duhet të kuptohet se grupet e ekstremizmit të dhunshëm

mund të tërhiqen drejt "shteteve me forcë të kufizuar", përkundër shteteve të dështuara apo në dështim e sipër, ku mund të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar rrjetin e tyre dhe për të kryer operacionet.

Shqipëria e ka përmirësuar renditjen e saj në Indeksin e Shteteve të Brishta të Fondit për Paqe dhe notën nga 65.2 në 2013 në 63.6 pikë në 2014.¹⁶³ Megjithatë, ajo gjendet ende në nivelin "Paralajmërim" të shteteve, me tetë vende dhe një nivel prapa pararojës së Ballkanit perëndimor, Malit të Zi (me 55.7 pikë, në nivelin "më pak i qëndrueshëm").¹⁶⁴ Ndërthurja e qeverisjes së dobët me korrupsionin e përhapur (dhe konfliktet lokale) nxit krijimin e qendrave alternative të pushtetit dhe ekstremizmit të dhunshëm.¹⁶⁵ Siç shpjegojnë G. Denoeux dhe L. Carter, ky nxitës ndërlidhet me korrupsionin e përhapur që minon kapacitetin e shtetit, fuqinë dhe praninë e institucioneve shtetërore. Autorët sugjerojnë se lagjet e varfra peri-urbane, rajonet kufitare dhe vendet e zhytura në konflikte të dhunshme apo kriminalitet si dhe rajonet e largëta, të izoluara apo me densitet të ulët të popullsisë ku prania apo efektiviteti i institucioneve shtetërore janë të kufizuara, kanë potencialin të shërbejnë si strehë e sigurt për grupet e ekstremizmit të dhunshëm. Zonat rurale dhe të largëta të Shqipërisë paraqesin interes të veçantë për analizën në këtë drejtim për shkak të pranisë së kufizuar të agjencive shtetërore.¹⁶⁶ Mbulimi i dobët i popullsisë në këto zona me shërbime të ofruara nga shteti (shërbimi shëndetësor, arsimit dhe shërbime të tjera sociale) mund të shërbejnë për radikalizimin dhe/ose të përdoren nga grupet ekstremizmit të dhunshëm.¹⁶⁷

Një tjetër paraqitje e 'zonave me qeverisje të dobët' lidhet me institucionet e zbatimit të ligjit ku 'policimi në komunitet' është

larg praktikimit të qëndrueshëm dhe funksional që mbështetet në partneritetin mes policisë, njësive të qeverisjes vendore dhe komuniteteve të qytetarëve.¹⁶⁸ Prania e ulët e këtyre agjencive ka krijuar vatra të sigurta për veprimtari të paligjshme, veçanërisht për kultivimin e kanabisit në zonat rurale.

"Pavarësisht arritjeve të rëndësishme të policisë në luftën kundër këtij krimi në Lazarat¹⁶⁹ dhe zona të tjera rurale, fakti se kjo veprimtari e paligjshme ka lulëzuar për shumë vite mund të ngrejë dyshime të arsyeshme se mund të jenë zhvilluar edhe veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm me baza fetare. Nga ana tjetër, ndonjëherë feja, siç tregohet në rastin e familjeve myslimane që praktikojnë besimin e tyre, mund të ndihmojë shtetin të forcojë autoritetin e tij në zona të tilla."¹⁷⁰

Në fakt, G. Denoeux dhe L. Carter (2009) janë të mendimit se kontributi i zonave të paqeverisuar ose të qeverisuar dobët për ekstremizmin e dhunshëm nuk duhet të mbivlerësohet. Në vend të përgjithësimeve për evidentimin e vetëm këtij variabli, studimet duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë mënyrës se si ndërvepron ekzistenca e zonave të paqeverisura me variabla të tjera për të krijuar mundësi për ekstremizmin e dhunshëm.

Në studimin e IDM-së janë përfshirë dy pohime kontrolli për të identifikuar perceptimin e publikut në zonat e synuara në lidhje me (1) praninë e shtetit, dhe (2) qëndrimin e të intervistuarve ndaj rolit të shtetit në monitorimin e veprimtarive fetare, si më poshtë:

a) *Forca e "shtetit" është më e ulët në zonat rurale sesa në qytete.*

b) *Aktivitetet fetare duhet të jenë të lira dhe të pamonitoruara nga shteti.*


54% e të intervistuarve të sondazhit të IDM-së besojnë se forca e shtetit është më pak e pranishme (më e ulët) në zonat rurale. Shumica dërrmuese në Cërrik (80%), Kukës (66%), në Komunën Qendër-Librazhd (64%) dhe Librazhd (51%) ndajnë këtë opinion. Në Përrenjas, 45% e të intervistuarve nuk kanë një mendim dhe 40% janë dakord.

Të intervistuar nga Pogradeci dhe Komuna Buçimas janë të ndarë edhe pse pjesa më e madhe e tyre kanë këtë mendim, me 38% dhe 45% përkatësisht. Analiza e përgjithshme e përgjigjeve brenda nënkategorive të ndryshme të demografisë konfirmon dominimin e miratimit të pohimit.

Nga ana tjetër, përgjigjet e të intervistuarve janë më të spikatura kur pyeten për rolin monitorues të shtetit për veprimtaritë fetare. Kështu, 67% e të intervistuarve janë dakord që veprimtaritë fetare duhet të jenë të lira dhe të mos monitorohen nga shteti.

Figura 21. Monitorimi i aktivitetit fetar [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Aktivitetet fetare duhet të jenë të lira dhe të pamonitoruara nga shteti.



Mbi 60% e të intervistuarve në të gjitha zonat, përveç Bulqizës, janë dakord me pohimin, ndërsa të intervistuarit nga Përrenjasi janë dakord masivisht (92%). Pjesa më e madhe e të anketuarve nga Bulqiza (60%) nuk e miratojnë këtë pohim dhe vetëm 1/3 e të intervistuarve nga kjo zonë (32%) janë dakord me pohimin.

Për sa i përket kategorive demografike, përgjigjet tregojnë nivel të lartë uniformiteti tek të gjithë variablat – kategoria e nivelit arsimor, gjinisë, statusit të punësimit dhe grupmoshave. Kështu, një shumicë e theksuar prej 60% deri në 75% e të gjithë të intervistuarve brenda secilës prej këtyre nënkategorive janë dakord që

“aktivitetet fetare duhet të jenë të lira dhe të pamonitoruara nga shteti”. Ky opinion mbështetet edhe nga të intervistuar që praktikojnë të gjitha ritet fetare, ata që praktikojnë ritet kryesore dhe ata që nuk e ushtrojnë fare fenë, edhe pse kjo mbështetje ka prirje rënëse nga 76% e atyre që praktikojnë fenë rregullisht në 67% e të intervistuarve që praktikojnë ritet kryesore fetare dhe 56% e të intervistuarve që nuk ushtrojnë asnjë rit fetar.

Siç sugjerohet edhe nga diskutimet e disa pjesëmarrësve në fokus grupe, ky pohim duket se është problematik, sepse pjesa e parë e fjalisë pyet nëse veprimtaritë fetare duhet të jenë të lira dhe pjesa e dytë i referohet rolit monitorues të shtetit.¹⁷¹ Shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe dhe shumë informues kyçë në nivel vendor dhe në Tiranë

bien dakord se veprimtaritë fetare duhet të monitorohen për të siguruar respektimin e traditës shqiptare të Islamit.

“Edhe pse kjo nuk i përjashton agjencitë e zbatimit të ligjit, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i vazhdueshëm, veçanërisht me spektrin e institucioneve shtetërore jashtë sektorit të sigurisë, do ta vendoste monitorimin e veprimtarive fetare në një mjedis shumë më të mirë.”¹⁷² Vëzhgimi policor dhe monitorimi i veprimtarive fetare në xhami nga agjencitë e tjera të sigurisë raportohet se ka efekt të kundërt sipas informuesve kyçë.¹⁷³ Prandaj, siç sugjeron edhe natyra e kësaj nxitësi, edhe parandalimi duhet të ndjekë logjikën e aktivizimit të këtij nxitësi – pra të jetë i kushtëzuar nga faktorë/variabla të tjerë dhe rolet e aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë për të trajtuar efektet përkatëse.

6.2.6. FRIKËSIMI APO KËRCËNIM NGA GRUPET E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Aty ku qeveritë nuk mund t’u japin qytetarëve të tyre mbrojtje dhe siguri, grupet e ekstremizmit të dhunshëm do të përdorin frikën dhe kërcënimin për të detyruar mbështetje për lëvizjen e tyre.

Edhe pse nuk ka raportime për raste të kërcënimit apo frikësimit me synim për të rekrutuar anëtarë nga ana e grupeve apo individëve të ekstremizmit të dhunshëm, ky nxitës analizohet në këtë studim të IDM-së me një qëllim të dyfishtë.¹⁷⁴ Së pari, për të përcaktuar ekzistencën e grupeve apo individëve që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm mbi baza fetare, dhe rrjedhimisht që mund të përdorin kërcënimin apo frikësimin mbi baza fetare. Së dyti, analiza shqyrton “mjete” të tjera që grupe apo individë

të tillë mund të përdorin me qëllim ushtrimin e presionit tek qytetarët për të rritur ndikimin e tyre. Logjika për këtë zgjedhje është se, siç sugjerojnë edhe G. Denoëux dhe L. Carter (2009), “një nivel i caktuar presioni shoqëron ofrimin e disa shërbimeve, përfitimeve ekonomike apo mundësive për punësim, dhe/ose aftësinë për të siguruar një shkallë të caktuar legjitimiteti duke e identifikuar vetveten me kauza popullore.”¹⁷⁵

Gjatë fazës fillestare ky studim u ballafaqua me dy pozicione të

ndryshme të informuesve kyçë për sa i përket instrumenteve dhe mjeteve të përdorura nga grupe të ekstremizmit të dhunshëm fetar për të manipuluar dhe rekrutuar besimtarët (përfshirë edhe motivimin e tyre) të cilët janë përfshirë eventualisht në konfliktin sirian si luftëtarë të huaj apo për të siguruar mbështetje për një kauzë të tillë. Pozicioni i parë sugjeron përfitime financiare dhe ekonomike (si motivim për luftëtarët e huaj dhe) si instrument apo mjet në anën e rekrutuesit. Një opinion i tillë vjen kryesisht nga përfaqësues të institucioneve shtetërore që nuk raportojnë të kenë ndonjë përvojë apo rol në trajtimin e radikalizimit fetar, si psh. Ministrinë e Arsimit, Çështjeve Sociale, Çështjet Vendore apo inspektoratet dhe agjencitë e tjera në varësinë e tyre. Sipas grupit të dytë të informuesve kyçë – ekspertë dhe profesionistë, të cilët raportojnë interes dhe përvojë lidhur me fenomenin si rezultat i angazhimit të tyre profesional (si pjesë e institucioneve të sigurisë, KMSH-së apo organizatave të tjera) – sugjerojnë keqinterpretimet e dogmës fetare (nga rekrutuesit) dhe “injurancën fetare” (të individëve të manipuluar), si instrument kryesor.¹⁷⁶ Pothuajse ndarje identike u identifikua edhe gjatë punës në terren të këtij studimi në nivel vendor gjatë shumë intervistave me informuesit kyçë të institucioneve shtetërore, KMSH-së dhe aktorë të tjerë joshitetërorë, ku aktorët më të informuar sugjerojnë se media ka luajtur rolin kryesor në krijimin e perceptimit të tillë tek publiku, duke përfshirë edhe perceptimet e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore jashtë sektorit të sigurisë.¹⁷⁷

Në fakt, me një ekonomi të bazuar kryesisht tek pagesat me para në dorë dhe me përhapje të punësimit informal dhe ekonomisë gri,¹⁷⁸ Shqipëria ofron kushte për përdorimin e mjeteve të tilla nga grupet e ekstremizmit të

dhunshëm. Pavarësisht përmirësimeve në legjislacion për të luftuar financimin e terrorizmit, raporte të ndryshme ndërkombëtare sugjerojnë se pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit mbeten rreziqe të mëdha për vendin.¹⁷⁹ Nga ana tjetër, raportet e medias investigative argumentojnë se në rastet e ndjekjes penale të rekrutuesve të luftëtarëve të huaj, Prokuroria ka evidentuar mekanizmin e disa pagesave në shuma të vogla të hollash, ndërsa kjo sugjeron se është pikërisht propaganda fetare (dhe jo përfitimet ekonomike) motivi kryesor i luftëtarëve të huaj shqiptarë.¹⁸⁰ Edhe pse këto pagesa me para në dorë janë përdorur për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit, disa informues kyçë nuk përjashtojnë mundësinë që me anë të një forme të “sistemit hawala”¹⁸¹ ato të kenë shërbyer edhe për të “motivuar” rekrutuesit, siç ka qenë rasti në disa vende të tjera.¹⁸²


Në sondazhin e IDM-së të intervistuarit u pyetën specifikisht për ekzistencën e individëve që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm mbi baza fetare në zonat e synuara. Një pyetje shtesë u drejtua për të identifikuar perceptimet lidhur me besimtarët që përçojnë mesazhe fetare. Kështu, në sondazh të intervistuarit u pyetën nëse ata binin dakord me pohimin “Është detyrim i çdo besimtari të çojë fjalën e Zotit tek ata që ende nuk e kanë pranuar.” 64% e të intervistuarve ishin dakord me pohimin përkundër 22% që nuk mendonin kështu. Kjo prirje është pranishme në të gjitha zonat e synuara, përveç Librazhdit ku shumica (44%) nuk është dakord me këtë pohim dhe 39% bien dakord me të. Ky pohim mbështetet nga mbi 50% e të intervistuarve në të gjitha kategoritë demografike (gjinia, niveli arsimor, grupmosha, statusi i punësimit, etj.) përveç të intervistuarve që nuk ushtrojnë asnjë rit fetar, tek të cilët niveli i mbështetjes bie në 42% (dhe 34.2% që nuk janë dakord).

Një grup prej 16% e të intervistuarve e konfirmojnë ekzistencën e individëve që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm fetar në zonat e synuara. Një tjetër

58% nuk janë dakord me këtë pohim kontrolli të hartuar nga sondazhi i IDM-së: “në zonën ku jetoj ka individë që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm me baza fetare.”

Figura 22. Individë që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Në zonën ku jetoj ka individë që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm me baza fetare.



Të intervistuarit nga Përrenjasi dhe Kukësi raportojnë përqindje më të ulët të dakordësisë me pohimin - vetëm 3% dhe 7% respektivisht raportojnë se ka individë që përkrahin ekstremizmin e dhunshëm fetar në këto zona. Nga ana tjetër, 30% e të intervistuarve të Komunës Qendër-Librazhd janë dakord se ka individë që cilët mbështesin ekstremizmin e dhunshëm fetar në zonën e tyre (36% nuk janë dakord me këtë pohim dhe 34% shprehen se nuk e dinë). Të anketuarit në Cërrik vijjnë të dytët, ku 27% e tyre raportojnë ekzistencën e individëve të tillë (dhe 46% nuk janë të këtij mendimi).

Mesatarisht 10% deri në 20% e të intervistuarve të pjesës më të madhe të kategorive demografike nuk raportojnë

për individë të tillë - gjinia (15.7% femra dhe 16.9% meshkuj), statusi i punësimit (15.4% të punësuar dhe 19.6% të papunë), mosha (17.5% të grupmoshës “18-25 vjeç”, 16,6% të grupmoshës “26-30 vjeç”, 11.7% të “31-35 vjeç” dhe 15% të “36-40 vjeç”), niveli arsimor (15,2% e të anketuarve me arsim të mesëm dhe 15.4% e të anketuarve me arsim të lartë) dhe të intervistuarit që praktikojnë fenë (10% e të anketuarve të cilët praktikojnë rregullisht dhe 15,4% e të anketuarve të cilët praktikojnë ritet kryesore fetare).

Ka vetëm tre nënkategori demografike që janë dakord me këtë pohim (dhe që rrjedhimisht raportojnë për ekzistencën e individëve që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm fetar) përtej kësaj mesatareje. Kështu,

këtu përfshihet 21.5% e të gjithë të intervistuarve me “deri në 9 vjet arsim”, 21.7% e të intervistuarve të grupmoshës 41-45 vjeç dhe 24.9% e të intervistuarve që nuk praktikojnë asnjë rit fetar.

Gjetjet e sondazhit të IDM-së mbi ekzistencën e individëve të cilët mbështesin ekstremizmin e dhunshëm mbi baza fetare konfirmohen në shumë diskutime të fokus grupeve (maj 2015), ndërsa ky fakt ishte paralajmëruar

edhe në një sërë intervistash të kryera me informuesit kyç nga kryeqyteti dhe tetë zonat e synuara. Gjithsesi, edhe pse shumë prej informuesve kyçë sugjerojnë se individë të tillë janë një pakicë shumë e izoluar në krahasim me numrin e përgjithshëm të besimtarëve fetarë, është e vështirë që nëpërmjet kësaj pyetjeje të bëhet një vlerësim i numrit të individëve që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm mbi baza fetare.

6.2.7. PERCEPTIMI SE SISTEMI NDËRKOMBËTAR ËSHTË THELBËSISHT I PADREJTË DHE ARMIQËSOR ME SHOQËRITË/POPUJT MYSLIMANË


Popullsia mund të pranojë propagandën e ekstremizmit të dhunshëm se sistemi botëror politik dhe ekonomik diskriminojnë botën myslimane, gjë që mund të ndërliqhet me ndjenjat personale ose komunitare të diskriminimit.

Shqipëria është promovuar gjerësisht si vendi i harmonisë fetare kur myslimanët, të krishterët dhe besimtarë të komuniteteve të tjera fetare bashkëjetojnë në paqe. Megjithatë, siç tregojnë edhe gjetjet e sondazhit të IDM-së në lidhje me shumë prej pohimeve të kontrollit sipas kategorive të ndryshme të nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm, komuniteti

më i madh fetar në vend (ai mysliman) përballet me sfida dhe shqetësime domethënëse. Për më tepër, kur iu kërkua të vlerësonin në një shkallë nga 1 deri në 5 nëse “në Shqipëri ka ‘urrejtje fetare’ (1) apo ‘harmoni fetare’ (5)”, vlerësimi mesatar është 4.1, ndonëse “harmonia fetare” (5) është përgjigja që u raportua nga pjesa më e madhe e të anketuarve (47.2% e tyre).

Figura 23. Shqipëria – Urrëjtje apo harmoni fetare? [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Në Shqipëri ka ‘urrejtje fetare’ (1) apo ‘harmoni fetare’ (5)




Në diskutimet në fokus grupe dhe në disa nga intervistat me klerikë fetarë të KMSH-së në nivel vendor raportohet një perceptim për diskriminimin në mënyrë të veçantë kundër besimtarëve myslimanë që ushtrojnë rregullisht besimin e tyre fetar.¹⁸³ Instrumentet cilësore të studimit të IDM-së (intervista dhe fokus grupe) kanë synuar ta diskutojnë këtë nxitës me klerikë myslimanë apo anëtarëve të xhematit. Megjithatë, duke pasur parasysh orientimin e konsiderueshëm pro-Perëndimor të shqiptarëve në

përgjithësi, ishte e vështirë të shqyrtohej me informuesit kyçë argumenti se “sistemi ndërkombëtar është i padrejtë me botën myslimane.”¹⁸⁴

Duke qenë se Shqipëria është vend me shumicë të popullsisë që i përket besimit mysliman, në studimin e IDM-së shqyrtohet edhe ky nxitës për të cilin të intervistuarit pyeten në lidhje me pohimin e mëposhtëm: “Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën Islame.”¹⁸⁵

Figura 24. Perëndimi dhe Islami [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën Islame



Të intervistuarit e këtij sondazhi janë të ndarë për sa i përket këtij pohimi, siç tregohet edhe në grafikun 24. 34% e të anketuarve besojnë se “Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën Islame.” Një ndarje e tillë opinionesh është e pranishme edhe tek të intervistuarit nga pjesa më e madhe e zonave të synuara, me pak përjashtime. Kështu, vetëm në Bulqizë ka një shumicë të madhe prej 47% të intervistuarish që janë

dakord me pohimin. Nga ana tjetër, kjo pikëpamje ka përqindjen më të ulët tek të intervistuarit nga Cërriku, ku 24% e tyre janë dakord dhe 45% e tyre nuk mendojnë se perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën Islame.

Gjatë shqyrtimit të kësaj përqindjeje të intervistuarish që e konsiderojnë Perëndimin si armiqësor brenda secilës kategori demografike, në

analizën e IDM-së evidentohen gjetje simptomatike. Kështu, nga perspektiva e gjinisë – 27.2% e të intervistuarve femra dhe 38.2% meshkuj kanë këtë mendim. Po ashtu, 31%-33% e të gjithë të intervistuarve nga secila grupmoshë nga 18 deri në 35 vjeç janë dakord me pohimin, ndërkohë që kjo përqindje shkon në 38.1% e të anketuarve të grupmoshës 36-40 vjeç dhe 35.5% e të intervistuarve të grupmoshës 41-45 vjeç. Nuk ka dallime domethënëse në përqindje mes grupeve të nivelit arsimor, ndërkohë që mbështetja për këtë pohim varion nga 32.5% e të intervistuarve me nivel arsimor universitar në 34.5% të të intervistuarve me arsim të mesëm dhe 36% të atyre me arsimin bazë. Po ashtu, 34.25% e të

intervistuarve të papunë dhe 36.2% e të punësuarve janë dakord me pohimin se Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën Islame.

Të vetmet dallime të konsiderueshme me nënkategoritë demografike të të intervistuarve vërehen në lidhje me elementin e “ushtrimit të besimit”. Gati gjysma e të intervistuarve që ushtrojnë rregullisht ritet dhe rregullat fetare (49.3) janë dakord me këtë pohim. Të intervistuarit që praktikojnë vetëm ritet kryesore fetare tregojnë një përqindje më të ulët – 28.8% e tyre. Së fundi, vetëm 20.5% e të gjithë të anketuarve që nuk praktikojnë asnjë rit fetar janë dakord me këtë pohim.

6.3. NXITËS KULTURORE

Lista e nxitësve të renditur këtu nuk është përfundimtare, por në literaturën e shqyrtuar këta nxitës shquhen për rolin e tyre kyç për ‘mundësimin’ e ekstremizmit të dhunshëm. Sa më shumë prej tyre të jenë të pranishëm në një mjedis, aq më e mundur është që aty të zhvillohet radikalizim dhe ekstremizëm i dhunshëm. Për më tepër, këta nxitës shpesh mbivendosen dhe përforcojnë njëri-tjetrin. Për shembull, nxitësi “Sulme kundër Islamit” i përshkruar më poshtë si nxitës kulturor është ngushtësisht i lidhur me perceptimin politik se sistemi ndërkombëtar është i padrejtë dhe diskriminues ndaj vendeve dhe besimtarëve myslimanë dhe se popullsitë myslimane në zona të caktuara në konflikt po shtypen.¹⁸⁶ Perceptimi i një rreziku jetik ndaj kulturës së Islamit mund të përforcojë bindjen se Perëndimi është armiqësor ndaj vendeve Myslimane dhe se popullsitë e tyre vuajnë padrejtësisht

diskriminim shoqëror dhe zhvleftësim të vazhdueshëm të kulturës dhe vlerave të Islamit.

Guilain Deneux dhe Lynn Carter (2009) konstatojnë tre lloje nxitësie kulturore të cilët përfshijnë a) perceptime të sulmeve dhe padrejtësive të vazhdueshme nga vendet perëndimore ndaj kulturës dhe vendeve Myslimane; b) perceptime të pushtimit dhe asimilimit të kulturës tradicionale të një vendi nga influenca të huaja moderniste, dhe c) përpjekje proaktive të grupeve radikale për imponimin dhe përhapjen e nën-kulturës dhe rrymës së tyre të ashpër të Islamitmbi traditat dhe kulturat e tjera. Për të kuptuar shkallën e pranisë dhe rolin e tyre në Shqipëri, këta nxitës janë trajtuar në mënyrë të thelluar më poshtë, duke u mbështetur në informacionin e përftuar nga intervistat me aktorë kyç, sondazhet e kryera në tetë zona të synuara dhe grupet e fokusuara.

Tabela 4. Kategoria e nxitësve kulturorë

NXITËSI	PËRSHKRIMI
Islami nën rrethim (Perceptime të sulmeve kundër Islamit)	<p>Ekziston një lidhje e fortë midis suksesit të ekstremizmit të dhunshëm dhe perceptimit se Perëndimi po sulmon Islamin dhe myslimanët. Njerëzit që përjetojnë shtypje dhe poshtërim në jetën e tyre të përditshme mund të jenë më të ndjeshëm ndaj imazheve shumë të politizuara dhe emocionale të myslimanëve të tjerë që vuajnë në vende të tjera.</p> <p><i>Shënim. Kjo duplikon dhe përforcon një nga nxitësit politikë, d.m.th., "Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është krejtësisht i padrejtë dhe armiqësor ndaj shoqërive/popujve myslimanë".</i></p>
Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës	<p>Popullata mund të perceptojë një kërcënim të përgjithshëm kulturor ndaj traditave, zakoneve, vlerave dhe ndjesisë së nderit dhe dinjitetit personal dhe kolektiv</p>
Agjendat "Proaktive" fetare	<p>Grupet që nxisin agjendat e tyre do të tentojnë të imponojnë versionin e tyre të Islamit, xihadit, etj., tek popullatat vendase, duke dobësuar kështu strukturat dhe traditat tradicionale e më tolerante fetare. Kjo krijon kushtet për ekstremizmin e dhunshëm.</p>

Burimi: Guilain Denoeux dhe Lynn Carter (2009)

6.3.1. PERCEPTIME TË SULMEVE KUNDËR ISLAMIT

*"Ekziston një lidhje e fortë midis suksesit të ekstremizmit të dhunshëm dhe perceptimit se Perëndimi po sulmon islamin dhe myslimanët. Njerëzit që përjetojnë shtypje dhe poshtërim në jetën e tyre të përditshme mund të jenë më të ndjeshëm ndaj imazheve shumë të politizuara dhe emocionale të myslimanëve të tjerë që vuajnë në vende të tjera. Ky nxitës mbivendoset dhe përforcon nxitësin politik pararendës."*¹⁸⁷

Ky nxitës kulturor lidhet me perceptimet e një sulmi të vazhdueshëm ndaj Islamit dhe myslimanëve prej Perëndimit dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe ndjesinë e turpërimit, margjinalizimit dhe nënshtrimit të popullsisë Myslimane. Ndjesia se ekzistenca e besimit Islam është nën kërcënim është e lidhur me bindjen se shtypja dhe

padrejtësitë ndaj myslimanëve janë pjesë e sistemit aktual ndërkombëtar. Studimet empirike kanë treguar se perceptime të padrejtësive ndaj Islamit ndërveprojnë ngushtë me mundësinë për të mbështetur apo për t'u përfshirë në aktivitete të ekstremizmit të dhunshëm.¹⁸⁸

Megjithatë, në perceptimet e disa personave, ky rrezik mund të vijë edhe

nga brenda, domethënë nga vetë besimtarë myslimanë të cilët kanë 'devijuar rrugën e drejtë' (p.sh. duke besuar në një sekt) apo 'tradhtuar' duke u rreshtuar me Perëndimin. Ndonjëherë, ky nxitës mund të jetë më i fortë se nxitësit socio-ekonomikë dhe kjo mund të dallohet qartë në ndjenjën e solidaritetit me myslimanët në vendet e tjera, të cilët po shtypen, sipas perceptimeve të luftëtarëve të huaj. Për më tepër, sipas luftëtarëve të huaj, mbrojtja e 'vëllezërve myslimanë' është detyrim fetar. Interpretimi mjaft i ngushtë i dogmës fetare, bën që persona të influencuar shpesh të kenë konflikte edhe me familjarët e tyre të cilët konsiderohen si "jo myslimanë" apo si "jo të devotshëm". Së fundmi, duhet mbajtur parasysh se ky nxitës nuk formohet në vakum. Formësimi i perceptimeve të tilla tek një person varet nga aftësitë predikuese dhe kohëzgjatjen e indoktrinimit të kryer nga një influencues karizmatik si dhe rrethanat e caktuara të cilat bëjnë vulnerabël një person të ekspozuar ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Arrestimi i dy imamëve të vetëshpallur dhe pesë mbështetësve të tyre u krye për shkak se mbi këta persona rëndojnë akuzat e "Rekrutimit të personave me qëllim kryerjen e veprimeve terroriste", "Nxitjes, thirrjes publike dhe propagandës për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste", si dhe të "Nxitjes së urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve" të parashikuara nga neni 231, 232/a dhe 265 të Kodit Penal. Sipas organit të akuzës, imamët u arrestuan, pasi akuzohen se përmes propagandës fetare frymëzuan mbi 70 shqiptarë, ndjekës të rrymës tekfiriste të Islamit për t'u përfshirë në këtë konflikt. Sipas informacionit të pasqyruar në media, në xhamitë e Unazës së Re dhe Mëzezit në Tiranë besimtarëve u

bëhej thirrje për xhihad dhe u thuhej se pjesëmarrja në këtë konflikt do t'u siguronte 'xhehnetin' (parajsën) në botën e përtejme. Personave që ishin të gatshëm për t'u përfshirë në konflikt u sigurohej mbështetje financiare dhe logjistike.

Personat e radikalizuar, të gatshëm apo të përfshirë në konflikt, besojnë se luftimi përkrah të vetëquajturit "Shtetit Islamik" (ISIS) është në mbrojtje të "vëllezërve myslimanë" të cilët po vuajnë dhe shtypen padrejtësisht. Siç është diskutuar dhe më sipër, ndjesia e sulmeve të vazhdueshme ndaj Islamit nxit dhe lehtëson marrjen e vendimeve ekstreme, siç është përfshirja në konflikt të armatosur në mbrojtje dhe solidarizim me myslimanët, të cilët po vuajnë nga sulmet dhe padrejtësitë e perceptuara.

Sipas klerikëve myslimanë të intervistuar, radikalizimi ndodh për shkak të keqinterpretimit dhe keqkuptimit të dogmës fetare. Keqinterpretimi i teksteve fetarë (Kurani dhe hadithet) bëhet nga imamët e vetëshpallur, të cilët kanë për qëllim manipulimin dhe indoktrinimin e të tjerëve. Klerikë të intervistuar nga IDM pohojnë se imamët e vetëshpallur dhe persona të tjerë kishin tentuar të predikonin apo kishin predikuar në xhamitë e tyre. "Gjuha e përdorur prej tyre ishte e mbushur me urrejtje ndaj feve dhe vendeve të tjera dhe besimtarëve u flitej për padrejtësi ndërkombëtare ndaj myslimanëve në vende të ndryshme të botës. Gjithashtu, bëhej thirrje kundër demokracisë, pasi sipas tyre Zoti kishte gjithçka në dorë, dhe jo njerëzit."¹⁸⁹ Në disa raste, drejtuesit lokalë të xhamive pohojnë t'i kenë përzënë dhe ndalojnë ata të rikthehen për të predikuar para 'xhematit' (besimtarëve) të xhamisë. Nga ana tjetër, të intervistuarit shprehen se persona kryesisht të rinj

nga komunitetet e tyre, me nivel të ulët arsimimi dhe njohje sipërfaqësore të Islamit keqkuptojnë pjesë të doktrinës fetare dhe bien lehtësisht pre e manipulimit.

Të intervistuarit në këtë studim shpjegojnë se gjuha e përdorur nga besimtarët tekfivistë është mjaft e ashpër si ndaj feve të tjera ashtu edhe ndaj vetë Imamëve dhe besimtarëve të tjerë myslimanë të cilët ndjekin dhe praktikojnë Islamit tradicional. Disa prej të intervistuarve kanë pohuar se janë quajtur “munafikë” (hipokritë) apo edhe “qafirë” (të pafe) prej ndjekësve të këtyre rrymave. Në raste të tjera, këta të fundit refuzojnë kategorikisht të diskutojnë pikëpamjet e tyre me imamët apo besimtarët e tjerë. Imamët nuk konsiderohen myslimanë të vërtetë dhe Komuniteti Mysliman Shqiptar konsiderohet si “tradhtar” dhe bashkëpunëtor me politikën dhe vendet perëndimore. Megjithatë, të intervistuarit mohojnë të jenë shënuar raste të konflikteve fizike midis tyre për shkak të dallimeve në pikëpamjet e tyre fetare.

Shumica dërrmuese e të intervistuarve, qoftë pjesë e klerit Islam apo përfaqësues të institucioneve dhe nëpunës shtetërorë, janë shprehur të pakënaqur me mënyrën e mbulimit dhe trajtimit të këtyre çështjeve nga media. Sipas tyre, qëllimi kryesor i medias është “shitja e lajmit” dhe jo informimi profesional dhe edukimi i publikut me fenomenin. Sipas të intervistuarve, media në Shqipëri perceptohet nga besimtarët si “Islamofobe”, “irracionale”, “diskriminuese”, dhe i “hedh benzinë zjarrit” duke marrë kështu një rol negativ në nxitjen e paragjykimeve dhe urrejtjes. Mënyra se si paraqiten këto tema në media bën që besimtarët myslimanë të paragjykojnë dhe shigjetohen si terroristë. Sipas klerikëve të intervistuar, raportimet mediatike

e paraqesin Islamit të lidhur me terrorizmin. Madje, disa prej tyre deklarojnë se raste të padrejtësive ndaj myslimanëve nuk janë pasqyruar mjaftueshëm apo aspak në televizionet brenda vendit.


Për të njohur shkallën në të cilën perceptime të sulmeve ndaj Islamit janë të pranishme brenda vendit, ky seksion analizon përgjigjet e të intervistuarve në tetë zonat e synuara në lidhje me dy ‘pyetjet e kontrollit’, si më poshtë:

- a) *Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën Islame.*
- b) *Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame.*

Mundësia që këto perceptime të favorizojnë apo nxisin radikalizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm është vlerësuar mbi bazë të “përgjigjeve pozitive” për dy pyetjet e mësipërme të cilat nxjerrin në pah: a) ndjesinë se vendet dhe kultura Islame sulmohen padrejtësisht nga Perëndimi, dhe (b) perceptime të vështirësisë për të praktikuar lirisht fenë Islame. Grafiku 25 më poshtë paraqet gjetjet e sondazhit në lidhje me këtë nxitës.

Një në tre të anketuar beson se “Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën Islame” (34%). Mendim të kundërt ndan një i anketuar i dytë (33%), ndërsa i anketuari i tretë paraqitet i pavendosur (33%). Konkretisht, në një total prej 792 personash të cilët kanë pranuar të përgjigjen në lidhje me këtë pyetje, 269 prej tyre besojnë se vendet dhe kultura Islame po sulmohen nga Perëndimi. Numri më i madh i të intervistuarve të cilët besojnë se vendet dhe kultura Islame janë nën sulm të vazhdueshëm është në Bulqizë (47%) dhe Komunën Qendër-Librazhd (43%), ndërsa numri më i vogël i atyre që ndajnë të njëjtin

Figura 25. Perceptime të sulmeve ndaj Islamit [Burimi: Sondazhi IDM 2015]



perceptim është në Cërrik (24%).

Shumica e të intervistuarve janë të mendimit se të jesh besimtar praktikant i fesë Islame në Shqipëri nuk është e vështirë (54%). Ndërsa 31% e të intervistuarve besojnë se është e vështirë këto kohë të praktikosh fenë Islame në Shqipëri.¹⁹⁰ Numri më i madh i "përgjigjeve pozitive" shënohet në Bulqizë (48%), ndërsa numri më i vogël i përgjigjeve të njëjta është në Librazhd (17%).

Perceptimi se "Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën Islame" (34%) është më i fortë ndërmjet: të intervistuarve meshkuj (38% e tyre), personave të grupmoshës 36-40 vjeç (38%) dhe me arsim 9-vjeçar ose më pak (36%).

Për sa i përket statusit të punësimit, ky perceptim është më i fortë midis personave të punësuar (36%). Të intervistuarit, të cilët janë praktikantë të rregullt (49%), janë më të prirur të besojnë se vendet perëndimore janë armiqësore dhe sulmojnë vazhdimisht vendet dhe kulturën Islame.

Në lidhje me pyetjen e dytë të kontrollit për këtë nxitës, ndjesia se 'sot është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame' (32%) është më e theksuar midis: të intervistuarve meshkuj (37% e tyre), persona të grupmoshës 31-35 vjeç (42%), personave që kanë përfunduar arsimin e mesëm (34%), të papunë (33%). Të intervistuarit të cilët praktikojnë rregullisht ritet fetare (51%) janë më të prirur të përgjigjen pozitivisht ndaj kësaj pyetje.

6.3.2. KËRCËNIM I PËRGJITHSHËM NDAJ KULTURËS

“Popullsia mund të perceptojnë një rrezik më të madh kulturor – ndaj traditave, zakoneve, vlerave dhe ndjesisë së nderit dhe dinjitetit kolektiv apo personal.”¹⁹¹

Megjithëse besimi se Islami është nën sulm të vazhdueshëm përbën nxitësin kulturor më domethënës, perceptime të një rreziku të përgjithshëm ndaj traditave, zakoneve dhe nderit personal e atij kolektiv mund të luajnë një rol kyç në nxitjen e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.¹⁹² Në këtë rast, qëllimi nuk është mbrojtja e fesë në vetvete, por e kufijve kulturorë të një vendi apo komuniteti (shumë elementë të të cilave mund të jenë të lidhura me fenë dhe mund të shprehen përmes frazave fetare). Kërcënimi kulturor perceptohet në formën e “njollosjes”, asimilimit dhe humbjes së kulturës vendase nga ndikimi i influencave të huaja, moderniste dhe perëndimore. Kodet shekullore të nderit dhe moralit janë ata të cilët gjykohen në rrezik. Dëshira për të mbrojtur “status quo-në” që rrezikohet mund të nxisë dhunë duke qenë se persona dhe komunitete konservatore mund të shndërrohen në “radikalë reagues”. Sipas Denooux dhe Carter (2009), aftësia e tyre për t’u mobilizuar buron pikërisht nga tradita, e cila në vetvete është e mishëruar në rrjetet e marrëdhënieve shoqërore dhe kanalet e komunikimit, të cilat lehtësojnë mobilizimin.

Të intervistuarit në këtë studim kanë përmendur një sërë rreziqesh kulturore ku përfshihen: a) rreziku i ndierë nga besimtarët tradicionalë myslimanë prej ndikimeve dhe përhapjes së rrymave radikale të Islamit. Në mënyrë reciproke, ndjekësit e rrymave radikale i konsiderojnë besimtarët tradicionalë në Shqipëri si “myslimanë jo të vërtetë” dhe bashkëpunëtorë të vendeve dhe kulturës perëndimore; b) familjet ndjekëse të interpretimeve

të rrepta dhe rrymave radikale heqin vajzat e tyre prej shkollave në moshë të hershme. Në këtë rast, shkolla konsiderohet prej tyre si ambient i rrezikshëm për nderin dhe dinjitetin e femrës; dhe c) rrezik ndaj moralit dhe dinjitetit personal të besimtarit.


Prania dhe shkalla e përhapjes së perceptimeve të kërcënimeve ndaj kulturës dhe traditave është matur përmes sondazhit në tetë zonat e synuara. Për këtë qëllim, të intervistuarve u është parashtruar pyetja e kontrollit, si më poshtë:

Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi është nën presion dhe kërcimin të vazhdueshëm.

Mundësia që ky perceptim të favorizojë apo nxisë radikalizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm është vlerësuar mbi bazë të “përgjigjes pozitive” për pyetjen e parashtruar e cila nxjerr në pah ndjesinë e të intervistuarve se kultura dhe traditat e komunitetit të tyre fetar janë në rrezik. Siç është shpjeguar më sipër, studime empirike kanë provuar se një ndjesi e tillë provokon mobilizim të individëve dhe komuniteteve konservatore, të cilët mund të reagojnë në mënyrë radikale për ruajtjen e “status quo”-së. Grafiku 26 më poshtë paraqet gjetjet e sondazhit në lidhje me këtë nxitës.

Rreth 32% e të intervistuarve kanë ndjesinë se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar janë nën kërcënim të vazhdueshëm. Shumica e të intervistuarve, apo një në dy të anketuar nuk ka të njëjtën ndjesi (50%). Në nivel zonash të caktuara, perceptime të kërcënimeve ndaj

Figura 26. Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës [Burimi: Sondazhi IDM 2015]



kulturës dhe traditave të komuniteteve lokale fetare janë më të përhapura në Komunën Qendër-Librazhd (47% e të intervistuarve) dhe Bulqizë (46%). Shkalla më e ulët e përhapjes së këtij perceptimi rezulton në Kukës, ku 24% e të intervistuarve kanë ndjesinë e kërcënimeve ndaj kulturës dhe traditave të komunitetit të tyre fetar

Perceptimi se “besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi është nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm.” (32%) është

më i fortë ndërmjet: të intervistuarve meshkuj (36% e tyre), personave të grupmoshës 31-35 vjeç (37%) dhe atyre të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm (38%). Për sa i përket statusit të punësimit, ky perceptim është më i fortë midis personave të punësuar (35%). Të intervistuarit të cilët praktikojnë rregullat dhe ritet fetare (51%) janë më të prirur të besojnë se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre është përgjithësisht nën kërcënim të vazhdueshëm.

6.3.3. AXHENDA “PROAKTIVE” FETARE

“Grupet që promovojnë këto agjenda përpiqen të imponojnë versionin e tyre të Islamit, xhihadit, etj., tek popullatat vendase, përmes dobësimit të strukturave dhe praktikave tradicionale dhe tolerante fetare. Kjo krijon kushtet për aktivitetet e ekstremizmit të dhunshëm.”¹⁹³

Shfaqja e rrymave radikale fetare në Shqipëri lidhet me ardhjen pas rënies së komunizmit të disa organizatave arabo-islamike të dyshuara apo të lidhura me terrorizmin, dhe kthimin në vend të studentëve shqiptarë të financuar me bursa studimore prej këtyre organizatave. Të intervistuarit shpjegojnë se disa prej këtyre studentëve mund të kenë rënë në kontakt dhe të jenë influencuar nga persona të njohur për pikëpamjet e tyre radikale fetare, të cilët justifikojnë veprimet ekstreme. Prezantimi dhe shtrirja e këtyre rrymave u favorizua edhe nga boshllëku i krijuar gjatë periudhës së komunizmit në drejtim të predikimit fetar dhe mungesës së klerikëve të kualifikuar myslimanë.

Sipas teologëve të intervistuar, Islami tradicional e sheh fenë si një marrëveshje mes njeriut dhe Zotit dhe rrjedhimisht si një hapësirë shpirtërore. Në këtë besim, forca dhe shtrëngimi nuk kanë vend në fe. Kurani përmend në mënyrë të përsëritur se nuk ka shtrëngim në fe dhe se të gjithë njerëzit janë të lirë të praktikojnë cilëndo fe që ata dëshirojnë. Qysh nga koha e Profetit Muhamed, paqja dhe toleranca kanë zënë vend midis grupeve të ndryshme fetare, duke respektuar dallimet në besim.¹⁹⁴ Në kundërshtim me këtë, ideologjia e grupeve radikale është e ndërtuar mbi konceptin e detyrimit politik të besimit fetar, duke mos lejuar kështu dallime në besim. Për më tepër, ata justifikojnë dhunën e përdorur përmes 'tekfirizmit', që do të thotë deklarinë si "qafir" (jo mysliman) të drejtuesve të shteteve islamike, të cilët konsiderohen jo mjaftueshëm besimtarë. Ky koncept refuzohet nga myslimanët dhe grupet tradicionale të Islamit, pasi konsiderohet si devijim nga doktrina.¹⁹⁵

Për të imponuar besimin e tyre mbi këdo, mysliman ose jo-mysliman,

ideologjitë ekstremiste u referohen në mënyrë arbitrare shkrimeve fetare duke injoruar parimin themelor Islam të tolerancës. Një numër teologësh nga vende të ndryshme kanë argumentuar se gjuha e përpunuar, lutja e Zotit dhe Kuranit, thirrja për aplikimin e Sheriatit dhe gatishmëria për martirizim kanë qëllim të vetëm mashtrimin e të rinjve "me ëndrra naive".¹⁹⁶

Grupet ekstremiste refuzojnë çdo mundësi kompromisi duke këmbëngulur vetëm në rrugën e tyre dhe në asnjë tjetër. Individët dhe grupet radikale që janë shndërruar në militantë ekstremistë caktojnë dënimin me vdekje për çdokënd që mendon ndryshe prej tyre si dhe u deklarojnë luftë dhe synojnë të përmbysin qeveritë që ata i konsiderojnë si të paligjshme para Zotit. Ndjekësit e këtyre rrymave besojnë se kanë një mision dhe mesazh për të shpërndarë. Për këtë qëllim, ata infiltrohen në xhami, qendra komunitare fetare dhe organizata bamirëse, nga ku indoktrinojnë me idetë dhe metodat e tyre persona me prirje për të besuar.¹⁹⁷ Të intervistuarit kanë pohuar se taktika të tilla janë përdorur edhe në xhamitë e disa prej zonave të synuara nga ky studim. Përmes manipulimit apo financimeve ata imponojnë pikëpamjet e tyre mbi komunitete të dobëta në aspektin socio-ekonomik. Thelbi i manipulimit të tyre qëndron në keqinterpretimin e shkrimeve të shenjta dhe krijimin e bindjes tek ndjekësit e tyre për fitimin e 'parajsës' përmes xhihadit.

Mundësia dhe rreziku që individë/ grupe radikale të ndërmarrin një agjendë fetare 'proaktive' në Shqipëri është vlerësuar përmes analizimit të të dhënave të përfuara nga sondazhi i kryer në tetë zonat e synuara. Për këtë qëllim, të intervistuarve u janë parashtruar pohimet (pyetjet e kontrollit) të mëposhtme:


- a) *Predikimet fetare në Shqipëri duhet të jenë liberale e të përshtaten me tendencat moderne;*
- b) *Në zonën ku banoj veprojnë individë / grupe që nxisin radikalizimin islamik.¹⁹⁸*

Terreni i favorshëm për ndërmarrjen e një agjende fetare 'proaktive' nga

individë dhe grupe radikale vlerësohet mbi bazë të "përgjigjeve negative" për pyetjen e parë të kontrollit, e cila synon të evidentojë 'qëndrime konservatore ndaj formave liberale të predikimit fetar' dhe të "përgjigjeve pozitive" për pohimin e dytë, i cili konsiston në 'praninë në komunitet të individëve/ grupeve që nxisin radikalizimin Islamik'.

Figura 27. Predikime liberale fetare [Burimi: Sondazhi IDM 2015]

Predikimet fetare duhet të jenë liberale




Shumica e të intervistuarve kanë pranuar që 'predikimet fetare në Shqipëri duhet të jenë më liberale dhe të përshtaten me tendencat moderne' (56%). Megjithatë, 30% e të intervistuarve shprehen kundër predikimeve fetare më liberale dhe të përshtatura ndaj tendencave moderne. Numri më i lartë i të intervistuarve që kundërshtojnë format më liberale të predikimeve fetare të përshtatura ndaj tendencave moderne regjistrohet në Cërrik (46%), kurse numri më i vogël rezultojnë në Librazhd (23%).

Siç dallohet nga grafiku 27, shumica e të intervistuarve (62% - 65%) mohojnë praninë e individëve apo grupeve radikale fetare në komunitetet e tyre. Prania në komunitet e individëve apo grupeve që nxisin radikalizimin e Krishterë apo Islamik pohohet respektivisht vetëm në masën 9 % dhe 12 %. Në të njëjtën kohë, numri i personave që mohojnë praninë e individëve apo grupeve nxitëse të radikalizimit islamik është më i lartë se numri i të intervistuarve që mohojnë praninë e grupeve me agjendë

Figura 28. Radikalizmi islamik/i krishterë [Burimi: Sondazhi IDM 2015]

Në zonën ku banoj veprojnë individë që nxisin...



radikalizuese të krishterë. Në krahasim me të gjitha zonat e anketuara, numri më i lartë i personave që besojnë se në zonën e tyre ka individë apo grupe nxitëse të radikalizmit të krishterë është në zonën e Librazhdit, si në qytet (18.2%) ashtu dhe komunë (Qendër 15.3%). Ndërsa numri më i lartë i personave që besojnë se në zonën ku ata banojnë janë të pranishëm individë apo grupe nxitëse të radikalizmit islamik është në Bulqizë (21%).

Demografia e të intervistuarve, të cilët janë më të prirur të kundërshtojnë idenë që 'predikimet fetare në Shqipëri të jenë më liberale dhe të përshtaten me tendencat moderne' (30%), paraqitet e tillë: shumica e tyre janë meshkuj (34%), persona të grupmoshës 31-35 vjeç (37%) dhe atyre me arsim të mesëm (33%). Për sa i përket statusit të punësimit, ky perceptim është më i fortë midis personave të punësuar (32%). Të intervistuarit që praktikojnë rregullat

dhe ritet fetare (54%) janë më të prirur të kundërshtojnë idenë që predikimet fetare në Shqipëri të jenë më liberale dhe të përshtaten me tendencat moderne.

Në lidhje me pyetjen e dytë të kontrollit për këtë nxitës, personat më të prirur të besojnë se në komunitetin e tyre ekzistojnë individë apo grupe të caktuara që nxisin radikalizmin e Krishterë janë: meshkuj (9.4% e tyre), grupmosha 36-40 vjeç (12.5%), persona me arsim 9-vjeçar ose më pak (13%), të punësuar (11.3%). Të intervistuarit më të prirur për të besuar se në komunitetin e tyre ekzistojnë individë apo grupe të caktuara që nxisin radikalizmin Islamik janë: meshkuj (12.4% e tyre), persona të grupmoshës 18-25vjeç (15%), të anketuar me arsim 9 vjeçar ose më pak (14.7%), të papunë (13.7%). Kjo bindje prevalon midis personave të cilët nuk praktikojnë rregulla dhe rite fetare (18%).

6.4. NXITËS POTENCIALË TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM SPECIFIKË PËR SHQIPËRINË

Studimi i IDM-së e trajton vlerësimin e nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm dhe faktorëve mundësues për radikalizimin fetar në Shqipëri nëpërmjet kuadrit metodologjik të kontekstualizuar dhe literaturës bashkëkohore. Siç trajtohet edhe në metodologjinë e këtij studimi, IDM e ka testuar kuadrin e metodologjisë përkundër kontekstit shqiptar me qëllim që të sigurojë relevancën e instrumenteve metodologjike dhe cilësinë e zbatimit të tyre. Për më tepër, Guilain Denoeux dhe Lynn Carter (2009) sugjerojnë se kuadri i nxitësve dhe kategoritë përkatëse nuk janë shteruese dhe nuk mund të pasqyrojnë tiparet e çdo mjedisi shoqëror.

Në këtë aspekt, kapitulli “Rikthimi i fesë dhe lufta kundër radikalizmit: Shqipëria në 25 vjet” që jepet në këtë studim paraqet tiparet kryesore të rrugëtimit të Shqipërisë në ngritjen e komunitetit të besimtarëve në 2.5 dekadat e fundit. Në të shqyrtohen një sërë sfidash, problemesh dhe shqetësimesh ndonëse me një bazë të kufizuar të dhënash.

Informuesit kyçë të këtij studimi gjatë fazës fillestare kanë ngritur supozime dhe pohime të ndryshme në lidhje me ndikimin e mundshëm që mund të kenë zhvillime të caktuara (të së kaluarës dhe së tashmes) tek ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi fetar në Shqipëri. Faza fillestare e studimit konfirmoi relevancën e këtyre tipareve dhe zhvillimeve tipike për Shqipërinë dhe ndikimin e mundshëm që mund të kenë në kontekstin e ekstremizmit

të dhunshëm dhe radikalizimit fetar. Megjithatë, vlerësimi i ndikimit të tyre aktual në kontekstin shqiptar kërkonte fakte dhe të dhëna, të cilat studimi i IDM-së mori përsipër t’i gjeneronte përmes sondazhit dhe instrumenteve cilësore në zonat e synuara – intervistat me informuesit kyç dhe grupeve të fokusit.

Rrjedhimisht, u shqyrtua një kategori e re me nxitës potencialë të ekstremizmit të dhunshëm me katër faktorë të mundshëm që mundësojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin fetar. Në studimin e IDM-së shqyrtohet secili prej këtyre nxitësve me instrumente kërkimore cilësore dhe sasiore. Në tabelën e mëposhtme jepet një përshkrim, ndërkohë që në seksionet e mëtejshëm shtjellohen gjetjet për secilin prej tyre.

Tabela 5. Nxitës potencialë të ekstremizmit të dhunshëm specifikë për Shqipërinë

NXITËSI	PËRSHKRIMI
Tolerimi i institucioneve të paligjshme fetare (legjitimiteti)	<p>Qëndrimi ndaj institucioneve fetare (apo objekteve të kultit, si xhami, kisha, etj.) që veprojnë jashtë autoritetit të institucioneve zyrtare fetare dhe që nuk rregullohen nga legjislacioni përkatës (Marrëveshja me Shtetin).</p> <p>Në analizë shqyrtohen implikimet e “tolerimit të institucioneve të paligjshme fetare” në kontekstin e radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm.</p>
Autoriteti i kontestuar i institucioneve fetare në Shqipëri (niveli qendror)	<p>Synon të shqyrtojë ekzistencën dhe madhësinë e boshllëkut të raportuar mes autoriteteve fetare dhe klerikëve në nivel qendror (kombëtar) dhe komuniteteve të besimtarëve si dhe mosmarrëveshjet apo përplasjet e brendshme të fshehura ku përfshihen klerikë të rangjeve të ndryshme (nëse dhe si përkthehen ato tek komunitetet e besimtarëve).</p> <p>Në analizë shqyrtohen implikimet e “autoritetit të kontestuar” në kontekstin e radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm.</p>
(Mungesë) Ndikimi i klerikëve lokalë	<p>Roli i klerikëve lokalë është veçanërisht i rëndësishëm për parandalimin e radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ata janë në kontakt të përhershëm çdo ditë me anëtarët e komunitetit fetar. Për më tepër, ata duhet të jenë personi kryesor për të ndërmjetësuar kontaktet dhe trajtuar shqetësimet e besimtarëve në bashkëpunim me aktorë të tjerë.</p> <p>Në analizë shqyrtohen implikimet e këtij faktori në kontekstin e radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm.</p>
Niveli i përgatitjes së klerikëve lokalë	<p>Për t’iu përgjigjur dogmave/ideologjive radikale fetare dhe formave të ekstremizmit të dhunshëm fetar kërkohet një nivel i lartë i përgatitjes teologjike dhe edukimit të klerikëve, në mënyrë të veçantë të atyre që janë në kontakt të përhershëm me komunitetin e besimtarëve.</p> <p>Në analizë shqyrtohen implikimet e “përgatitjes së klerikëve lokalë” dhe performancës së tyre në kontekstin e radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm.</p>

Burimi: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim – IDM (2015)

6.4.1. TOLERIMI I INSTITUCIONEVE TË PALIGJSHME FETARE

Qëndrimi ndaj institucioneve fetare (apo objekteve të kultit, si xhami, kisha, etj.) që vepronjë jashtë autoritetit të institucioneve zyrtare fetare dhe që nuk rregullohen nga legjislacioni përkatës (Marrëveshja me Shtetin)

Zonat informale dhe ndërtimet e paligjshme kanë shoqëruar debatin dhe realitetin e periudhës post-komuniste prej 25 vitesh në Shqipëri. Legalizimi i zonave të tilla informale dhe i ndërtesave (kryesisht banimi) të paligjshme ka qenë një çështje rreth së cilës partitë politike në vend kanë bazuar premtimet e tyre elektorale dhe për të cilat kanë tërhequr vota, veçanërisht në periferi të zonave urbane.

Megjithatë, vetëm në vitet e fundit debati publik u "informua" për të ashtuquajturat objekte të paligjshme fetare, të ndërtuar nga individë dhe grupe besimtarësh shpesh me burime të huaja financiare. Përveç kësaj, një tjetër rrethanë që ka ndikuar në mënyrë të tërthortë në këtë drejtim është edhe rrugëtimi i gjatë i kthimit të apo kompensimit për objektet e kultit (xhami, kisha, teqe) që janë konfiskuar ose shkatërruar nga regjimi komunist në periudhën 1967 - 1990. Bashkësia myslimane shqiptare si komuniteti më i madh në vend është prekur më shumë nga ky fenomen, edhe pse raste të ngjashme janë raportuar edhe në raport me komunitetet e tjera.¹⁹⁹

Shumë nga raportet e mediave në tre vitet e fundit shpesh i janë referuar xhamive të paligjshme si burim i ekstremizmit fetar. I njëjti perceptim është hasur nga puna e IDM-së në terren, veçanërisht në intervistat me informuesit kyç të institucioneve shtetërore në nivel vendor, të cilët nuk raportuan për ndonjë aktivitet apo interes nga ana e institucionit

përkatës në trajtimin e shqetësimeve të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm (p.sh. njësitë e qeverisjes vendore, shërbimet sociale ose inspektoratet e arsimit). Për më tepër, shumë prej tyre fajësojnë mungesën e veprimeve nga ana e KMSH-së ndaj xhamive të tilla dhe pasivitetit të institucioneve të sigurisë dhe të tjera për t'i ndaluar ata.²⁰⁰

Gjithsesi, edhe pse është e rëndësishme të nënvizohet se pjesa më e madhe e objekteve të paligjshme fetare nuk e kanë njohur (dhe disa ende nuk e njohin) autoritetin e Komunitetit Mysliman Shqiptar, shqetësimi kryesor i këtij të fundit lidhet me besimtarët që frekuentojnë këto objekte.

*"Ndalimi i këtyre xhamive dhe ndjekja penale e klerikëve të tyre është detyra më e lehtë. Megjithatë, lind pyetja: - çfarë kemi bërë ose arritur me një gjë të tillë? Kjo thjesht do t'i përkeqësojë gjërat, sepse xhemati në këto institucione të paligjshme do të kthehet krejtësisht kundër KMSH-së, klerikëve tanë dhe shtetit, apo edhe kundër besimtarëve tanë myslimanë në sistemin e ligjshëm të xhamive. Ne nuk e duam këtë; në vend të kësaj duam që këto komunitete të besimtarëve, edhe pse të vogla, të integrohen me shumicën e xhematit shqiptar."*²⁰¹

Ndërkohë që qeveria shqiptare ka ndërgjegjësuar publikun dhe agjencitë shtetërore kanë ndërmarrë hapa konkretë për të luftuar fenomenin e ndërtimeve të paligjshme gjatë vitit të kaluar, studimi i IDM-së e shqyrton


këtë faktor me anë të përcaktimit të nivelit të tolerancës së të intervistuarve ndaj objekteve të paligjshme fetare. Pra, në studimin e IDM-së u pyetën të intervistuarit nëse ata bien dakord me

deklaratën e mëposhtme (të kontrollit):

Objektet fetare (kisha, xhami etj.) të ndërtuara pa lejen e komuniteteve përkatëse fetare duhen ndaluar.

Figura 29. Toleranca ndaj objekteve ilegale të kultit [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Objektet e kultit (kisha, xhamia, etj.) të ngritura pa lejen e komunitetit fetar përkatës duhen ndaluar?



Mbi 50% e të intervistuarve në secilën zonë të synuar bien dakord me këtë pohim, përveç të intervistuarve në Pogradec, ku shumica (38%) nuk janë dakord dhe 33% janë dakord. Pjesa më e madhe e një mbështetjeje të tillë për këtë pohim evidentohet në Cërrik, ku 75% e të intervistuarve besojnë se objektet fetare (kisha, xhami, etj.) të ndërtuara pa lejen e komuniteteve përkatëse fetare duhet të ndalohen.

Kjo pikëpamje ndahet nga më shumë se 50% e të intervistuarve në të gjitha nënkategoritë e demografisë.²⁰² Në përgjithësi, ky pohim mbështetet nga 60% deri në 70% e nënkategorive të mëposhtme demografike - të intervistuarat femra (60.4% e tyre), grupmoshat e "36-40 vjet" (66.7%)

dhe "41-45 vjeç" (71.7%), 60.3% e të anketuarve të papunë dhe 60.4% e të anketuarve me arsim të mesëm.

Ajo që ka më shumë rëndësi është se nuk ka diferenca të mëdha në mbështetjen për këtë pohim brenda tre nënkategorive të elementit "praktikim i rregullave fetare". Kjo pikëpamje mbështetet nga 56.4% e të anketuarve, të cilët e praktikojnë rregullisht fenë, 57.1% e atyre që praktikojnë ritualet kryesore dhe 56,1% e të intervistuarve që nuk e praktikojnë aspak fenë. Të anketuarit që nuk e praktikojnë fenë tregojnë përqindjen më të lartë (30.7%) të mospajtimit me pohimin.²⁰³ Tek nënkategoritë e tjera të të intervistuarve, ku përqindja e mospajtimit me deklaratën është mbi

mesataren prej 28% të kampionit të përgjithshëm, përfshihen të intervistuar meshkuj (32.1%), grupmoshat e “26-30 vjeç” (32.9%) dhe “31 -35 vjeç” (32.1%), dhe të intervistuarit me nivel arsimor të përfunduar deri në 9-vjeçar (29.6%).

Shumë pjesëmarrës të diskutimeve në fokus-grupe të kryera nën këtë studim e shpjegojnë “tolerancën” ndaj objekteve të paligjshme të kultit pikërisht me faktin se “këto objekte frekuentohen nga besimtarët që praktikojnë besimin

e tyre dhe për këtë arsye shteti dhe KMSH duhet të gjejnë alternativa për integrimin e tyre.” Gjithsesi, disa prej tyre ngrenë pikëpyetje në lidhje me klerikët e këtyre objekteve të paligjshme – “procedimi i këtyre klerikëve të paligjshëm që praktikojnë Islamin konservator duhet të jetë një opsion i fundit. KMSH duhet të krijojë kanale komunikimi dhe mjete për de-radikalizimin e tyre.”²⁰⁴

6.4.2. AUTORITETI I KONTESTUAR I INSTITUCIONEVE FETARE NË SHQIPËRI NË NIVEL QENDROR

Synon të shqyrtojë ekzistencën dhe madhësinë e boshllëkut të raportuar mes autoriteteve fetare dhe klerikëve në nivel qendror (kombëtar) dhe komuniteteve të besimtarëve si dhe mosmarrëveshjet apo përplasjet e brendshme të fshehta ku përfshihen klerikë të rangjeve të ndryshme (nëse dhe si përkthehen ato tek komunitetet e besimtarëve).

Shumë prej informuesve kyçë gjatë fazës fillestare të këtij studimi ngritën shqetësime rreth divergjencave të vazhdueshme të fshehura brenda KMSH-së dhe implikimeve të tyre të mundshme në kontekstin e një radikalizimi fetar dhe ekstremizmi të dhunshëm në vend. Këto divergjencia, që pretendohet se rrjedhin nga diversiteti i edukimit teologjik të klerikëve në vende të ndryshme të huaja, raportohet se kanë si qendër kontrollin dhe ndikimin tek radhët brenda institucionit të KMSH-së. Edhe pse divergjencia të tilla të brendshme të fshehura nuk pranohen se ekzistojnë (ose nënvlerësohet rëndësia dhe serioziteti i tyre) nga zyrtarët e KMSH-së në Tiranë, klerikët lokalë të KMSH-së në disa nga zonat e synuara i konfirmojnë këto shqetësime.²⁰⁵ Përveç kësaj, divergjencat e fshehura raportohen edhe nga informues të tjerë nga Tirana që përfaqësojnë institucionet jo-fetare, të cilët kanë

interes ose përvojë në diskursin mbi bashkësitë fetare në vend.

Pa paragjykuar përmbajtjen e këtyre debateve të brendshme, faza fillestare e këtij studimi sugjeron se është e rëndësishme të përcaktohet rëndësia, shkalla dhe potenciali i tyre për të krijuar një boshllëk mes autoriteteve fetare (klerikët e rangjeve të larta) dhe komunitetit të besimtarëve apo që çojnë në autoritetin e kontestuar të institucioneve fetare, gjë që mund të përdoren nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm për të siguruar më shumë mbështetje.²⁰⁶

Disa informues kyçë në Tiranë dhe në disa zona të synuara të studimit sugjerojnë se këto divergjencat kanë prodhuar pasoja negative brenda KMSH-së në të kaluarën. “Xhamitë e paligjshme në ditët e sotme përbëjnë një shembull të tillë ku divergjencat mes fraksioneve të ndryshme kanë çuar në një grup të tillë klerikësh që

kanë kontestuar autoritetin e KMSH-së.²⁰⁷ Megjithatë, informues të tjerë kyçë argumentojnë se divergjencat e brendshme janë sigurisht një faktor potencial që mund të mundësojë kushtet për grupet e ekstremizmit të dhunshëm, por efektet nuk janë përçuar në rradhët e xhematit. "Këto divergjencat shpesh kufizohen brenda organizmit dhe strukturave të brendshme të KMSH-së".²⁰⁸

Me qëllim analizimin e supozimeve dhe pozicioneve shpesh kontradiktore të informuesve kyçë lidhur me faktin nëse divergjencat e brendshme janë përçuar në rradhët e xhematit, studimi i IDM-së analizon mbështetjen që gëzon autoriteti qendror i KMSH-së nga të intervistuarit dhe në mënyrë të veçantë nga komuniteti i besimtarëve myslimanë në zonat e synuara. Siç shpjegohet në seksionin e metodologjisë së këtij studimi, kampioni i sondazhit është hartuar për të synuar 50% nga besimtarë myslimanë që praktikojnë fenë dhe

50% nga qytetarë të zgjedhur rastësisht në zonat e synuara. Megjithatë, duke pasur parasysh dominimin e komunitetit mysliman në këto zona, kampioni i përgjithshëm përbëhet kryesisht nga të intervistuar që raportojnë të kenë këtë përkatësinë fetare.


Në mënyrë specifike, 88% e të intervistuarve që iu përgjigjën pohimit për këtë nxitës të ekstremizmit të dhunshëm raportojnë "mysliman" si përkatësi të tyre fetare, 5.5% bektashi, 2.6% ortodoks, 1% katolik dhe pjesa tjetër raportojnë se nuk i përkasin asnjë feje. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh përqindjen e madhe, gjetjet janë indikative për KMSH-në.

Pohimi, për të cilin sondazhi i IDM-së pyeti të intervistuarit nëse ata janë dakord me qëllim analizimin e këtij nxitësi, është si më poshtë:

*Pozicioni/qëndrimi i kryetarit të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzon mbështetjen e plotë të besimtarëve në zonën ku banoj.*²⁰⁹

Figura 30. Mbështetja për krerët e komunitetit fetar [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Pozicioni/qëndrimi i kryetarit të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzon mbështetjen e plotë të besimtarëve



11% e të intervistuarve besojnë se kryetari i komunitetit të tyre fetar nuk gëzon mbështetjen e besimtarëve. Përqindja e të anketuarve të cilët ndajnë të njëjtin mendim është nën këtë mesatare në Përrenjas (3%), Kukës (8%) dhe Komunën Buçimas (9%). Nga ana tjetër, numri më i madh i të intervistuarve që besojnë se kryetari i komunitetit të tyre fetar gëzon mbështetje të plotë nga ana e besimtarëve identifikohet në Librazhd (66%).

Analiza e demografisë së të intervistuarve që nuk besojnë se kryetari i bashkësisë së tyre fetare gëzon mbështetje nga besimtarët lokalë evidenton mospërputhje të vogla brenda nënkategorive të ndryshme të demografisë. Këtë mendim e kanë 8% - 12% e të intervistuarve brenda pjesës më të madhe të nënkategorive të demografisë së të intervistuarve (p.sh. gjinia, statusi i punësimit, arsimit dhe grupmosha). Vetëm pak përjashtime që largohen nga kjo prirje mesatare, vërehen si më vijon: 16% e të intervistuarve të moshës 26-30 vjeç, 16% e atyre 36-40 vjeç dhe 14% e të intervistuarve që nuk praktikojnë aspak fenë besojnë se besimtarët lokalë nuk i mbështesin pozicionet ose qëndrimin e kryetarit të komunitetit të tyre fetar.

Mospërputhje më të mëdha brenda nënkategorive të demografisë vërehen

në lidhje me mbështetjen për këtë pohim. Për pjesën më të madhe të nënkategorive (të gjinisë, arsimit, grupmoshave, statusit të punësimit dhe "ushtrimit të fesë"), përqindja e të intervistuarve që mbështesin këtë deklaratë është më e ulët se 50% e të gjithë të intervistuarve në nënkategorinë përkatëse. Megjithatë, në disa nga këto nënkategori demografike vihet re një përjashtim. Konkretisht, përkrahja për këtë pohim paraqet një nivel të konsiderueshëm brenda këtyre nënkategorive si vijon: 56% e të gjithë të intervistuarve meshkuj, 64.5% të të gjithë të intervistuarve nga 41-45 vjeç, 62,2% e të intervistuarve me deri në nëntë vjet arsim dhe 52.3% e atyre me arsim të mesëm, 55% të të papunëve, 58,8% e atyre që ushtrojnë rregullisht fenë dhe 54,2% e të anketuarve të cilët praktikojnë vetëm ritet kryesore fetare.

Siç tregon edhe analiza në seksionet e mëposhtme, tendenca të ngjashme janë vërejtur edhe në lidhje me klerikët lokale dhe ndikimin e tyre mes besimtarëve, siç perceptohet nga të intervistuarit. Për më tepër, ndërkohë që disa pjesëmarrës në diskutimet në grup pranojnë ekzistencën e divergjencave midis klerikëve lokalë dhe autoriteteve të KMSH në nivel qendror, fokus-grupet nuk konfirmojnë që divergjenca të tilla të jenë përçar tek xhemati.

6.4.3. MUNGESË / NDIKIMI I KLERIKË LOKALË

Roli i klerikëve lokalë është veçanërisht i rëndësishëm për parandalimin e radikalizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ata janë në kontakt të përhershëm çdo ditë me anëtarët e komunitetit fetar. Për më tepër, ata (duhet) të jenë personi kryesor për të ndërmjetësuar kontaktet dhe trajtuar shqetësimet e besimtarëve në bashkëpunim me aktorë të tjerë.

Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë (2010) sugjeron se pjesa më e madhe e


shqiptarëve (59.1%) nuk e konsiderojnë veten fetarë.²¹⁰ Edhe pse nuk ka të

dhëna për përqindjen e qytetarëve që praktikojnë rregullisht besimin e tyre në institucionet fetare (kisha, xhami), sondazhe të ndryshme raportojnë se ky është një komunitet relativisht i vogël. Klerikët lokalë luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe zgjerimin e komuniteteve të tyre fetare. Në mënyrë që të jenë të suksesshëm në këtë drejtim dhe me ndikim tek besimtarët, shumë prej informuesve kyçë të këtij studimi argumentojnë se profili i klerikëve lokalë duhet të jetë një kombinim i aftësive që rrjedhin nga arsimi solid fetar, i komunikimit, besimit dhe të qënurit i hapur. Aftësi të tilla si dhe niveli i ndikimit tek bashkësitë fetare janë mjaft të rëndësishme, ndër të tjera, për të siguruar edhe një rol aktiv të klerikëve lokalë në përgjigjen ndaj dhe parandalimin e devijimeve fetare.

Në përgjithësi, klerikët e KMSH-së në nivel vendor argumentojnë se “padija fetare”, niveli i ulët arsimor dhe izolimi janë arsye kryesore pse grupet e ekstremizmit të dhunshëm ia kanë dalë të manipulojnë qytetarët në vend dhe t’i rekrutojnë ata si luftëtarë të huaj jashtë vendit. Ndonëse klerikët lokalë nuk përjashtojnë arsye ekonomike (ose premtime për jetë më të mirë), shumë prej tyre besojnë se këto nuk janë një faktor dominues.

Megjithatë, qytetarët e intervistuar paraqesin përgjithësisht të njëjtat “tre arsye kryesore”, por në renditjen e kundërt. Një perceptim i tillë nga shumë klerikë, ekspertë dhe informues të tjerë kyçë shpjegohet me ndikimin e medias, e cila nuk ka mundur të sigurojë “analiza të plota dhe të mbështetura në fakte” mbi fenomenin për publikun e gjerë.²¹¹

Figura 31. Arsyet kryesore të rekrutimit në grupe ekstremiste të dhunshme [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]



Megjithatë, kjo sugjeron se ka ende vend për përmirësim jo vetëm për të ndërtuar komunitete fetare të qëndrueshme, por edhe për forcimin e lidhjeve dhe komunikimit mes klerikëve dhe bashkësive të tyre. “Kjo duhet të zhvillohet edhe në drejtim të bashkëpunimit me institucionet shtetërore, të cilat shpesh nuk i kuptojnë ashtu siç duhet shqetësimet e xhematit.”²¹²


Shumë nga informuesit kyçë dhe pjesëmarrës të fokus-grupeve në nivel vendor raportojnë se veprimet e institucioneve të sigurisë mund të kenë efekt të kundërt – “kjo mund të perceptohet si ngacmim nga anëtarët e xhematit.”²¹³ Në fakt, për herë të parë në vitin 2013, Indeksi i Kufizimeve të Qeverisë (GRI), të përgatitur nga Qendra Kërkimore Pew (Pew Research Center), raporton për “ngacmime apo kërcënime të kufizuara të grupeve fetare nga shkallë të ndryshme të qeverisë” apo për ngjarje të “dhunës fizike”.²¹⁴

Informuesit kyçë të KMSH-së në nivel vendor sugjerojnë se ka nevojë për trajnim të imamëve, në veçanti për mënyrën se si të përballen me devijimet fetare. “Të rinjtë sot kanë mundësi për të parë burime të ndryshme informacioni në internet, por jo të gjitha këto burime ofrojnë njohuritë e duhura fetare. Kështu, imamët duhet zhvillojnë aftësitë për të punuar me të rinjtë dhe grupet e rrezikuara, por edhe të ndërveprojnë më shpesh me institucionet në nivel vendor, me shkollat, njësitë e qeverisjes vendore, etj. Sa më afër të jetë imami me problemet dhe shqetësimet e xhematit, aq më shumë ndikim perceptohet ai nga besimtarët dhe nga aktorë të tjerë në komunitetin vendor.”²¹⁵

Për të shqyrtuar perceptimet e qytetarëve nga kjo perspektivë, sondazhi i IDM-së pyeti të intervistuarit nëse ata janë dakord me pohimin e mëposhtëm: “Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të lartë tek besimtarët.”²¹⁶

Figura 32. Influenca e klerikëve lokalë [Burimi: Sondazhi i IDM-së 2015]

Klerikë lokalë me ndikim?



Më shumë se gjysma (56%) e të anketuarve besojnë se klerikët lokalë kanë ndikim të madh në komunitetin e tyre të besimtarëve, ndërsa 13% mendojnë të kundërtën. Në përgjithësi, kjo prirje është e pranishme në të gjitha zonat e synuara, me përjashtim të Pogradecit, ku vetëm 31% e të intervistuarve besojnë në ndikimin e klerikëve vendorë, 30% nuk e mendojnë një ndikim të tillë dhe 39% të tjerë nuk kanë mendim për këtë çështje. Një përqindje e konsiderueshme (24%) e të intervistuarve në Komunën e Buçimasit nuk mendojnë se kleriku i tyre vendor ka ndikim te komuniteti fetar, në krahasim me 53% që kanë një mendim të tillë.

Analiza e demografisë e përgjigjeve të të intervistuarve tregon korrelacione brenda kategorive. Konkretisht, perceptimi që "klerikët vendorë kanë ndikim te besimtarët" rritet me rritjen e moshës së të intervistuarve - nga 49% të grupmoshës "18-25 vjeç", në 50.3% të grupmoshës "26-30 vjeç", 57,3% tek grupmosha "31-35 vjeç", 65.9% te grupmosha "36-40 vjeç", tek maksimum prej 68,3% e të intervistuarve brenda kategorisë "41-45 vjeç".

Ekziston një korrelacion edhe kur analizohet pesha e këtij perceptimi brenda grupeve të nivelit arsimor - sa më shumë vite arsimit të përfunduar, aq më e ulët është përqindja e të intervistuarve që i shohin klerikët lokalë me ndikim tek besimtarët (66,9% e të intervistuarve me arsim deri në nëntë vjet, 62.2% me arsim të mesëm në vetëm 39.9% e të anketuarve me universitet ose studimet pasuniversitare të përfunduara).

Klerikët lokalë perceptohet të kenë ndikim sidomos tek të intervistuarit fetarë (73%) ose kryesisht fetarë (56.3%), ndërsa të anketuarit të cilët nuk e praktikojnë aspak fenë tregojnë përqindje shumë më të ulët - vetëm 38% e tyre besojnë se klerikët lokalë janë me ndikim.

Kjo nënkategori (jo-fetare) shfaq përqindjen më të lartë (18%) të mospajtimit me pohimin. Po ashtu, 16% e të intervistuarve me diplomë pas/universitare, 16.6% e të gjithë të intervistuarve të grupmoshës 26-30 vjeç dhe 15% e grupmoshës 36-40 vjeç nuk mendojnë se klerikët lokale kanë ndikim tek besimtarët.

6.4.4. NIVELI I PËRGATITJES SË KLERIKËVE

"Përgjigja ndaj ideologjive radikale fetare dhe formave të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm kërkon një nivel të mire arsimor dhe formim teologjik të klerikëve, veçanërisht të atyre që janë në marrëdhënie të vazhdueshme me komunitetin e besimtarëve."

Komunitetet fetare kanë një rol kyç në parandalimin e faktorëve burimorë dhe të rreziqeve nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm me baza fetare duke promovuar edukimin e modelit të duhur të praktikimit të fesë dhe duke mënjanuar çdo mundësi që praktikimi i saj të keqpërdoret.

Përballja në nivel vendor me rrezikun e indoktrinimit dhe rekrutimit të pjesëtarëve të komunitetit fetar nga grupe me axhendë radikale fetare, kërkon që drejtuesit fetarë të jenë mjaftueshëm të përgatitur në aspektin e përgjithshëm arsimor dhe të kenë formim të mire teologjik për

të kundërshtuar në mënyrë bindëse dogmën dhe ideologjitë radikale fetare.

Sipas rregullores së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Myftijtë të cilët ndjekin dhe kontrollojnë veprimtaritë fetare në xhamitë brenda juridiksionit të myftinisë së tyre, si dhe udhëzojnë imamët për kryerjen e riteve fetare në xhami, duhet të kenë kryer fakultet teologjik ose medresenë dhe fakultet laik. Për vetë rolin drejtues dhe përgjegjësinë e tyre, krahas nivelit të mire arsimor, kërkohet që ata të kenë përvojë profesionale të paktën pesë vjeçare në organikën e KMSH.²¹⁷ Krahas Myftijve, Imamët kanë një rol mjaft të rëndësishëm në marrëdhënien e përditshme me besimtarët në çdo xhami. Megjithatë, ndryshe nga Myftijtë, kriteret arsimore (teologjike dhe laike) dhe profesionale për caktimin e Imamëve nuk janë mjaft rigorozë dhe të qarta.

Sipas të intervistuarve, arsimimi i imamëve përbën një nga sfidat e Komunitetit Mysliman sot në Shqipëri. Niveli arsimor dhe formimi i posaçëm teologjik i imamëve konsiderohet i pamjaftueshëm, sidomos i atyre të cilët shërbejnë në zona rurale të vendit. Kryesisht, imamët kanë mësuar në mënyrë autodidakte, kanë ndjekur kurse profesionale dhe trajnime, apo kanë përfunduar medresenë. Një numër i kufizuar i tyre kanë përfunduar arsimin e lartë laik. Duke marrë në konsideratë pagat e ulëta të klerikëve, kërkohet që KMSH të ofrojë falas kurse dhe trajnime profesionale për imamët, si dhe të organizojë simpoziume rreth problematikës aktuale të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Nevojitet që përmes qarkoreve të institucionit drejtues të nxitën dhe udhëzohen klerikët lokalë për trajtimin e këtyre çështjeve me besimtarët në komunitetin e tyre. Për më tepër, sugjerohet që përfaqësues zyrtarë të

KMSH, klerikë dhe teologë të njohur të hartojnë "fatwa" (opinione) publike për kundërshtimin e ideologjive të grupeve radikale, përmes referimit të shkrimeve të shenjta. Nga ana tjetër, trajnimi i posaçëm i imamëve me qëllim aftësimin e tyre për të kundërshtuar në mënyrë sa më të plotë, bindëse dhe të argumentuar ideologjinë e grupeve radikale fetare, do të rriste impaktin e tyre në komunitet dhe parandalonte manipulimin fetar të pjesëtarëve të xhematit (komunitetit) të tyre.

Gjatë intervistave në terren janë identifikuar gjithashtu sfida të ndryshme. E para lidhet me faktin që disa xhami, përgjithësisht në zona të largëta rurale, janë aktualisht pa imamë ndërsa shërbimet për besimtarët vendas plotësohen nga klerikët e zonave përreth. Shqetësim tjetër i parashtruar nga të intervistuarit, lidhet me nevojën për të kontrolluar dhe vlerësuar rregullisht punën e klerikëve lokalë, me qëllim parandalimin e rasteve negative të përfshirjes të imamëve, drejtëpërdrejtë apo tërthorazi, në veprimtari të grupeve radikale dhe ekstremizmit të dhunshëm.


Rëndësia e 'përgatitjes së klerikëve' merret në shqyrtim përmes analizimit të të dhënave të përfutuara nga sondazhi i kryer në tetë zonat e targetuara, specifikisht nëpërmjet përgjigjeve të të anketuarve lidhur me pohimin e mëposhtëm:

Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar.

Një terren i favorshëm për individë dhe grupe radikale vlerësohet mbi bazë të "përgjigjeve pozitive" për këtë pohim. Grafiku 33 paraqet gjetjet e anketimit në lidhje me këtë nxitës të mundshëm.

Figura 33. Formimi fetar i klerikëve [Burimi: Anketa IDM 2015]

Klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar?



Shumica e të anketuarve besojnë se klerikët në komunitetin e tyre nuk kanë arsimin/formimin e duhur fetar (45%). Ndërsa 34% e të anketuarve deklarojnë që nuk kanë dijeni rreth nivelit të arsimit dhe formimit fetar të klerikëve në zonën e tyre. Vetëm 21% e të pyeturve besojnë se klerikët në komunitetin e tyre fetar kanë arsimin dhe formimin fetar të mjaftueshëm. Në nivel zonash të caktuara, numri më i lartë i të anketuarve të cilët besojnë që klerikët e komunitetit të tyre fetar nuk kanë arsimin dhe formimin fetar të duhur regjistrohet në Përrenjas (68.7%), kurse numri më i vogël i tyre rezulton në komunën Buçimas (23%).

Demografia e të anketuarve të cilët janë më të prirur të besojnë se *klerikët në komunitetin e tyre fetar nuk kanë arsimin/formimin e duhur fetar* (45.5%), paraqitet e tillë: shumica e tyre janë femra (56%), persona të grupmoshës 18-25 vjeç (55%) dhe atyre të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë (55.6%).

Përsa i përket statusit të punësimit, ky perceptim është më i fortë midis personave të punësuar (46%). Të anketuarit të cilët praktikojnë vetëm rregullat dhe ritualet kryesore fetare (56.2%) janë më të prirur të ndajnë të njëjtin perceptim.

Këto të dhëna nga analiza e përgjigjeve të të anketuarve lidhur me formimin e klerikëve vendorë reflektojnë në një masë të konsiderueshme shqetësimet e ngritura nga intervistat dhe në diskutimet me focus grupe. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për besimtarët e rinj në moshë, duke pasur parasysh edhe faktin se Shqipëria ka një popullsi mjaft të re ku një pjesë e mire e tyre mund të shfrytëzojnë më shumë burime alternative online për informim dhe njohuri fetare. Një profil sa më i kompletuar i klerikëve lokalë nga pikpamja e formimit fetar por edhe e aftësive për të krijuar lidhje të ngushta me xhematin është thelbësore për të minimizuar manipulimin fetar.

7



PËRFUNDIME

Radikaliz(i)mi me baza fetare shqyrtohet në këtë studim si një seri procesesh të larmishëm përmes të cilëve individë të caktuar adoptojnë bindje që justifikojnë dhe propagandojnë dhunën. Nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm nuk kufizohen në faktorë të veçantë por ata shfrytëzojnë faktorë nxitës dhe dinamika të ndryshme në shoqëri që lehtësojnë përfshirjen në aktivitete të ekstremizmit të dhunshëm.

Studimi i IDM konstaton se ndonëse radikalizmi fetar në Shqipëri ndodhet në fazat e hershme të tij, mungesa e vëmendjes dhe gjithëpërfshirjes në trajtimin e faktorëve nxitës ose mundësues të tij mund t'i shërbejë përkeqësimit të fenomenit. Përtej jehonës së përgjithshme të 'harmonisë fetare' nga njëra anë, apo teprimit mediatik me "xhihadistët shqiptarë" që luftojnë në Siri nga ana tjetër, një sërë informuesish kyçë të studimit kundërshtojnë idenë se disa forma të radikalizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm (p.sh., ndërtimi dhe funksionimi i 'xhamive pa leje' dhe qytetarë shqiptarë si 'luftëtarët të huaj' në Siri) janë raste sporadike dhe të izoluara. Megjithëse përgjithësisht ngurrohet për të diskutuar hapur problematika me kontekst fetar, studimi pohon se heshtja lidhur me probleme ekzistuese mund të lehtësojë dhe favorizojë agjendën e grupeve të caktuara radikale fetare dhe propaganduese të dhunës. Në mënyrë të veçantë, ekspertë dhe informues të tjerë kyçë të studimit e vendosin theksin tek adresimi i divergjencave të ndryshme brenda KMSH-së, të cilat ndonëse nuk janë përçarur ende tek perceptimi i besimtarëve sipas sondazhit të IDM, potencialisht krijojnë hapësira veprimi për grupe me agjendë radikale fetare. Përmirësimi i kapaciteteve dhe i formimit të klerikëve në nivel vendor, i komunikimit

të vazhdueshëm me komunitetin e besimtarëve dhe veçanërisht me të rinjtë si edhe forcimi i bashkëpunimit të klerikëve me aktorë të tjerë në nivel vendor mbeten po aq të rëndësishme. Nga ana tjetër, sfidat financiare të KMSH-së, të reflektuara si në pagat e ulëta të klerikëve apo edhe në mungesën e klerikëve në disa xhami, kryesisht në zona të largëta rurale, bëhen shqetësuese për faktin se mungesa e kontrollit efektiv të KMSH-së mbi disa objekte të kultit mund të krijojë hapësira veprimi për grupet radikale. Ofrimi i predikimeve fetare dhe kurseve të ndryshme janë disa nga metodat e përdorura prej grupeve radikale për t'u prezantuar dhe influencuar frekuentuesit e këtyre xhamive. Një formë më e skajshme e përthyerjes së këtyre hapësirave ka qenë kontestimi i hapur i autoritetit të KMSH-së si dhe xhamitë e paligjshme. Trajtimi i kësaj sfide duhet të udhëhiqet nga nevoja për shmangien e ndasive mes komunitetit të besimtarëve.

Studimi konstaton pasivitet për trajtimin dhe parandalimin e radikalizimit fetar tek një pjesë e mirë e institucioneve shtetërore, veçanërisht institucionet jashtë spektrit të sigurisë, si edhe tek aktorët jo-shtetërorë. Fenomeni i radikalizmit fetar mund të zhvillohet më tej për shkak të mungesës së një bashkëpunimi përmbajtësor në drejtim të parandalimit të fenomenit midis autoriteteve shtetërore jashtë fushës së sigurisë dhe drejtuesve të komuniteteve fetare. Gjithashtu, agjenda e grupeve radikale fetare mund të lehtësohet dhe favorizohet edhe nga mungesa e shoqërisë civile në zona të largëta rurale, e cila krijon një boshllëk në drejtim të aktiviteteve "mbrojtëse" ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Aktivitete të tilla konsiderohen inkurajimi për pjesëmarrje dhe aftësimi i të rinjve, programe për zbutjen e varfërisë,

përfshirja në debate mbi vlerat dhe të drejtat e njeriut, dhe fushatat ndërgjegjësuese kundër diskriminimit dhe islamofobisë.

Radikalizimi fetar (si proces) dhe ekstremizmi i dhunshëm (si rezultat) mundësohen dhe nxiten nga një larmi faktorësh të cilët ndërveprojnë në një kontekst shoqëror (makro) dhe individual/grupi (mikro). Megjithatë, jo gjithmonë prania dhe ndërveprimi i këtyre faktorëve prodhon forma të ekstremizmit të dhunshëm, pavarësisht potencialit të tyre. Ndonëse pjesëmarrja e qytetarëve shqiptarë në konflikte të huaja raportohet deri më tani si forma e vetme e ekstremizmit të dhunshëm me baza fetare, studimi konstaton ekzistencën e disa parakushteve, të cilat potencialisht mund të keqpërdoren për manipulimin fetar. Mbështetja e gjerë e komuniteteve të besimtarëve fetarë ndaj traditës liberale të besimit, institucioneve fetare dhe vlerave të harmonisë fetare nuk duhet të shërbejë si justifikim për pasivitetin e aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë. Nga ana tjetër, keq-interpretimi i fenomenit, minimizimi i rëndësisë së tij apo identifikimi i tij me pasojat (kryesisht në fushën e sigurisë) orienton drejt përjasjes së gabuar dhe eventualisht efekte kundër-produktive të reagimit të institucioneve.

Për këtë arsye studimi i IDM fokusohet veçanërisht tek 'makineria' e fenomenit dhe jo thjesht tek 'produkti' i tij. Kjo përjasje synon njohjen e plotë të mjedisit dhe faktorëve socialë, ekonomikë, kulturorë, politikë e të tjerë në mënyrë që të mbërrihet tek përfundime dhe rekomandime që ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme për adresimin e burimeve dhe arsyeve që mundësojnë ose ushqejnë radikalizimin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm. Në këtë kontekst, studimi ka shqyrtuar kontekstin e plotë në nivel kombëtar

dhe të zonave të synuara si edhe rëndësinë, mënyrën e ndërveprimit dhe potencialin radikalizues të faktorëve të ndryshëm.

NXITËS SOCIAL- EKONOMIKË

Komunitete të caktuara në Shqipëri, kryesisht në zona të pazhvilluara rurale dhe në periferitë e zonave urbane, ndihen të braktisura nga shteti dhe të privuara nga mundësitë e ndryshme social-ekonomike. Perceptime të forta të përjashtimit shoqëror dhe marginalizimit përfshijnë:

- a. Mungesa e përfshirjes së të rinjve të këtyre zonave në aktivitete që i mbajnë larg nga veset dhe sjelljet e rrezikshme. Rreth 70% e të anketuarve shprehen se të rinjtë e komunitetit të tyre kanë shumë kohë të lirë në dispozicion dhe nuk janë të angazhuar në aktivitete të dobishme.
- b. Mundësitë e ulëta për punësim pavarësisht arsimimit të mirë mund të shërbejnë si një faktor potencial për radikalizim. Kjo ndjesi e përgjithshme privimi dhe pritshmëri të dështuara përjetohet afërsisht nga gjysma e të anketuarve (49%).
- c. Një tjetër faktor lehtësues apo nxitës i radikalizimit është mospërbushja e nevojave sociale dhe ekonomike nga individë apo grupe të caktuara. Kjo formë privimi, e vetme apo e kombinuar me faktorët e mësipërm, bën që individët/familjet në nevojë të ekspozohen dhe të jenë më pranuese ndaj

shërbimeve dhe alternativave të ofruara nga grupet radikale për përmbushjen e nevojave të tyre bazë.

- d. Privimi nga mundësitë social-ekonomike shoqërohet me ndjesinë e të qenit i përjashtuar dhe i diskriminuar. Një në dy të anketuar beson se komuniteti fetar, të cilët ai i përket, nuk është i përfaqësuar mjaftueshëm në politikë dhe institucione shtetërore (51%).

Zbutja e efekteve të faktorëve të mësipërm përbën sfidë për aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë në nivel vendor dhe qendror. Zonat periferike dhe rurale shfaqin treguesit më shqetësues për të katër faktorët e sipërpërmendur, ndërsa personat apo grupet më të cënueshëm ndaj radikalizimit janë individë dhe familje në nevojë, të rinj të papunë apo të paangazhuar në aktivitete të dobishme. Personat në kushte të tilla, të cilët besojnë se janë të diskriminuar për shkak të besimit të tyre, janë akoma më të rrezikuar nga ndikimi i grupeve radikale fetare.

NXITËS POLITIKË

Zona të caktuara me kontekste specifike politike mund të jenë më të prirura se të tjerat për të prodhuar radikalizim fetar dhe ekstremizëm të dhunshëm. Të dhënat e përfuara në terren nga studimi sugjerojnë se faktorët e mëposhtëm meritojnë një vëmendje të veçantë:

- a. Pamundësia për të ndikuar në vendimmarrjen apo për ta reformuar atë, e cila konsiderohet e padrejtë dhe e korruptuar, është një faktor i fortë që mund të nxisë

përfshirjen në ekstremizëm të dhunshëm. Kështu, 55% e të anketuarve besojnë se përgjithësisht të drejtat dhe liritë e tyre nuk respektohen nga institucionet shtetërore, ndërsa 26% e të anketuarve në këtë studim besojnë se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar edhe me dhunë po qe nevoja.

- b. Zona të izoluara, përgjithësisht me popullsi të vogël dhe larg vëmendjes së shtetit mund të shndërrohen në “inkubatorë” për grupe të ekstremizmit të dhunshëm. Rreth 54% e të anketuarve besojnë se “forca” e shtetit është më e ulët në zonat rurale se në qytete.
- c. 47% e të anketuarve besojnë se mbrojtja me çdo mjet, brenda apo jashtë kufijve, e vlerave dhe dinjitetit fetar është detyrë e çdo besimtari.
- d. Dhuna, keqtrajtimi apo përndjekja nga policia dhe forcat e sigurisë mund të provokojnë ndjenja hakmarrjeje dhe mbështetje për grupet ekstremiste të dhunshme. 30% e të anketuarve në këtë studim e justifikojnë hakmarrjen kundër institucioneve shtetërore, nëse ato shkelin të drejtat dhe liritë e njeriut.

Individë apo grupe personash, të cilët shfaqen më të rrezikuar për t’u përfshirë në veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm, janë ato persona që banojnë në zona të “harruara” nga vëmendja e qeverisë dhe pa mundësi efektive për të ndikuar apo reformuar vendimmarrjen në komunitetin e tyre. Rreziku për përfshirje në veprimtari të dhunshme kundër institucioneve dhe punonjësve të tyre (p.sh., policisë)

është më i lartë nëse këta individë kanë rënë pre e abuzimit dhe dhunimit të të drejtave të tyre nga organet e zbatimit të ligjit. Mjaft shqetësues është fakti se kryesisht moshat e reja nga 18 deri 30 vjeç (jo praktikantë të fesë) me arsim të ulët dhe të papunë shfaqen më të prirur për të mbështetur përdorimin e dhunës. Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore dhe ofrimi i mundësive efektive për të marrë pjesë në vendimmarrjen në nivel vendor apo qendror janë kusht dhe shërbejnë për forcimin e marrëdhënies qytetar-shtet. Po ashtu, është e nevojshme që institucionet arsimore, komunitetet fetare, shoqëria civile dhe aktorë të tjerë të luajnë një rol më aktiv.

NXITËS KULTURORE

Ekziston një lidhje e fortë midis ekstremizmit të dhunshëm dhe perceptimeve të kërcënimeve ndaj kulturës së një vendi apo sulmeve ndaj traditës dhe besimit Islam prej vendeve perëndimore. Faktorët më të spikatur në këtë kontekst, janë:

- a. Rreth 1/3 e të anketuarve besojnë se traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar është nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm, ndërsa Perëndimi shihet si armiqësor ndaj vendeve dhe kulturës Islame. Sipas të njëjtës përqindje të të intervistuarve, sot në Shqipëri është e vështirë të praktikosh fenë islame.
- b. Rreth 12% e të anketuarve besojnë se në komunitetin e tyre ka individë apo grupe që nxisin radikalizmin Islamik.

Kategoritë e qytetarëve më të rrezikuara nga manipulimi fetar dhe më pranuese ndaj propagandës së grupeve radikale për sulme ndaj besimit dhe kulturës islame janë veçanërisht meshkuj të grupmoshës 31-35 vjeç, praktikantë të fesë, me arsim të mesëm dhe që nuk janë të punësuar. Për të kundërshtuar "narrativën viktimizuese" të traditës, besimit dhe dinjitetit të një komuniteti fetar nevojitet që figura të besueshme të komuniteteve fetare dhe përfaqësuesit e tyre në nivel vendor të punojnë më ngushtësisht me besimtarët duke konsideruar, gjithashtu, edhe mundësinë e programeve të deradikalizimit. Më tej, përqsja e institucioneve shtetërore duhet të ndryshojë në drejtim të gjithëpërfshirjes (brenda aktorëve shtetërorë) dhe partneritetit me komunitetet fetare dhe shoqërisë civile në funksion të parandalimit. Identifikimi i individëve apo grupeve të dyshuara për nxitjen e radikalizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm është një detyrë e organeve ligjzbatuese e cila duhet kryer me shumë përgjegjësi. Megjithatë, parandalimi i fenomenit përbën një sfidë, para së gjithash, për aktorët e tjerë të shoqërisë.

NXITËS SPECIFIKË PËR SHQIPËRINË

Përveç faktorëve të mësipërm, në fazën paraprake të hulumtimit u evidentuan një sërë faktorësh specifikë për Shqipërinë, të cilat ekspertë dhe aktorë kyçë i konsideruan potencialisht me ndikim për fenomenin e radikalizimit fetar. Pavarësisht relevancës së argumentuar, hulumtimi dhe puna në terren për një pjesë të tyre nuk konfirmuan ndikim konkret, ndërsa për

pjesën tjetër të faktorëve specifikë që mund të lehtësojnë radikalizmin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm gjetjet kryesore përfshijnë:

- a. Rreth 28% e të anketuarve shprehen tolerantë ndaj objekteve fetare pa leje (kisha, xhami). Një qëndrim i tillë paraqitet shqetësues duke pasur parasysh se këto mjedise shpesh janë raportuar si propaganduese të ekstremizmi fetar. Nga ana tjetër, ekspertët sugjerojnë se masat ndaj këtyre objekteve duhet të udhëhiqen nga nevoja për të shmangur radikalizimin apo përçarjen mes besimtarëve.
- b. Rreth 21% e të pyeturve nuk besojnë se klerikët në komunitetin e tyre kanë nivelin e duhur të formimit teologjik. Për shkak të marrëdhënies së përditshme të klerikëve me komunitetin e besimtarëve, është kritike që ata të jenë të përgatitur dhe të aftë për të kundërshtuar në mënyrë bindëse ideologjitë e grupeve të ekstremizmit fetar dhe të trajtojnë në mënyrë të përshtatshme shqetësimet e besimtarëve.

Duke qenë komuniteti më i madh fetar në vend, sfidat kryesore në këtë kontekst paraqiten për KMSH-në dhe klerikët lokalë, të cilët janë përgjegjës për mbrojtjen e besimtarëve nga ndikime të rrezikshme fetare. Shqetësimet e hasura brenda komunitetit mysliman mund të trajtohen njëkohësisht nga vetë strukturat e brendshme ashtu edhe në bashkëpunim me aktorët e tjerë relevantë.

Përgjithësisht faktorë të ndryshëm ndërveprojnë dhe përforcojnë njëri

tjetrin duke rritur rrezikun e mbështetjes apo përfshirjes në aktivitete ekstremiste fetare. Kështu, perceptime të përjashtimit shoqëror dhe marginalizimit ndërthuren zakonisht me perceptime të përjashtimit shoqëror për shkak të besimit si dhe situata të privimit relativ dhe pritshmërive të dështuara. Gjithashtu, faktorë social-ekonomikë, të tillë si përjashtimi shoqëror, ndërthuren me faktorë politikë (p.sh. zona të qeverisura dobët) dhe me nxitës kulturorë që mundësojnë përhapjen e agjendës proaktive fetare të grupeve radikale përmes ofrimit të shërbimeve, mundësive financiare dhe të punësimit. Faktorë politikë si perceptime të një qëndrimi armiqësor dhe sulmues të Perëndimit ndaj Islamit shoqërohet në praktikë dhe me prirjen e disa personave për të kundërshtuar ndalimin e objekteve pa leje të kultit (faktor specifik për vendin tonë).

Bazuar në gjetjet dhe përfundimet e mësipërme, studimi i IDM-së parashtron në seksionin vijues një seri rekomandimesh për aktorët kryesorë veçanërisht në funksion të parandalimit të fenomenit dhe pasojave të tij.

8



REKOMANDIME

Duke u mbështetur në analizën e gjetjeve të këtij studimi rekomandimet e mëposhtme trajtojnë masa dhe alternative konkrete në mbështetje të parandalimit dhe trajtimit të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm në kontekstin e Shqipërisë. Propozimet, të cilat nuk janë shteruese, synojnë adresimin e problematikës së evidentuar lidhur me katër kategoritë e shqyrtuara të faktorëve nxitës të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm: social-ekonomikë, politikë, kulturorë dhe faktorë specifikë për vendin tonë. Ndërkohë që rekomandimet u drejtohen tre aktorëve kyçë –

institucioneve shtetërore, Komunitetit Mysliman Shqiptar dhe shoqërisë civile – studimi sugjeron se përgjegjësia për parandalimin dhe trajtimin e radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm duhet konsideruar si një përgjegjësi më e gjerë shoqërore. Rrjedhimisht, procesi i përhithjes së gjetjeve të studimit dhe zbatimit të rekomandimeve të tij duhet të udhëhiqet nga një përqsasje gjithëpërfshirëse që reflekton mbi sfida shoqërore me ndikim tek fenomeni dhe fuqizon “agjentë të ndryshimit” në nivel kombëtar dhe veçanërisht pranë komuniteteve vendore të rrezikuara më së tepërmi.

8.1. INSTITUCIONET SHTETËRORE

Rritja e radikalizimit fetar konsiderohet në dokumentin e sigurisë kombëtare të Shqipërisë si një rrezik ndaj vlerave të harmonisë fetare në vend dhe shkak i mundshëm për tension shoqëror. Ruajtja e kohezionit shoqëror dhe harmonisë fetare janë të një rëndësie parësore dhe për këtë qëllim duhen ndërmarrë një sërë masash mbështetëse me qëllim rritjen e bashkëpunimit me bashkësitë fetare, hartimin e politikave të bazuara në të dhëna dhe marrjen e masave ligjore, institucionale, social-ekonomike, etj., përfshirë ndërgjegjësimin e opinionit publik, për të parandaluar dhe për t’iu kundërvënë shfaqjeve të radikalizimit fetar. Në këtë kuadër, një vëmendje e veçantë u duhet kushtuar të rinjve dhe komuniteteve të marginalizuara jo vetëm në zona rurale por edhe në periferinë e zonave të zhvilluara urbane. Përqsasja e institucioneve shtetërore nuk duhet kufizuar në masa të reagimit penal. Parandalimi

i fenomenit është ngushtësisht i lidhur me përqsasje gjithëpërfshirëse dhe me masa që reflektojnë natyrën dhe dinamikën e faktorëve nxitës të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm në lokalitete dhe tek popullsi të cënueshme në nivel vendor. Në këtë kontekst, studimi konstaton se është thelbësisht e rëndësishme ndërmarrja e masave të mëposhtme nga institucionet shtetërore:

- Trajtimin e fenomenit të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm përtej kufijve të sektorit të sigurisë duke përfshirë në mënyrë aktive agjenci dhe institucione shtetërore në fushat e qeverisjes vendore, arsimit, çështjeve sociale dhe të rinisë, punësimi, anti-diskriminimi etj. si edhe aktorë jo-shtetërorë, mbi të gjitha komunitetet fetare dhe shoqërinë civile. Hartimi i

- programeve parandaluese ndaj fenomenit dhe përfshirja në to e aktorëve me ndikim duhet gjithashtu të shoqërohet me një rol më aktiv të institucioneve shtetërore, sidomos në nivel vendor. Rritja e kapaciteteve dhe burimeve për Komitetin Shtetëror të Kulteve duhet të shoqërohet edhe me qartësimin e kompetencave të tij dhe me krijimin e mekanizmave që sigurojnë bashkëpunim të vazhdueshëm me komunitetet fetare, si dhe me nisma të përbashkëta me institucione të pavarura (Avokati Popullit, Komisioneri kundër Diskriminimit, etj.) dhe me aktorë jo-shtetërorë për parandalimin e fenomenit, reagimin në kohë ndaj tij, trajtimin e parajgjyqimeve me baza fetare jo vetëm tek qytetarët por edhe tek përfaqësues të administratës dhe institucioneve shtetërore;
- Me qëllim zbutjen e formave të privimit relativ dhe pritshmërive të dështuara, sidomos midis të rinjve në zonat periferike dhe rurale, nevojitet: ofrimi i mundësive shtesë për trajnime profesionale dhe zhvillimin e aftësive të vlerësuara nga punëdhënësit; ndërtimi, shtrirja dhe përmirësimi i mekanizmave që synojnë lehtësimin e tranzicionit nga shkolla në punë. Për këtë qëllim, institucionet shtetërore duhet të bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile për ofrimin e informacionit rreth mundësive për trajnime rikualifikimi, bursa, punësim, dhe burime financimi për projekte komunitare; mbështetja dhe nxitja e bizneseve të cilat punësojnë të rinjtë dhe mbështetja e të rinjve sipërmarrës përmes skemave të granteve të vogla dhe mikro-kredive;
 - Veprimet dhe masat e ndërmarra në kuadër të reagimit të organeve ligjzbatuese duhet të ndërthuren edhe me mundësinë e programeve rehabilituese apo de-radikalizuese fetare në bashkëpunim me komunitetet fetare dhe shoqërinë civile. Në hetimet proaktive ndaj rasteve të nxitjes së radikalizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm duhet të përfshihen elementë që ofrojnë mundësi për të kuptuar fenomenin nga këndvështrimi fetar si edhe në drejtim të funksionimit të grupeve të tilla dhe ndarjen e roleve mes personave nxitës, ndihmues, mbështetës, të manipuluar, etj.
 - Përdorimi i dhunës, përndjekja dhe keqtrajtimi i qytetarëve nga organet e zbatimit të ligjit provokon ndjenja hakmarrje ndaj tyre dhe lehtëson mundësinë e mbështetjes së grupeve të ekstremizmit të dhunshëm. Prandaj është e nevojshme që personeli i këtyre agjencive ligjzbatuese të marrin trajnimin e nevojshëm për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe parandalimin e situatave të tilla. Në të njëjtën kohë, përmes programeve edukuese civile duhen informuar qytetarët mbi të drejtat e tyre si dhe të promovohet policimi në komunitet;
 - Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si edhe agjencitë e tyre në nivel rajonal dhe vendor në bashkëpunim me

pushtetin vendor, komunitetet fetare, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë (sektori privat, media, etj.) duhet të përfshijnë në fokusin e punës së tyre trajtimin e radikalizmit fetar dhe të ekstremizmit të dhunshëm. Përveç veprimtarisë së Inspektoratit Shtetëror të Arsimit si një mekanizëm monitorues dhe kontrolli i cilësisë, MAS duhet të nxisë përmes kurrikulave mësimore

të menduarit kritik në arsimin fillor dhe të mesëm si edhe të trajnojë mësuesit rreth këtij fenomeni. Bashkëpunimi duhet të shtrihet edhe në programet e rikualifikimit dhe trajnimit që bashkërendohen nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit duke ndërmarrë po ashtu nisma ndërgjegjësuere kundër diskriminimit dhe parandaluese të radikalizimit tek të rinjtë.

8.2. INSTITUCIONET FETARE

Komuniteti Mysliman Shqiptar ka përgjegjësinë për të identifikuar, kundërshtuar përmes argumenteve teologjike dhe raportuar tek autoritetet shtetërore qendra me ideologji radikale islamike të cilat nxisin ekstremizmin e dhunshëm me baza fetare. Bashkëpunimi me Komitetin Shtetëror të Kulteve dhe institucione të tjera veçanërisht në nivel vendor do të forcojë ndikimin tek komuniteti i besimtarëve. Rekomandime të tjera dhe masa konkrete për KMSH, rekomandime që mund të shërbejnë edhe për komunitetet e tjera fetare në vend, përfshijnë:

- Për kundërshtimin e ideologjive dhe perceptimeve të sulmeve të vendeve perëndimore ndaj Islamit dhe myslimanëve, KMSH duhet të nxisë zhvillimin e një debati të informuar dhe larmishëm rreth shoqërive myslimane në botën moderne. Gjithashtu, duhen mbështetur zërat në komunitet të cilët refuzojnë "narrativën viktimizuese" të përdorura

nga grupet radikale fetare. Të ofrohet më shumë informacion dhe të trajtohen ngjarje që mund të provokojnë perceptime të mungesës së respektit dhe fyerje ndaj Islamit. Në bashkëpunim me organizata jo-fitimprurëse dhe median të shpërndajë informacion rreth "historive të suksesit" të besimtarëve myslimanë brenda vendit apo në vendet perëndimore.

- Të merren masa për konsolidimin e nivelit dhe formimit teologjik të imamëve, veçanërisht atyre në zona të largëta rurale. Gjithashtu, imamët të trajnohen rreth fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, argumenteve teologjike kundërshtuese dhe të udhëzohen që ata t'i trajtojnë këto çështje me besimtarët. Fuqizimi i Këshillit të Teologëve dhe nxitja e koordinuar e veprimtarisë së tij me imamët

do të përmirësojë ndjeshëm bazat dhe njohurive fetare të besimtarëve;

- Të intensifikohen përpjekjet për gjithëpërfshirje dhe sheshim të divergjencave brenda KMSH-së mes strukturave drejtuese në qendër dhe imamëve në nivel vendor. Përthithja e kapaciteteve cilësore dhe fuqizimi i strukturave të ndryshme të KMSH-së që

punojnë me të rinjtë, gratë, çështje të formimit fetar, etj., duhet të forcojnë më tej komunitetin dhe të orientohen nga besimtari. KMSH duhet të vazhdojë përpjekjet e nisura nën përfaqshjen e përfshirjes për trajtimin e rasteve të xhamive ilegale, si alternativë ndaj izolimit të tyre apo konfrontimit. Është thelbësore që këto përpjekje të mbështeten nga aktorë të tjerë të shoqërisë.

8.3. SHOQËRIA CIVILE

Shoqëria civile ka qenë deri tani pothuaj inekzistente në inkurajimin apo edhe zhvillimin e një debati të informuar mbi tendencat radikalizuese fetare, islamofobinë dhe zhvillimet e tjera fetare në vend. Përgjithësisht, trajtimet publike të këtij fenomeni kanë qenë sipërfaqësore dhe kanë lënë jashtë aspekte shumë të rëndësishme të parandalimit të tij. Mungesa e organizatave të shoqërisë civile në zona të largëta rurale krijon një handikap të theksuar në trajtimin e këtij fenomeni dhe çështjeve të tjera sociale në këto komunitete.

Propozimet e këtij studimi për rolin e shoqërisë civile në drejtim të ndërgjegjësimin dhe parandalimit të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm duhen vlerësuar edhe nga aktorë të tjerë, të cilët bashkëpunojnë ose mbështesin veprimtarinë e shoqërisë civile, si p.sh. institucione shtetërore, media, donatorët, sektori privat etj.

- Zbutja e perceptimeve dhe efekteve të përjashtimit shoqëror dhe marginalizimit, sidomos

midis të rinjve në kërkim të punësimit, mund të realizohet përmes nismave të shoqërisë civile me fokus tek rinia, gratë dhe komuniteteve të cënueshme nga fenomeni duke u dhënë zë shqetësimeve të tyre dhe duke nxitur trajtimin e sfidave me të cilat përballen. Programe për nxitjen e punësimit, barazinë gjinore, ndërgjegjësimi kundër diskriminimit, vullnetarizmin, mbrojtjen e çështjeve me interes për të rinjtë, pjesëmarrja dhe aktivizmi qytetar, përfshirja në politikë-bërje dhe nxitja e forumeve të diskutimit mbi fenë, shoqërinë, shtetin dhe vlerave demokratike përbëjnë disa prej nismave të tilla që kërkojnë përfshirje të komuniteteve fetare dhe veprim konkret nga aktorët shtetërorë;

- Organizatat jo-fitimprurëse duhet të zhvillojnë dhe shtrijnë projektet e tyre me karakter social (p.sh. kurse profesionale dhe aftësimi) në zona të

pazhvilluara rurale si edhe në zonat periferike të qendrave urbane si një alternativë për individë dhe familje, të cilat kanë vështirësi ose nuk arrijnë të përmbushin nevojat e tyre bazë. Për adresimin e shqetësimeve që lidhen me mohimin e të drejtave politike, aktorët e shoqërisë civile duhet të angazhohen në përfaqësimin e interesave dhe trajtimin e sfidave të komuniteteve të cënueshme. Monitorimi i vazhdueshëm në bashkëpunim me median nuk duhet të kufizohet vetëm tek evidentimi i rasteve të abuzimit, por duhet të përfshijë edhe angazhimin për të ushtruar trysni tek institucionet shtetërore për trajtimin dhe parandalimin e tyre;

- Shoqëria civile duhet të kontribuojë për kundërshtimin e ideologjive dhe agjendave 'proaktive' të grupeve radikale

fetare përmes krijimit të forumeve në të cilat marrin pjesë aktive opinion-bërës, drejtues fetarë dhe teologë. Mesazhet e tyre kundër ideologjive radikale duhen shpërndarë më tej përmes rrjeteve sociale, radios, kanaleve televizive, dhe programeve nëpër shkolla. Po ashtu, shoqëria civile duhet të nxitë informimin e publikut mbi proceset radikalizuese fetare, shkaqet dhe pasojat e tyre. Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, është nxitja e studimeve, mbështetja e hulumtimeve dhe monitorimit të vazhdueshëm për të siguruar një bazë të përditësuar të dhënash për fenomenin dhe tendencat e tij çka do t'u shërbejë politikëbërësve për hartimin e politikave përkatëse, komuniteteve fetare dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë.

8.4. PROGRAMET E "MONITORIMIT TË TENSIONIT" DHE EKIPET MULTI-DISCIPLINARE

Radikalizimi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm janë dukuri komplekse dhe shumë-dimensionale dhe si të tilla kërkojnë një reagim shumë-disiplinor. Ashtu siç nuk ka një teori apo shpjegim të vetëm për arsyet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, njësoj nuk mund të ketë një zgjidhje apo aktor përgjegjës të vetëm për të penguar fenomenin në gjithë

kompleksitetin e tij. Zbatimi rigoroz dhe efikas i programeve parandaluese të radikalizimit kërkon bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës midis aktorëve përgjegjës, ku përfshihen institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, drejtues zyrtarë të komuniteteve fetare, teologë dhe klerikë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Ky studim rekomandon hartimin e programeve të "monitorimit të tensionit" si një alternativë parandalimi që duhet të përfshijnë promovimin e vlerave të përbashkëta, kundërshtimin e ideologjive ekstremiste, ndërtimin e kapaciteteve civile dhe drejtuese në komunitetet fetare dhe ato të marginalizuara si dhe forcimin e rolit të institucioneve brenda këtyre komuniteteve. Gjithashtu, programet e "monitorimit të tensionit" duhet të synojnë nxitjen e mendimit kritik për sfidimin e ideologjive radikale dhe mbështetëse të ekstremizmit të dhunshëm. Zbatimi i tyre duhet të kryhet nga skuadra multi-disiplinare duke u shtrirë sa më gjerë në komunitetet vendore dhe mjedise të tjera si shkollat, shërbimet sociale apo institucionet e riedukimit. Njëkohësisht, nevojitet që të promovohen zëra të moderuar dhe shembuj të suksesshëm nga komunitetet fetare ku skuadrat multi-disiplinare, sidomos klerikët fetarë, duhet të ofrojnë argumentet e duhura që kundërshtojnë në mënyrë të besueshme pretendimet e rekrutuesve radikalë dhe ekstremistë.

Një vëmendje e veçantë u duhet kushtuar programeve më specifike, të cilat synojnë parandalimin e radikalizmit dhe de-radikalizmin në nivel individual. Identifikimi i individëve të rrezikuar nga radikalizmi apo përfshirja në ekstremizëm të dhunshëm është një çështje që kërkon informacionin dhe përgatitjen e duhur të personave që kanë mundësitë të zbulojnë elementë të caktuar të prirjeve apo bindjeve radikale dhe ekstreme tek të afërmit e tyre, nxënësit apo përfituesit e shërbimeve të tjera sociale dhe ekonomike. Aktorët e ashtuquajtur të linjës së parë, si, p.sh., të afërmit, mësuesit, punonjësit socialë, duhet të jenë në gjendje të kuptojnë rrezikun që vjen prej radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe faktorët

që favorizojnë kushtet e shfaqjes së tyre. Programet me individët e rrezikuar nga radikalizmi apo të radikalizuar duhet të përfshijnë forma të ndryshme mentorimi dhe mbështetjeje, si ofrimi i hapësirave të sigurta, këshillimi psikologjik si dhe nxitja e individëve drejt mendimit kritik dhe të pavarur, dhe angazhimit të tyre pozitiv. Është e rëndësishme që këta individë të vetë-reflektojnë dhe të zhvillojnë mendim kritik ndaj ideologjive ekstreme që mund t'i tërheqin. Kontestimi i historive dhe propagandës radikale fetare duhet të mbështetet përmes zërave të besueshëm dhe kompetentë nga pikëpamja fetare. Hartimi i programeve të tilla duhet bërë sipas një vlerësimi të nevojave specifike duke garantuar liritë dhe të drejtat themelore, në veçanti konfidencialitetin e të dhënave personale.

9



SHTOJCA

9.1. ISLAMI I KEQINTERPRETUAR – SI FUNKSIONON MANIPULIMI NË FE?

Ermir Gjinishi, Teolog

Çdo gjurmë e historisë së njerëzimit flet për marrëdhënien e tij me hyjnoren. Pavarësisht formës, hyjnorja e ka shoqëruar gjithnjë njeriun gjatë të gjitha etapave kohore që nga ekzistenca e tij. Edhe manipulimi i hyjnores është po aq i vjetër. Ai është një proces, produkt i marrëdhënies së deformuar që krijon njeriu me besimin. Gjithsesi, pavarësisht kohës dhe formës në të cilën shfaqet, manipulimi në fe vjen si rezultat i keqinterpretimit apo keqkuptimit. I qëllimshëm ose jo, ai ka një ndikim thelbësor në formimin e personalitetit dhe sjelljes së individit (besimtar). I shtrirë në kohë dhe i përhapur kudo ky fenomen bëhet shqetësues për shkak të ndikimit negativ të brendshëm që krijon tek vetë individi besimtar, i cili fillon më pas të shfaqet dukshëm në sjelljet dhe marrëdhëniet e tij me të tjerët, fillimisht me besimtarët, në familje, pastaj me komunitetin përreth e kudo.

Pavarësisht rezultatit të njëjtë që krijon manipulimi në fe, radikalizëm apo ekstremizëm qoftë, ka rrethana dhe kushte të ndryshme që e nxisin shfaqjen e tij. Ato mund të jenë politike, sociale, fetare, kulturore etj., në varësi të lokalitetit apo vendit, por përgjithësisht qëllimi është dukshëm i njëjtë. Angazhimi nga protagonistët për ta kamufluar fenomenin si një zhvillim të brendshëm teologjik që synon ruajtjen e fesë nga devijimet dhe kthimin e saj në origjinë është i dështuar. Përgjatë gjithë historisë këto zhvillime kanë pasur qëllime politike, fronin e pushtetit.²¹⁸ Në Shqipëri fenomeni është pjesërisht i lindur dhe pjesërisht i huazuar. Është i lindur (radikalizmi) nga ligjërimet fetare dhe i huazuar (ekstremizmi) nga doktrina e eksperiencës fetare të

ndryshme jashtë vendit, por gjithsesi mbetet i lokalizuar.

Manipulimi në fe fillon me radikalizëm dhe nëse nuk trajtohet në kohën e duhur degjeneron në ekstremizëm të dhunshëm. Ai është një proces, i cili inicion krijimin e mendësive, grupeve, ndjekësve, simpatizantëve të tij. Nëpërmjet keqinterpretimit fetar të çështjeve që lidhen me besimin (akiden) keqpërdor argumentet teologjike (nga Kurani dhe tradita profetike), deformon klasifikimin dhe standardet e tyre (në legjislacion, fikh), krijon ose huazon kauza dhe ofron zgjidhje duke fajësuar besimtarët për mosveprim. Ai formësohet dalëngadalë duke nxitur qëndrime të skajshme të ekzagjeruara drejt ekstremitetit.

Manipulimi në çështjet e besimit çon në mënyrë të patjetërsueshme në krijim doktrinash. Këto doktrina shfrytëzojnë rrethana të caktuara dhe përcillen në formë kauze tek besimtarët, të cilët në shumicën e rasteve janë pjesa më e keqpërdorur. Një komunitet besimtarësh i indoktrinuar përdoret lehtësisht në kauza të manipuluar. Kjo është trajektorja e manipulimit dhe rezultatja që sjell ai si proces:

Manipulim / Doktrinë / Kauzë

Indoktrinim / Veprim / Lëvizje

Në të gjitha rastet fenomeni ka prodhuar dhunë, terror e konflikt të armatosur. Aktualisht vihet re një stad i ri i ekstremizmit fetar me dy tipare kryesore, modelin dhe shtrirjen:

- 1- **Si model** po transformohet nga "kauzë / burime njerëzore / organizata rekrutimi / financim", në "doktrinë / indoktrinim / iniciativë personale".
- 2- **Si shtrirje** nga "lokal / kombëtar" në "rajonal / ndërkombëtar".

Ky transformim është rezultat i ndryshimit të referencës, nga kauzë në doktrinë.

Çfarë mësimesh fetare përdoren për manipulimin dhe radikalizimin e besimtarëve?

Besimi islam mbështetet në dy burime: Kurani dhe tradita profetike. Për nga tematika këto ndahen në tre pjesë: ritet (adhurimi), rregullat (sheriati) dhe mënyra e implementimit të tyre. Të gjitha rregullat fetare janë të sanksionuara dhe të sqaruara imtësisht nga dijetarët ekspertë. Janë katër shkolla juridike që përmbledhin tërë rregullat dhe ligjet e besimit, terminologjinë, metodologjinë dhe parimet e përdorura në standardizimin dhe klasifikimin e tyre. I gjithë legjislati islam (sheriati) ka pesë qëllime.

- 1- mbrojtja e jetës
- 2- mbrojtja e fesë
- 3- mbrojtja e mendjes
- 4- mbrojtja e pronës
- 5- mbrojtja e nderit

Çdo doktrinë apo veprim në emër të fesë që bie ndesh qoftë me njërin prej këtyre pesë qëllimeve kategorizohet si jo islame.

Radikalizmi, ekstremizmi dhe tekfirizmi, janë qëndrime jashtë këtij përcaktimi. Ato përdorin metodologji të papranuar,

jashtë standardit në klasifikimin e nocioneve e statuseve, për të justifikuar qëllimet e tyre. Si të tilla ato shfaqen si doktrina dhe rryma më vete. Manipulimi fillon me terminologjinë, vazhdon me klasifikimin, më pas me legjitimitetin (e lejuar apo e ndaluar) dhe përfundon me gjykimin.

Ekstremizmi si përkufizim teologjik do të thotë: kapërcim i kufirit. Ekstremizmi në fe është i ndaluar, pa marrë parasysh identitetin dhe besimin ku shfaqet. Ndalesa përcaktohet me tekst të qartë: "O ithtarët e librit (të krishterë dhe hebrenj), mos teproni në fenë tuaj."²¹⁹ Kjo ndalesë, drejtuar ndjekësve të Librit (të krishterëve dhe hebrenjve), vlerësohet e tillë edhe për myslimanët mbështetur në përcaktimin profetik: "Ruajuni nga ekstremizmi në fe, sepse ata që ishin para jush i shkatërroi ekstremizmi në fe."²²⁰

Dy janë arsyet e formimit të ekstremizmit si mendësi:

- 1- moskuptimi i qëllimit të vargjeve në tekstet e shenjta, refuzimi i kontekstit dhe mungesa e referencës shkencore teologjike.
- 2- tekfirizmi dhe lejimi i vrasjes së pajustificuar ligjrisht për të gjithë ata që nuk pranojnë doktrinën e tyre.

Tekfirizmi²²¹ si doktrinë është: të akuzuarit e ndjekësve të besimeve abrahamitë (myslimanë, krishterë, hebrenj) me apostazi²²² dhe detyrimin e vrasjes së tyre me vetëgjyqësi. Për sa i përket myslimanëve ata kategorizohen si të tillë kur nuk ndjekin doktrinën tekfiriste, ndërsa të krishterët dhe hebrenjtë për shkak të besimit të tyre.

Tekstet kuranore refuzojnë këtë kategorizim: "Me ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe vetëm se me të mirë".²²³ Islami u ndalon në mënyrë kategorike besimtarëve të tij përdorimin

e forcës, për të detyruar cilindo qoftë ai, për të pranuar ose praktikuar doktrinat islame apo për të përmbushur synime politike: "Nuk ka dhunë në fe..."²²⁴ Toleranca fetare nuk është çështje zgjedhjeje personale por detyrim fetar i përcaktuar në Kuran: " Ju keni fenë tuaj dhe unë timen".²²⁵ Refuzimi i kësaj marrëdhënie është mohim i tekstit kuranor. Praktika profetike ndalon në lëndimin e ithtarëve abrahamitë: "Kush lëndon ndonjë ithtar të librave të shenjtë (krishterë, hebre) ta dijë se më ka lënduar mua"²²⁶ Kurani vlerëson realitetin e ndryshimit dhe diversitetit brenda njerëzimit. Ai të jep përshtypjen se larmia është pjesë e planit hyjnor, duke pranuar kështu shumëllojshmërinë e ligjeve dhe bindjeve fetare siç mund të kuptohet qartë në këtë sentencë kuranore: "Për secilin prej jush, Ne caktoam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit). Sikur të donte Zoti, do t'ju bënte një popull (në fe dhe besim)."²²⁷

Feja islame ndalon çdo dhunim me bazë fetare. Nëse islami do të kishte legjitimuar vrasjen e jo-myslimanëve për shkak të besimit, atëherë si shpjegohet ekzistenca e jo-myslimanëve në vendet myslimane prej 1400 vitesh që nga fillimet e islamit. Komunitetet krishtere më të vjetrat në botë gjenden në vende arabe. Besimet abrahamite (të krishterë dhe hebrej) kanë status të veçantë të garantuar, ku u respektohet feja, objekti i kultit dhe ligjet e tyre kanonike.

XHIHADI

Një nga nocionet më të manipuluar nga lëvizjet tekfiriste është xhihad. Ajo që shohim sot në Siri dhe Irak është një terrorizëm i organizuar nga banda kriminale, që nuk ka asnjë lidhje me xhihadin, njëkohësisht rezultat i manipulimit në fe. Fakti i pjesëmarrjes

në këto formacione luftimesh të individëve nga vende të ndryshme të botës padyshim tregon hartën e përhapjes së manipulimit. Ja disa detaje të shkurtra për të kuptuar diferencën.

Në kuptimin gjuhësor dhe fetar .Xhihad-i ka kuptimin e përpjekjes, mundit.²²⁸ Nga e njëjta rrënjë rrjedh edhe termi "ixhtihad", që do të thotë: përpjekje intelektuale e dijetarëve islam për të mbërritur në një opinion ligjor fetar të vlefshëm rreth një problematike të re. Rëndom, termi "xhihad" përkthehet gabimisht si "luftë e shenjtë" (holy war). Ky përkthim është deformim i kuptimit të vërtetë të kësaj fjale dhe burim keqkuptimi. Në islam nuk glorifikohet xhihadi si i shenjtë. Për më tepër ai praktikohet në kushtet e vetëmbrojtjes dhe nuk ka kuptimin e një lufte në interes të një feje kundrejt një tjetre. Si i tillë ai është zgjidhje e detyrueshme e imponuar në kushte ekstreme kur nuk ka asnjë mundësi tjetër zgjidhjeje. Për këtë arsye është cilësuar në Kuran: "ju nuk e pëlqeni atë" (xhihadin).²²⁹

Në Kuran janë pak vargje, të cilat lejojnë pjesëmarrjen në një luftë me armë, dhe të gjitha ato kanë një natyrë tepër të përcaktuar: cenim i sovranitetit, vetëmbrojtje nga agresioni territorial dhe persekutimi i qartë që synon mohimin e besimit. Në kushtet e një konturi ligjor ndërkombëtar, ku e drejta e fesë është sanksionuar në konventa, kornizën e të drejtave të njeriut, dhe kushtetutave të shteteve, ka rënë xhihad për shkak të mohimit të së drejtës së besimit dhe të ndalimit të praktikimit të fesë.

Xhihad nuk kushtëzohet vetëm me arsyet që e justifikojnë atë, por edhe me vetë mënyrën se si duhet të zhvillohet, sepse sipas islamit "qëllimi nuk e justifikon mjetin". Rregullat janë të forta, të vendosura prerazi. Lufta nuk duhet të nisë për sa kohë mjetet e

tjera paqësore për të ndalur agresionin dhe persekutimin nuk janë ezauruar. Shpallja e tij nuk bëhet nga individë, cilëtdo qofshin, por nga autoriteti ligjor shtetëror, pas konsultimeve të nevojshme. Autoriteti ligjor janë qeveritë dhe drejtohet kundrejt shteteve dhe jo individëve. Lufta duhet të zhvillohet nën flamurin e një shteti mysliman, të ligjshëm, dhe jo nën flamurin e një njeriu që ka shpallur veten si të tillë. Lufta bëhet vetëm midis strukturave ushtarake, nuk cenohen të tjerë veç pjesëmarrësve në ushtrinë agresore, të cilët dallohen që nga uniforma. Përballja me forcë duhet të jetë vetëm me ushtrinë armike dhe në betejën e luftës. Nuk preken civilë, kisha, sinagoga, prona, pasuritë. Ndalohen plaçkitjet dhe shkatërrimet. Robërit dhe të plagosurit nuk ekzekutohen por trajtohen njerëzishëm sipas statusit përkatës. Nuk lejohet përdorimi i mjeteve të tilla të dhunshme, si shpërthimet, rrëmbimet e njerëzve dhe avionëve, shantazhet ose çdo formë tjetër dhune të paligjshme, që përdoret si mjet për realizimin e synimeve fetare ose politike. Nuk lejohet pjesëmarrja e luftëtarëve nga jashtë pa u ftuar nga popullata vendase, në kushtet e pamundësisë së përballjes.

“NJERIU BOMBË” – kamikazi (të cilin e shpallin “martir” – shehid)

Edhe ky është një deformim tipik i nocionit. Në asnjë rrethanë vetëvrasja apo vetëgjyqësia ndaj të tjerëve nuk kategorizohet si martirizim. Vrasja e vetes është e ndaluar (haram), një nga mëkatet e pafalshme. Vrasja e të pafajshmëve dhe me vetëgjyqësi është njëkohësisht e pafalshme. Kurani është i qartë në këto ndalesa kur thotë: “Ai që vret padrejtësisht një njeri, është si të ketë vrrarë gjithë njerëzimin dhe kush fal një jetë është si t’i ketë dhënë jetë gjithë njerëzimit”.

HIZBIZMI, PARTISHMËRIA – pasimi symbyllazi i disa hoxhallarëve (imamëve) dhe akuzimi i të tjerëve me kufër

Për shkak të ekstremitetit në kuptimin dhe praktikimin e fesë ndjekësit e këtyre doktrinave nuk gëzojnë mirëkuptimin dhe mbështetjen e dijetarëve dhe mendimtarëve myslimanë. Ata kanë qenë në qendër të kritikave teologjike të mirëfillta nga teologët. Ka një standard kuranor (“shura”²³⁰) në raste divergjencash mbi kuptimin e teksteve të shenjta. Diskutimi, dialogu, debati shkencor, janë instrumentet që legjitimon feja në rast mosdakordësie.

Pamundësia e doktrinarëve për t’iu përmbajtur standardit kuranor i çon në ekstremitet brenda llojit – shpalljen e kritikëve ndaj tyre si hipokritë, njerëz që kanë tradhtuar idealin fetar. Si pasojë e këtij qëndrimi, ata shpesh u predikojnë besimtarëve tituj librash, emra teologësh, imamësh, dijetarësh, të cilët duhet t’i braktisin. Margjinalizimi i besimtarëve, ‘shpëlarja e trurit’, janë e vetmja rrugë e tyre për të garantuar pasues, të cilët i ndjekin verbërisht. Ndjekësit e këtyre doktrinave janë refuzues kundrejt besimtarëve që mendojnë ndryshe nga ata, jo për shkak të argumentit fetar, por se kështu e kanë të lehtë të mbjellin mendimet e tyre tek njerëz që u mungon dimensionin i njohjes dhe u është bërë e ndaluar hulumtimi në burime të tjera bazike. Sigurisht, të paaftë të përballen me mendimin real fetar ideologët e tyre synojnë superioritetin ndaj të tjerëve duke vetë-sajuar e vetëshpallur tituj të pamerituar si mendimtarë, princa fetar, deri në kalif.

PJESËMARRJA NË VOTIME

Tendenca e pa justifikuar fetarisht për refuzimin e pjesëmarrjes

së besimtarëve në jetën sociale institucionale e kulturore të përditshme, marginalizimi, shkëputja dhe izolimi i tyre nga shoqëria, kulmon me refuzimin e sistemit politik dhe instrumenteve qeverisëse. Ndalimi i pjesëmarrjes në votime me arsyetimin se qeveriset jo me ligjet e Allahut është një keqinterpretim i fesë.

Ky qëndrim është parantezë dhe trampolinë për t'u hedhur në një koncept tjetër të manipuluar në të cilin shfaqet hapur qëllimi politik: Kryengritja ndaj pushtetit sipas tyre është (vaxhib) obligim. Ky është qëndrim i refuzuar nga të gjithë dijetarët. Individit besimtar, përveç detyrimeve fetare ka kërkesa jetësore të njëjta me pjesën tjetër të shoqërisë, kështu që përzgjedhja e programeve partiake të favorshme është kontribut i drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Një nga emrat e njohur të dijetarëve islam, ish myftiu i Arabisë Saudite shejh Abdul Aziz Ibn Baz në një fetfa²³¹ është pyetur: A është detyrim i thirrësve (imamëve e teologëve) në rrugën e Allahut në një shoqëri myslimane ku nuk zbatohen dispozitat e sheriatit ndryshimi i qeverisjes me forcë?


Ai është përgjigjur: "Obligim është të thirret në fe, me këshillë dhe udhëzim në të mirë, duke mos tentuar për të bërë ndryshim me dhunë, sepse kjo hap derën e të keqes para myslimanëve, thërret në fenë e Allahut me urtësi, me fjalë të mira, këshilla të mira, në mënyrën më të mirë, i këshillon pushtetmbajtësit, i këshillon edhe zyrtarët e tjerë, këshillon masën e gjerë dhe i udhëzon kah e mira."

Të gjitha qëndrimet e manipuluar kanë qëllim diferencimin, shpalljen jobesimtarë të gjithë atyre që refuzojnë këto doktrina, klasifikimin si fe-mohues dhe gjykimin e dënimit të tyre me vrasje.

Realiteti i sotshëm sirian është pasqyra e vërtetë e ekstremizmit që ka përfshirë njerëz të indoktrinuar nga vende të tjera. Ai është argument praktik i doktrinës së tyre, në të njëjtën kohë dhe vizioni se si e perceptojnë botën të gjithë ata që kanë këtë doktrinë në mendje kudo qofshin në vendet e tyre. Për këtë arsye, këto doktrina e rryma janë klasifikuar nga të gjithë dijetarët si të dalë prej feje që nuk i përkasin bashkësisë fetare myslimane.

Përrjashtimi i tjetrit ndryshe nga ç'je vetë është mohim i diversitetit hyjnor, natyror dhe thelbësor i vetë ekzistencës. Ky diversitet që përfshin kulturat, qytetërimet, besimet, shoqëritë, është i trashëgueshëm dhe jo një risi. Është natyrshmëria e ekzistencës, prandaj respekti është dimension i shpirtëror i tij. Dhe pikërisht këtë mesazh përcjell dhe vargu kuranor: "Bashkëpunoni mbi bazën e respektit reciprok dhe devotshmërisë".

9.2. PROFILI SOCIAL-EKONOMIK DHE DEMOGRAFIA E ZONAVE TË PROJEKTIT



Për të mbërritur në një shkallë të thelluar të kuptimit të radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm ky hulumtim ka prioritetuar jo vetëm grupet e synuara (shih Metodologjinë), por gjithashtu edhe fokusin gjeografik, duke identifikuar zona specifike brenda qarqeve të cilat shfaqen si veçanërisht vulnerable ndaj ekstremizmit të dhunshëm me baza fetare. Ndërkohë që fokusi fillestar i studimit përfshinte zonat rurale dhe periferike të katër qarqeve, faza fillestare e hulumtimit sugjeroi zgjerimin e këtij fokusi duke përfshirë edhe zonat urbane. Arsyeja për këtë ishte fakti se ekspozimi i komunitetit të besimtarëve ndaj radikalizimit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe dinamikat e grupit nuk janë të izoluara në zonat rurale. Rrjedhimisht, tetë zona specifike – njësi të qeverisjes vendore²³² – u identifikuan brenda qarqeve si vijon – komuna Buçimas dhe bashkia Pogradec (qarku Korçë); bashkitë Përrenjas, Librazhd dhe Cërrik, dhe komuna Qendër-Librazhd (qarku Elbasan); bashkia Bulqizë (qarku Dibër); dhe Bashkia Kukës (qarku Kukës).²³³

Seksionet e mëposhtme elaborojnë variablat dhe indikatorë kryesorë nëpërmjet prezantimit të profilit socio-ekonomik të secilës zonë dhe një analizë krahasimore lidhur me dallimet dhe të përbashkëtat e tyre.

9.2.1. BASHKIA POGRADEC


Tabela 1 . Të dhëna përmblledhëse për bashkinë Pogradec

Qarku	Korçë
Rrethi	Pogradec
Dendësia (banorë/km ²)	8615.82
Popullsia banuese	20,848
Meshkuj	10,425
Femra	10,423
Koeficienti i përgjithshëm i varësisë (%)	44
Analfabetizmi (%)	1.7
Papunësia (%)	35.40
Papunësia të rinjtë (%)	65.40

Burimi: Censusi i popullsisë dhe banesave (2011)

Fig.1 Përbërja moshore (në %)

■ 0-14 vjeç □ 15-64 vjeç ■ 65+ vjeç




Burimi: Censusi (2011)

DEMOGRAFIA

Në bashkinë Pogradec jetojnë 20,848 banorë ose 9.5% e popullsisë së përgjithshme të qarkut Korçë. Pogradeci është qyteti i dytë më i populluar në qark pas Korçës. Të dhënat tregojnë se gjatë dekadës së fundit, situata demografike në Pogradec ka reflektuar të njëjtën prirje të përgjithshme të tkurrjes së popullsisë të vëzhguar në shkallë kombëtare (Census, 2011). Në 2011, popullsia banuese ka përjetuar një rënie prej 12.26% krahasuar me 2001. Kjo rënie, megjithatë, rezulton të jetë nën nivelin e tkurrjes së popullsisë në rang qarku (17%). Ndërkohë, dendësia mesatare është 8615.82 banorë për km², një shifër shumë më e lartë se niveli kombëtar prej 97.4 banorë për km².

Në tërësi, përbërja gjinore në Pogradec është e balancuar, ku rreth 50% e banorëve janë meshkuj dhe 50% femra. Struktura moshore përbëhet nga 18.80% fëmijë, 69% të popullsisë në moshë pune (15-64 vjeç) dhe 11.98% të moshuar. Kjo shpërndarje moshore

Fig.2 Niveli arsimor i arritur (në %)



Burimi: *Censusi (2011)*

pasqyron parametrat kombëtarë. Koefficienti i përgjithshëm i varësisë²³⁴ është 44% ku peshën më të madhe relative e zë koefficienti i varësisë për të rinjtë. Kësisoj, për çdo 100 banorë potencialisht aktivë për punë në bashkinë Pogradec, ka 44 qytetarë jo në moshë pune. Të dhënat në lidhje me statusin martesor tregojnë se pjesa më e madhe e popullsisë ose 56% është e martuar; 38% është beqare, ndërsa 9% është e divorcuar. Nga pikëpamja etniko-kulturore²³⁵, pjesa dërrmuese ose 85.26% e banorëve janë shqiptarë. Ndërkohë, minoriteti grek është më i madhi me rreth 0.87%, ndjekur nga arumunët (0.30%) dhe maqedonasit (0.20%). Komuniteti rom dhe egjiptian përbën 0.95% të popullsisë.

KARAKTERISTIKAT SOCIO-EKONOMIKE


Banorët e Pogradecit, mesatarisht, kanë një nivel më të lartë arsimor se norma e qarkut Korçë dhe norma kombëtare e arsimimit. Për një banor në Pogradec, vitet mesatare të shkollimit janë 11.24. Ndërkaq, struktura arsimore e popullsisë tregon që pjesa më e madhe e banorëve që kanë përfunduar studimet (rreth 61%), kanë përfunduar së paku arsimin e mesëm. Gjithashtu, rreth 18% e popullsisë së përgjithshme është me arsim të lartë

(një shifër kjo 6 pikë përqindje më e lartë se vlera kombëtare). Vetëm 1.7% e popullsisë mund të konsiderohen analfabete (Census, 2011). Në Pogradec, ka 6 shkolla 9-vjeçare dhe 3 shkolla të mesme, në të cilat japin mësim 167 dhe 97 mësues, përkatësisht (Ministria e Arsimit dhe Sportit, 2015).

Në total, në Pogradec ka 6,042 familje me një madhësi mesatare të familjes prej 3.45 individësh. 21% e familjeve drejtohen nga gratë. Sipas Censurit 2011, burimi kryesor i të ardhurave për familjet është puna e paguar ose vetëpunësimi (në 53.39% të rasteve) dhe pensionet (në 35.36% të rasteve). Nga pikëpamja e besimit fetar,²³⁶ pjesa më e madhe ose 56% e popullsisë i përket besimit mysliman, 20% atij ortodoks, 1.40% atij katolik dhe 1.10% besimit bektashi.

Ekonomia e qytetit të Pogradecit mbështetet kryesisht në tregti dhe shërbime, sektorë që për rrjedhojë punësojnë edhe numrin më të madh të banorëve. Pjesa dërrmuese e të punësuarve (ose rreth 80%) është përqendruar në sektorin e shërbimeve. Ndërkohë, pesha e punësimit në sektorin e industrisë dhe bujqësisë është përfaqësuesisht 18% dhe 2%, respektivisht. Në total, 64% e të punësuarve janë të punësuar me pagë, ndërsa 36% janë

Fig.3 Punësimi sipas degëve të ekonomisë (në %)



Burimi: Censusi (2011)

të vetëpunësuar. Analiza e shkallës së punësimit sipas gjinisë tregon se punësimi është më i lartë tek meshkujt (rreth 43%), krahasuar me femrat (rreth 30%). Megjithatë, në perspektivë punësimi i femrave paraqitet pak më i lartë sesa shkalla kombëtare (25.5%). Si reflektim i nivelit arsimor të popullsisë, 49% e të punësuarve janë me arsim të mesëm dhe 35% me arsim universitar. Në 2011, popullsia në moshë pune në bashkinë Pogradec ishte 14,440 banorë. Ndërkohë, Censusi zbuloi se norma e papunësisë ishte 35.40% dhe se papunësia shfaqej veçanërisht problematike për moshat e reja; 65.40% e të rinjve në Pogradec u deklaruan të papunë. Vlerat e këtyre indikatorëve janë më të larta se vlerat përkatëse kombëtare prej 29.3% dhe 52.90%.

9.2.2. KOMUNA BUÇIMAS


Tabela 2. Të dhëna përmblledhëse për komunën Buçimas

Qarku	Korçë
Rrethi	Pogradec
Dendësia (banorë/km ²)	328.63
Popullsia banuese	15,687
Meshkuj	8,033
Femra	7,654
Koeficienti i përgjithshëm i varësisë (%)	48.68
Analfabetizmi (%)	3
Papunësia (%)	54.70
Papunësia të rinjtë (%)	78.80

Burimi: Censusi i popullsisë dhe banesave (2011)

Fig.4 Përbërja moshore (në %)

■ 0-14 vjeç □ 15-64 vjeç ■ 65+ vjeç




Burimi: Censusi (2011)

DEMOGRAFIA

Komuna Buçimas është komuna më e madhe në qarkun e Korçës me një popullsi prej 15,687 banorësh. Nga pikëpamja demografike, ndërkohë që popullsia në Shqipëri dhe në njësitë e tjera vendore në rang qarku ka pësuar rënie sipas Censurit të vitit 2011, një trend rritës mund të ravijëzohet përgjatë gjithë periudhës ndërmjet viteve 1989-2011 për Buçimasin. Popullsia banuese është rritur me 34.58% nga 1989 në 2011. Nga 2001 në 2011 popullsia është rritur me 17.75%, edhe pse mund të vëzhgohet një tendencë e ulët zbritjeje krahasuar me 2001. Dendësia mesatare prej 328.63 banorë për km² është gjithaq më e lartë se niveli kombëtar prej 97.4 banorë për km².

Për sa lidhet me shpërndarjen gjinore, 51.2 % e banorëve janë meshkuj dhe 48.7% femra. Përgjithësisht, struktura moshore e popullsisë në Buçimas paraqet të njëjtat tipare të shpërndarjes kombëtare, por vihet re

Fig.5 Niveli arsimor i arritur (në %)



Burimi: Censusi (2011)

një përqindje më e madhe e moshave të reja: 23% e popullsisë janë fëmijë, 67% është potencialisht forcë punëtore (grupmosha 15-64 vjeç) dhe 11% janë të moshuar. Raporti i varësisë totale ndaj grupmoshës që përbën forcën aktive potenciale për punë është 0.49 ose 49%. Kështu, për çdo dy banorë potencialisht ekonomikisht aktivë në Buçimas, 1 banor nuk është në moshë pune. Ndërkohë, në lidhje me statusin martesor, 54% e banorëve janë të martuar, ndërsa 40% janë beqarë. Po kështu numri i divorceve është mjaft i ulët krahasuar me shkallën kombëtare; vetëm 3% e banorëve janë të divorcuar. Në lidhje me kompozimin etnik të Buçimasit, vetë-deklarimi i përkatësisë etno-kulturore në 2011 tregoi se pjesa dërrmuese e popullsisë është shqiptare (86.67%). Në rend zbritës, pjesa tjetër përbërëse e popullsisë është: 0.47% egjiptianë, 0.13% arumunë dhe 0.07% grekë.

KARAKTERISTIKAT SOCIO-EKONOMIKE


Të dhënat mbi nivelin arsimor të arritur tregojnë se banorët e Buçimasit kanë, mesatarisht, një nivel të ulët arsimor. Pjesa më e madhe e popullsisë (ose rreth 59%) ka përfunduar vetëm arsimin bazë (fillor dhe 8/9 vjeçar); ndërkohë, pak

më shumë se një e treta ka përfunduar së paku arsimin e mesëm. Vetëm rreth 6% e banorëve ka mbaruar arsimin e lartë. 3% e popullsisë janë analfabetë, një normë kjo pak më e lartë se norma mesatare kombëtare e analfabetizimit (2.8%).

Në komunën Buçimas, ka në total 3,803 familje me një madhësi mesatare prej 4.12 individësh. Në aspektin gjinor, rreth 15% e kryefamiljarëve janë femra. Një standard i ulët jetese mund të ravijëzohet pasi puna e paguar ose vetëpunësimi janë burimi i të ardhurave për familjet vetëm në 49% të rasteve. Pensionet (në 28% të rasteve), ndihmat ekonomike (në 22% të rasteve) dhe remitancat (në 12% të rasteve) zënë një pjesë të rëndësishme si burim i të ardhurave familjare (Census, 2011). Në të njëjtën linjë, si tregues jo-monetarë të standardit të ulët të jetesës, vetëm 1 në 2 familje në Buçimas ka furnizim me ujë të rrjedhshëm brenda banesës. Ndërkohë, vetëm 8% e familjeve zotëron të paktën një kompjuter, nga ku rreth 3% ka akses në internet. Nga pikëpamja e besimit fetar, pjesa më e madhe ose 76.80% e popullsisë i përket besimit mysliman. Në rend zbritës, 2% identifikohen me besimin ortodoks, 0.60% me atë katolik dhe 0.20% me besimin bektashi.

Fig.6 Punësimi sipas degëve të ekonomisë (në %)

■ Bujqësi □ Industri ■ Shërbime



Burimi: Censusi (2011)

Popullsia në moshë pune në komunën Buçimas është 10,551 banorë. Megjithatë, një pjesë e madhe e fuqisë potenciale për punë mbetet ende e pashfrytëzuar. Rezultatet e Censurit (2011) tregojnë se më shumë se 1 në 2 banorë i Buçimasit është i papunë (me një shkallë papunësie 54.70%). Problem i papunësisë të rinjtë është më akut: 78.80% e të rinjve në moshën 15-30 vjeç janë të papunë. Ndërkohë, shkalla e punësimit anon veçanërisht nga meshkujt, ku vetëm 8.64% e femrave janë të punësuar, krahasuar me 27.1% të meshkujve. Rreth 37% e të punësuarve janë me arsimin bazë, ndërsa rreth 44% me arsim të mesëm. Përsa lidhet me aktivitetet ekonomike në Buçimas, pak më shumë se gjysma e të punësuarve është përqëndruar në sektorin e shërbimeve (rreth 53%). Ndërkaq, pesha tjetër e punësimit ndahet midis sektorit të industrisë dhe bujqësisë në 26% dhe 21%, përkatësisht. 54.50% e banorëve janë të punësuar me pagë, ndërsa 45.50% janë të vetëpunësuar.

9.2.3. BASHKIA LIBRAZH D


Tabela 3.Të dhëna përmblledhëse për bashkinë Librazhd

Qarku	Elbasan
Rrethi	Librazhd
Dendësia (banorë/km ²)	3777.87
Popullsia banuese	6,937
Meshkuj	3,445
Femra	3,492
Koeficienti i përgjithshëm i varësisë (%)	45
Analfabetizmi (%)	1.7
Papunësia (%)	32.20
Papunësia të rinjtë (%)	70

Burimi: Censusi i popullsisë dhe banesave (2011)

Fig.7 Përbërja moshore (në %)

0-14 vjeç 15-64 vjeç 65+ vjeç




Burimi: Censusi (2011)

DEMOGRAFIA

Popullsia e bashkisë Librazhd është 6,937 banorë. Të dhënat tregojnë se rritja e popullsisë me 38.24% – dukuri e cila është vëzhguar në periudhën midis viteve 1989 në 2011, kthehet në rënie me 3.87% nëse fokusojmë analizën në periudhën 2001 në 2011. Megjithatë, edhe pse mund të evidentohet një prirje tkurrjeje, nga pikëpamja demografike krahasuese, kjo rritje negative mbetet e vogël krahasuar me tkurrjen e popullsisë në rang qarku (18%) dhe rënien kombëtare të popullsisë (8.8%). Gjithashtu, qyteti i Librazhdit ka një dendësi popullsie më të lartë se mesatarja në shkallë vendi (3777.87).

Raporti gjinor është 98.7, ku 49.6% e popullsisë janë meshkuj dhe 50.3% femra. Ndërkaq, edhe pse shpërndarja moshore pasqyron parametrat kombëtarë, vëzhgohet një përqindje relative më e ulët për popullatën e moshuar: 23% e popullsisë janë fëmijë, 69% i përkasin grupmoshës aktive për

Fig.8 Niveli arsimor i arritur (në %)



Burimi: Censusi (2011)

punë (grupmosha 15 -64 vjeç) dhe rreth 8% janë të moshuar. Si rrjedhojë, koeficienti i përgjithshëm i varësisë është 45%, ku pjesën më të madhe specifike e zë koeficienti i varësisë për të rinjtë. Gjithashtu në parametra kombëtare, ndarja e popullsisë sipas statusit martesor tregon që pjesa më e madhe janë të martuar (52%), 42% janë beqarë, ndërsa 8% janë të divorcuar. Në Librazhd, nga pikëpamja etnike, 87.91% e popullatës është shqiptare. Në rend zbritës, 0.20% janë arumunë, 0.16% maqedonas, 0.12% janë grekë, dhe 0.03% i përkasin komunitetit egjiptian.

KARAKTERISTIKAT SOCIO-EKONOMIKE

Banorët e Librazhdit kanë, mesatarisht, një nivel më të lartë arsimor se norma mesatare kombëtare. Vitet mesatare të shkollimit janë 11.7. Pjesa më e madhe e popullsisë ka përfunduar së paku arsimin e mesëm (rreth 60%); ndërkohë, 21.42% zotëron një diplomë universitare. Vetëm 1.7% e popullsisë është analfabete. Në bashkinë Librazhd ka 2 shkolla 9-vjeçare ku japin mësim një staf prej 73 mësuesish dhe vetëm 1 shkollë të mesme me 33 mësues (Ministria e Arsimit dhe Sportit, 2015).


Në total, 1,843 familje në Librazhd

rendisin si burim kryesor të të ardhurave punën e paguar ose vetëpunësimin (në 67.61% të rasteve) dhe pensionet (në 24.63% të rasteve). Madhësia mesatare e një familjeje është 3.76 dhe 11.2% e kryefamiljarëve janë femra. Ndërkaq, nga pikëpamja e besimit fetar, pak më shumë se gjysma ose rreth 52% e popullsisë së Librazhdit identifikohet me besimin mysliman. Pjesa tjetër, 2.1% me atë ortodoks, 0.6% me atë bektashi dhe 0.3% me besimin katolik.

Sektori mbizotërues i punësimit të banorëve në Librazhd është sektori i shërbimeve, me rreth 83% të punësuar. Pjesa tjetër e të punësuarve, rreth 14% është angazhuar në sektorin e industrisë. Ndërkohë, për shkak të urbanizimit, pjesa e punësimit në sektorin e bujqësisë është vetëm 3%. 66.10% e të punësuarve janë të punësuar me pagë, ndërsa 33.90% janë të vetëpunësuar. Popullsia në moshë pune është 4,784 banorë. Shkalla e përgjithshme e papunësisë është 32.20%, por ndërkohë papunësia e të rinjve është rreth dyfish më e lartë dhe shënon shifra shqetësuese: rreth 70% e të rinjve janë të papunë (Census, 2011). Shkalla e punësimit anon lehtësisht nga meshkujt, ku 40.27% e femrave janë të punësuar, krahasuar me 46.2% të

Fig.9 Punësimi sipas degëve të ekonomisë (në %)

■ Bujqësi □ Industri ■ Shërbime



Burimi: Censusi (2011)

meshkujve. Ndërkaq, rreth 46% e të punësuarve janë me arsim të mesëm dhe 39% me arsim të lartë.

9.2.4. KOMUNA QENDËR


Tabela 4. Të dhëna përmblledhëse për komunën Qendër

Qarku	Elbasan
Rrethi	Librazhd
Dendësia (banorë/km ²)	43.29
Popullsia banuese	8,551
Meshkuj	4,351
Femra	4,200
Koeficienti i përgjithshëm i varësisë (%)	50.44
Analfabetizmi (%)	4.30
Papunësia (%)	18.50
Papunësia të rinjtë (%)	39

Burimi: Censusi i popullsisë dhe banesave (2011)

Fig.10 Përbërja moshore (në %)

■ 0-14 vjeç □ 15-64 vjeç ■ 65+ vjeç




Burimi: Censusi (2011)

DEMOGRAFIA

Në komunën Qendër jetojnë 8,551 banorë. Nga pikëpamja demografike, ndërmjet viteve 1989 dhe 2011, një trend i rënies konstante të popullsisë është i dukshëm. Në shifra konkrete, nga 1989 në 2011, popullsia në Qendër u tkurr me 33.20%, ose me një rritje negative prej 26.13% nga 2001 në 2011 (Census, 2011). Si rrjedhojë, në 2011, dendësia mesatare e popullsisë ishte 43.29 banorë për km².

Të dhënat mbi shpërndarjen gjinore tregojnë se 51% e banorëve janë meshkuj dhe 49% femra. Ndërkohë, pjesa i përket strukturës moshore, 23% e popullsisë janë fëmijë, 65% i përkasin grupmoshës ekonomisht aktive për punë (15 -64 vjeç) dhe 11% janë të moshuar. Si rrjedhojë, koeficienti i përgjithshëm i varësisë është 50.44%. Në komunën Qendër, pjesa më e madhe e popullsisë ose rreth 48% janë të martuar, 46% janë beqarë dhe vetëm 3% janë të divorcuar. Nga pikëpamja etniko-kulturore, 96.04% janë shqiptarë, ndërsa 0.05% i përkasin komunitetit rom.

Fig.11 Niveli arsimor i arritur (në %)



Burimi: *Censusi (2011)*

KARAKTERISTIKAT SOCIO-EKONOMIKE


Të dhënat mbi nivelin arsimor tregojnë se banorët e komunës Qendër kanë, mesatarisht, një nivel të ulët arsimor. Vitet mesatare të shkollimit janë 8.89. Në terma absolutë 368 banorë ose 4.30% e popullsisë është analfabete – një normë kjo më e lartë se mesatarja kombëtare. Pjesa dërrmuese e popullsisë ka përfunduar vetëm arsimin bazë (rreth 72%); ndërkohë, rreth 22% ka përfunduar së paku arsimin e mesëm. Vetëm 4% zotëron një diplomë universitare. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS, 2015), në komunën Qendër, ka 12 shkolla 9-vjeçare me një staf mësimor prej 87 mësuesish. Ndërkohë, në të vetmen shkollë të mesme në Qendër japin mësim vetëm 10 mësues.

Të dhënat ekonomike paraqesin një profil të ulët jetese të familjeve në komunën Qendër. Kësisoj, 1,863 familjet banuese kanë si burim të rëndësishëm të të ardhurave përveç punës së paguar ose vetëpunësimin (në 54.97% të rasteve), pensionet (në 33.92% të rasteve) dhe ndihmën ekonomike (në 18% të rasteve). Ndërkaq, edhe remitanat zënë një pjesë të rëndësishme në burimet e të ardhurave familjare (në 15.62% të rasteve). Të dhënat mbi kushtet e

banesave tregojnë se vetëm një në dhjetë familje ka furnizim me ujë të rrjedhshëm në banesë. Ndërkohë, 4% e familjeve kanë kompjuter dhe 1% ka mundësi aksesit në internet (Census, 2011). Si karakteristikë e zonave rurale, madhësia mesatare e familjes është 5 individë; 9.6% e kryefamiljarëve janë femra. Nga pikëpamja e besimit fetar, pjesa dërrmuese ose 89.90% e popullsisë së komunës i përket besimit mysliman. Ndërkohë, 0.10% i përket atij ortodoks.

Komuna Qendër është një zonë rurale me strukturë ekonomike agrare; sektori kryesor i ekonomisë është bujqësia. Si rrjedhojë, rreth 75% e të punësuarve janë të përfshirë në aktivitetet bujqësore. Ndërkohë, aktivitetet e tjera ekonomike më të mëdha pas bujqësisë janë shërbimet (rreth 16% e të punësuarve i përkasin sektorit të shërbimeve), ndjekur nga industria (9%). Si pasojë e këtij strukturimi të ekonomisë lokale, vetëm 20% e të punësuarve janë të punësuar me pagë, ndërsa 80% janë të vetëpunësuar. Popullsia në moshë pune në komunën Qendër është 5,684 banorë. Shkalla e papunësisë (18.50%) është nën mesataren kombëtare (29.30%), me shumë gjasa e mbuluar nga sektori bujqësor. Ndërkohë, papunësia e të

Fig.12 Punësimi sipas degëve të ekonomisë (në



Burimi: Censusi (2011)

rinjve edhe pse nën normën mesatare kombëtare është më e lartë se norma e përgjithshme duke shënuar vlerën 39%. Shkalla e punësimit anon nga meshkujt, ku vetëm një e treta e femrave janë të punësuarra, krahasuar me më shumë se gjysmën e meshkujve (52.9%). Si reflektim i nivelit të përgjithshëm arsimor të popullsisë, rreth 72.10% e të punësuarve janë me arsim bazë dhe 20.49% me arsim të mesëm. Vetëm 5.90% e të punësuarve janë me arsim pasuniversitar.

9.2.5. BASHKIA PËRRENJAS


Tabela 5. Të dhëna përmblledhëse për bashkinë Përrenjas

Qarku	Elbasan
Rrethi	Librazhd
Dendësia (banorë/km ²)	453.19
Popullsia banuese	5,847
Meshkuj	2,911
Femra	2,936
Koeficienti i përgjithshëm i varësisë (%)	46
Analfabetizmi (%)	1.7
Papunësia (%)	45.90
Papunësia të rinjtë (%)	65.90

Burimi: Censusi i popullsisë dhe banesave (2011)

Fig.13 Përbërja moshore (në %)

■ 0-14 vjeç □ 15-64 vjeç ■ 65+ vjeç




Burimi: Censusi (2011)

DEMOGRAFIA

Rreth 5,847 banorë jetojnë në bashkinë Përrenjas. Të dhënat e Censit (2011), tregojnë se gjatë dekadës së fundit, situata demografike në Përrenjas është prirur të reflektojë trendin e përgjithshëm të tkurrjes së popullsisë të vëzhguar në shkallë kombëtare. Në 2011, popullsia banuese përjetoj një rënie prej 11.98% krahasuar me 2001, ndonëse kjo rënie rezulton të jetë në nivelin prej 18% të tkurrjes së popullsisë në rang qarku. Ndërkohë, dendësia mesatare është 453.19 banorë për km², një shifër më e lartë se niveli kombëtar prej 97.4 banorë për km².

Në total, përbërja gjinore në Përrenjas është e balancuar, ku rreth 50% e banorëve janë meshkuj dhe 50% femra. Struktura moshore përbëhet nga 23.70% fëmijë, 68.31% të popullsisë në moshë pune (15-64 vjeç) dhe 8.02% të moshuar. Kjo shpërndarje moshore paraqitet lehtësisht më e re se struktura moshore në shkallë vendi.

Fig.14 Niveli arsimor i arritur (në %)



Burimi: *Censusi (2011)*

Koeficienti i përgjithshëm i varësisë është 46% dhe peshën më të madhe relative ose rreth 35% e zë koeficienti i varësisë për të rinjtë. Si rrjedhojë, për çdo 100 banorë potencialisht aktivë për punë në bashkinë Përrenjas, ka 46 qytetarë jo në moshë pune (Census, 2011). Të dhënat në lidhje me statusin martesor tregojnë se pak më shumë se gjysma e popullsisë është e martuar (52.2%), ndërsa 43% është beqare. Nga pikëpamja etniko-kulturore, pjesa dërrmuese ose 90.46% e banorëve janë shqiptarë. Ndërkohë, minoriteti arumunë është më i madhi (0.15%), ndjekur nga maqedonasit (0.12%).

KARAKTERISTIKAT SOCIO-EKONOMIKE


Banorët e Përrenjasit, mesatarisht, kanë një nivel arsimor lehtësisht më të lartë se norma e qarkut Elbasan: për një banor në Përrenjas, vitet 1mesatare të shkollimit janë 10.72. Ndërkaq, struktura arsimore e popullsisë tregon që pothuaj 1 në 2 banorë (rreth 49%) ka përfunduar së paku arsimin e mesëm. Gjithashtu, rreth 11% e popullsisë së përgjithshme është me arsim të lartë (një shifër kjo 1 pikë përqindje më e ulët se vlera kombëtare). 1.7% e popullsisë ose rreth 100 banorë mund të konsiderohen

analfabetë (Census, 2011). Indikatorët e tjerë arsimorë tregojnë se në Përrenjas, ka 3 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkollë të mesme, në të cilat japin mësim 56 dhe 24 mësues. përkatësisht (Ministria e Arsimit dhe Sportit, 2015).

Në total, në Përrenjas ka 1,482 familje dhe madhësia mesatare e familjes është 3.94 individë. Ndërkohë, 24.3% e familjeve drejtohen nga gratë. Sipas Censurit 2011, burimi kryesor i të ardhurave për familjet është puna e paguar ose vetëpunësimi (në 46.12% të rasteve) dhe pensionet (në 26.42% të rasteve). Ndërkohë, në 17% të rasteve, burimi kryesor i të ardhurave për familjet në Përrenjas renditet ndihma sociale. Remitancat janë burim kryesor vetëm në 4% të rasteve – dyfish më pak se norma kombëtare. Nga pikëpamja e besimit fetar, pjesa më e madhe ose 72.50% e popullsisë i përket besimit mysliman, 1.69% atij ortodoks 1% besimit bektashi dhe 0.4% atij katolik.

Ekonomia e qytetit të Përrenjasit mbështetet në pjesën më të madhe në shërbime, sektor që si rrjedhojë punëson dhe numrin më të madh të banorëve ose rreth 72%. Ndërkohë, pesha e punësimit në sektorin e bujqësisë dhe industrisë është përafërsisht 16% dhe 12%, respektivisht.

Fig.15 Punësimi sipas degëve të ekonomisë (në



Burimi: Censuri (2011)

53% e të punësuarve janë të punësuar me pagë, ndërsa 47% janë të vetëpunësuar. Në 2011, popullsia në moshë pune në bashkinë Përrenjas ishte 3,994 banorë. Analiza e shkallës së punësimit sipas gjinisë tregon se punësimi është më i lartë për meshkujt (rreth 33%), krahasuar me femrat (rreth 26%), edhe pse në perspektivë niveli i punësimit të femrave ruhet në shkallën kombëtare (25.5%). Ndërkohë, si reflektim i nivelit arsimor të popullsisë, 46% e të punësuarve janë me arsim të mesëm dhe 26% me arsim universitar. Norma e papunësisë, sipas Censurit 2011, ishte 45.90% dhe papunësia shfaqet veçanërisht problematike për grupmoshat e reja (65.90%).

9.2.6. BASHKIA CËRRIK


Tabela 6. Të dhëna përmblledhëse për bashkinë Cërrik

Qarku	Elbasan
Rrethi	Elbasan
Dendësia (banorë/km ²)	610.35
Popullsia banuese	6,695
Meshkuj	3314
Femra	3381
Koeficienti i përgjithshëm i varësisë (%)	43.30
Analfabetizmi (%)	4.40
Papunësia (%)	49.40
Papunësia të rinjtë (%)	72.50

Burimi: Censusi i popullsisë dhe banesave (2011)

Fig.16 Përbërja moshore (në %)

■ 0-14 vjeç □ 15-64 vjeç ■ 65+ vjeç




Burimi: Censusi (2011)

DEMOGRAFIA

Bashkia Cërrik ka 6,695 banorë. Të dhënat tregojnë se nga pikëpamja demografike, qyteti i Cërrikut shfaq prirje të dukshme të tkurrjes së popullsisë. Një vështrim i përgjithshëm i ndryshimit të numrit të popullsisë që nga 1989 tregon se në 2011 kishte 28.82% banorë më pak se në 2001 dhe 36.16% më pak nëse vëzhgojmë intervalin 1989-2011. Ky shpopullim paraqitet veçanërisht më i theksuar se ulja e popullsisë në rang qarku (18%) dhe rënia kombëtare e popullsisë (8.8%). Megjithatë, dendësia mesatare e popullsisë është 610.35 banorë për km², një vlerë mbi normën mesatare kombëtare.

Për sa i përket përbërjes gjinore, 49% e banorëve në Cërrik janë meshkuj dhe 51% femra. Struktura moshore përbëhet nga 70% e popullatës në moshë aktive për punë (grupmosha 15-64 vjeç), ndjekur nga 19% fëmijë dhe 11% të moshuar. Si rrjedhojë, koeficienti i përgjithshëm varësisë është 43%,

Fig.17 Niveli arsimor i arritur (në %)



Burimi: Censuri (2011)

ku për çdo 100 banorë të Cërrikut në segmentin e moshës aktive për punë, ka respektivisht 43 banorë në moshë jo pune. Të dhënat mbi statusin civil të popullatës, tregojnë që pak më shumë se gjysma janë të martuar (rreth 52%), 40% janë beqarë dhe 16% janë të divorcuar. Nga pikëpamja etno-kulturore, në masën dërrmuese të tyre banorët janë shqiptarë (88.50%), 0.55% i përkasin komunitetit egjiptian, ndërsa 0.04% janë arumunë.

KARAKTERISTIKAT SOCIO-EKONOMIKE


Banorët e Cërrikut kanë, mesatarisht, një nivel më të ulët arsimor se norma mesatare kombëtare. Vitet mesatare të shkollimit janë 9.78. Gjysma e popullsisë në Cërrik ka përfunduar vetëm arsimin bazë (rreth 50.80%); ndërkohë, pak më shumë se një e treta ka përfunduar vetëm arsimin e mesëm. Rreth 8% e popullsisë zotëron një diplomë universitare (4 pikë përqindje më pak se shkalla kombëtare e popullsisë me arsim të lartë). 294 banorë në terma absolutë ose rreth 4.4% janë analfabetë (Census, 2011). Të dhënat nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (2015) tregojnë se bashkia numëron 3 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkollë të mesme. Në shkollat

9-vjeçare janë punësuar në total 62 mësues. Ndërkohë, stafi i shkollës së mesme përbëhet nga 20 mësues.

Në Cërrik jetojnë 1,924 familje. Burimi kryesor i të ardhurave për familjet është puna e paguar ose vetëpunësimi (në 36.17% të rasteve) dhe pensionet në 38.62% të rasteve. Megjithatë, ndihma sociale zë një pjesë të rëndësishme në burimet e të ardhurave familjare (në 16.94% të rasteve). Madhësia mesatare e familjes është 4.23 dhe rreth një e treta e kryefamiljarëve janë femra. Nga pikëpamja e besimit fetar pjesa më e madhe ose 64.20% e popullsisë së Cërrikut i përket besimit myslimanë. Ndërkohë, 3.60% atij ortodoks, 2.20% katolikë dhe 2.60% bektashi.

Popullsia në moshë pune në bashkinë Cërrik është 4,671 banorë. Rezultatet e Censurit (2011) tregojnë se 1 në 2 banorë të Cërrikut është i papunë (shkalla e papunësisë është 49.40%), ndërkohë që papunësia e të rinjve shënon shifra shumë shqetësuese (72.50%). Ndërkohë, shkalla e punësimit anon veçanërisht nga meshkujt, ku vetëm 17.02% e femrave janë të punësuar, krahasuar me 26.5% të meshkujve. Rreth 46.97% e të punësuarve janë me arsim të mesëm dhe 22% me arsim universitar. Pjesa më e madhe e të punësuarve është

Fig.18 Punësimi sipas degëve të ekonomisë (në



Burimi: Censusi (2011)

përqendruar në sektorin e shërbimeve (rreth 64%). Ndërkohë, pesha tjetër e punësimit ndahet midis sektorit të industrisë dhe bujqësisë në 24% dhe 12%, përkatësisht. 57.90% e të punësuarve janë të punësuar me pagë, ndërsa 42.10% janë të vetëpunësuar.


9.2.7. BASHKIA BULQIZË

Tabela 7. Të dhëna përmblledhëse për bashkinë Bulqizë

Qarku	Dibër
Rrethi	Bulqizë
Dendësia (banorë/km ²)	200.99
Popullsia banuese	8,177
Meshkuj	4,125
Femra	4,052
Koeficienti i përgjithshëm i varësisë (%)	48
Analfabetizmi (%)	1.6
Papunësia (%)	46
Papunësia të rinjtë (%)	80.10

Burimi: Censusi i popullsisë dhe banesave (2011)

Fig.19 Përbërja moshore (në %)




Burimi: Censusi (2011)

DEMOGRAFIA

Në bashkinë Bulqizë jetojnë 8,177 banorë. Të dhënat e analizës demografike krahasimore shpërfaqin një tendencë në rritje të tkurrjes së popullsisë. Kështu, shpopullimi relativisht i vogël i vëzhguar nga vitet 1989 në 2011 (6.14%), është shoqëruar me një tkurrje prej 21.78% nga 2001 në 2011. Megjithatë, kjo shifër ruhet ende në parametra më të vegjël se ulja e popullsisë në rang qarku (28%). Qyteti i Bulqizës është qyteti i tretë më i populluar në qarkun Dibër.

Shpërndarja gjinore paraqitet e balancuar, ku 50.4% e banorëve janë meshkuj dhe 49.5% femra. Ndërkaq, 68% e popullsisë është potencialisht aktive për punë (15-64 vjeç), ndjekur nga 27% fëmijë dhe vetëm 5% të moshuar. Kjo strukturë moshore specifike nënvizon moshën relativisht të re të popullsisë në Bulqizë. Si rezultat, koeficienti i përgjithshëm i varësisë prej 48% në pjesën më të madhe i atribuohet

Fig.20 Niveli arsimor i arritur (në %)



Burimi: Censusi (2011)

përqindjes më të madhe të të rinjve (koeficienti i varësisë për të rinjtë 40.24). Gjithashtu, si rrjedhojë e moshës së re, popullsia ka afërsisht një numër të barabartë banorësh të martuar dhe beqarë: 48% janë të martuar dhe 47% janë beqarë. Ndërkaq, vetëm 5% e banorëve janë të divorcuar. Nga pikëpamja etno-kulturore, në Bulqizë, rreth 89% e banorëve janë shqiptarë, 0.20% arumunë, 0.16% maqedonas, dhe 0.01% i përkasin komunitetit egjiptian.

KARAKTERISTIKAT SOCIO-EKONOMIKE

Pjesa më e madhe e popullsisë në Bulqizë ka përfunduar vetëm arsimin bazë (rreth 59%); ndërkohë, 40% ka përfunduar së paku arsimin e mesëm. Prej këtyre, rreth 7% zotëron një diplomë universitare. Censusi (2011) tregoi se vetëm 1.6% e popullsisë është analfabete ose rreth 130 banorë në terma absolutë. Ndërkohë, në Bulqizë numërohen 2 shkolla 9-vjeçare me një staf prej 67 mësuesish dhe 1 shkollë e mesme me 26 mësues.


Në Bulqizë, ka në total 1,922 familje. Madhësia mesatare e familjes është 4.25. Dy në dhjetë kryefamiljarë janë femra. Burimi kryesor i të ardhurave për familjet është puna e paguar ose

vetëpunësimi (në 55.17% të rasteve) dhe pensionet (në 30.27% të rasteve). Gjithashtu, ndihma sociale zë një pjesë të rëndësishme në burimet e të ardhurave familjare (në 24.23% të rasteve). Nga pikëpamja e besimit fetar, pjesa më e madhe ose 71.20% e popullsisë së Bulqizës i përket besimit mysliman. Ndërkohë, 0.3% atij ortodoks, 0.2% katolik dhe 13.70% besimit bektashi.

Popullsia në moshë pune në Bulqizë është 5,524 banorë. Megjithatë, një pjesë e madhe e fuqisë potenciale për punë mbetet e pashfrytëzuar. Rezultatet e Censurit (2011) tregojnë se shkalla e papunësisë është 46%, ndërkohë që papunësia e të rinjve shënon shifra vërtetë shqetësuese: 80.10% e të rinjve në Cërrik vetë-deklarohen të papunë. Ndërkohë, shkalla e punësimit anon veçanërisht nga meshkujt, ku vetëm 19.62% e femrave janë të punësuar, krahasuar me 36.9% të meshkujve. Nga pikëpamja e nivelit arsimor, rreth 45.72% e të punësuarve janë me arsim të mesëm dhe 18% me arsim universitar. Pak më shumë se gjysma e të punësuarve është përqendruar në sektorin e shërbimeve (rreth 51%). Ndërkohë, pjesa tjetër e të punësuarve (rreth 45%) është angazhuar në sektorin e industrisë.

Fig.21 Punësimi sipas degëve të ekonomisë (në

Bujqësi **Industri** **Shërbime**



Burimi: Censusi (2011)

Vetëm 4% e të punësuarve në Bulqizë merren me aktivitete bujqësore. Në total, 76.30% janë të punësuar me pagë, ndërsa 23.70% janë të vetëpunësuar.

9.2.8. BASHKIA KUKËS


Tabela 8. Të dhëna përmblledhëse për bashkinë Kukës

Qarku	Kukës
Rrethi	Kukës
Dendësia (banorë/km ²)	1221.56
Popullsia banuese	16,719
Meshkuj	8,385
Femra	8,334
Koeficienti i përgjithshëm i varësisë (%)	52
Analfabetizmi (%)	1.6
Papunësia (%)	42.50
Papunësia të rinjtë (%)	74.50

Burimi: Censusi i popullsisë dhe banesave (2011)

Fig.22 Përbërja moshore (në %)

■ 0-14 vjeç □ 15-64 vjeç ■ 65+ vjeç




Burimi: Censusi (2011)

DEMOGRAFIA

Popullsia e bashkisë Kukës përfshin 16,719 banorë. Dendësia mesatare është 1221.56 banorë për km². Nga pikëpamja demografike, prirja e rritjes negative të popullsisë në rang qarku paraqitet më e theksuar në qarqet periferike në veri (ku tkurrja e popullsisë për Kukësin ishte 23% në 2011), megjithatë qyteti i Kukësit është larg kësaj prirjeje të përgjithshme. Kështu, nga 1989 në 2011, popullsia u rrit me vetëm 0.99%, ndërsa nëse vëzhgojmë nga 2001 në 2011 vihet re një tkurrje me 2.55%. Kjo tendencë i atribuohet kryesisht ndërthurjes së imigrimit të brendshëm dhe rritjes natyrore me emigrimin ndërkombëtar.

Nga pikëpamja gjinore, ekziston një numër afërsisht i barabartë mes meshkujve dhe femrave (50.1% meshkuj dhe 49.8% femra). Për sa i përket strukturës moshore, 66% e popullsisë është pjesë e grupmoshës potencialisht aktive për punë (15 -64 vjeç), 28% e popullsisë janë fëmijë dhe vetëm 6%

Fig.23 Niveli arsimor i arritur (në %)



Burimi: Censusi (2011)

